AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në:**
**"Shkenca Sociale dhe të Sjelljes"**
**ofruar nga**
**Universiteti Europian i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Dr Aliriza Arënliu**
**Prof. Asoc. Fiona Todhri**

**Shtator / 2025**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË: "SHKENCA SOCIALE DHE TË SJELLJES"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Europian i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Doktoratë në: "Shkencat Sociale dhe të Sjelljes" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhër MAS Nr. 111, datë 04.03.2022<br>Saktësuar me Urdhër MAS Nr. 251, datë 09.05.2022 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i tretë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 / 5 vjet |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë / kohë të zgjatur |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha Shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli i 8 (tetë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | Viti akademik 2021 – 2022 9 PAE / 0 PAK;<br>Viti akademik 2022 – 2023 11PAE / 0 PAK;<br>Viti akademik 2023 – 2024 24 PAE / 0 PAK;<br>Viti akademik 2024 – 2025 11 PAE / 0 PAK; |

| | | |
|---|---|---|
| 18 | Numri i studentëve: | Viti akademik 2021 – 2022 18 studentë;<br>Viti akademik 2022 – 2023 13 studentë;<br>Viti akademik 2023 – 2024 41 studentë; |
| 19 | Komente / të tjera: | |





## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Doktoraturës në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes në UET përfaqëson një përpjekje të strukturuar për të promovuar kërkimin shkencor të avancuar dhe për të ndërtuar një kulturë akademike që mbështet inovacionin, bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe rigorozitetin metodologjik. Ky program është i përafruar me misionin institucional të UET për të avancuar dijen, për të kontribuar në zhvillimin shoqëror dhe për të respektuar standardet më të larta akademike kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi doktoral është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 111, datë 04.03.2022 (ndryshuar me Urdhrin nr. 251, datë 09.05.2022). Karakteri ndërdisiplinor i programit është një nga pikat kyçe të tij. Ai përfshin fusha të ndryshme të shkencave sociale, si ekonomia, shkencat politike, psikologjia, sociologjia dhe studimet kulturore. Kjo qasje e gjerë synon të adresojë sfida komplekse në një kontekst të ndërlidhur global dhe lokal, duke përputhur fushat kërkimore me kodet ISCED, çka e bën programin të krahasueshëm dhe të standardizuar në nivel ndërkombëtar.Mjedisi kërkimor është një tjetër shtyllë e rëndësishme. Programi u ofron kandidatëve mundësinë për të qenë pjesë aktive e projekteve kërkimore të udhëhequra nga profesorë me profil të lartë shkencor, si dhe përfshirjen në grante dhe rrjete kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo jo vetëm që fuqizon kapacitetin kërkimor të doktorantëve, por gjithashtu integron programin në rrjedhat aktuale të kërkimit shkencor evropian dhe më gjerë. Për më tepër, programi gëzon legjitimitet të plotë institucional dhe ligjor, i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe i organizuar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara në bashkëpunim me njësi të tjera akademike dhe kërkimore brenda UET, duke garantuar kështu një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e tij afatgjatë.

Në kontekstin **akademik**, programi ndihmon në forcimin e kapaciteteve kërkimore të universitetit dhe kontribuon në ndërtimin e një kulture të vërtetë kërkimi brenda arsimit të lartë shqiptar. Pjesëmarrja aktive e doktorantëve në projekte të financuara nga burime të ndryshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, jo vetëm që pasuron përvojën e tyre shkencore, por edhe rrit vizibilitetin dhe kredibilitetin e UET si një qendër kërkimore me ndikim. Në planin **shoqëror**, ky program shërben si një mjet i rëndësishëm për të lidhur dijen akademike me realitetin shoqëror shqiptar. Duke përqafuar fusha si qeverisja, politikat publike, drejtësia sociale, edukimi qytetar, apo zhvillimi ekonomik dhe demografik, programi synon të prodhojë dije të dobishme që mund të orientojë vendimmarrjen politike dhe të ndihmojë në ndërtimin e institucioneve më të qëndrueshme, më gjithëpërfshirëse dhe më të ndjeshme ndaj sfidave të kohës. Programi doktoral në shkencat sociale dhe të sjelljes përfaqëson një perspektivë institucionale, forcon rolin e UET si një aktor proaktiv në zhvillimin e shkencave sociale në Shqipëri dhe në rajon. Përfshirja në rrjete ndërkombëtare si Erasmus+, COST Action apo AKKSHI i jep programit një dimension evropian dhe rrit mundësinë për transferim njohurish dhe praktika të mira akademike. Në përfundim, suksesi i këtij programi nuk matet vetëm me prodhimin e disertacioneve cilësore, por edhe me ndikimin e tij në krijimin e

politikave më të informuara, në fuqizimin e institucioneve publike dhe në avancimin e një shoqërie më të drejtë dhe më reflektuese ndaj vetvetes.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Nga perspektiva e ekspertëve të jashtëm të përfshirë në procesin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), programi i doktoraturës në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes në UET paraqet një qasje të mirëstrukturuar dhe të dokumentuar në mënyrë të rregullt, në përputhje me kërkesat e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë. Mbështetur në VKM nr. 109/2017 ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupin e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit "Doktoratë" në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" me anëtarë: **Prof. Dr. Aliriza Arënliu** dhe **Prof. Asoc. Fiona Todhri**. Grupi i vlerësimit të jashtëm është trajnuar dhe asistuar nga koordinatori dhe përfaqësuesi i ASCAL, Msc Muhamed Prezja. Ekspertët evidentuan rregullsinë dhe qartësinë e dokumentacionit të paraqitur si një pikë të fortë të raportit të vetëvlerësimit. Të dhënat janë mbledhur në mënyrë sistematike, të referuara qartë dhe të përputhura me kërkesat e akreditimit. Dokumentacioni i ofruar mbulon të gjitha aspektet thelbësore të programit: kurrikulat, profilin e stafit akademik, rezultatet e kërkimit shkencor, raportet e punës së doktorantëve, rregulloret përkatëse dhe mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, ekspertët vlerësuan pozitivisht larmishmërinë e burimeve dokumentare dhe institucionale të përfshira në raport. Pjesëmarrja e njësive të ndryshme – si departamente akademike, qendra kërkimore, zyra administrative dhe struktura mbështetëse – dëshmon për një proces vetëvlerësimi gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues. Kjo larmi burimesh pasqyron një qasje institucionale gjithëpërfshirëse që e tejkalon formën formale të përgatitjes së raportit dhe kontribuon në një kuptim më të thelluar të funksionimit real të programit. Nga pikëpamja e përputhshmërisë me standardet kombëtare të sigurimit të cilësisë, ekspertët konfirmuan se raporti është i harmonizuar me kriteret e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe i orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm. Tregohet një ndërgjegjësim institucional i mirë për menaxhimin e cilësisë, monitorimin e progresit të doktorantëve dhe përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor. Në përfundim, ekspertët e jashtëm vlerësuan që procesi i vlerësimit dhe vetë raporti përfaqësojnë një model të mirë të vetëanalizës institucionale, të ndërtuar mbi baza të qarta metodologjike dhe me një përkushtim të dukshëm ndaj transparencës dhe cilësisë akademike.

Universiteti Europian i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 89/20 Prot, datë 28.07.2025. Universiteti Europian i Tiranës më datë 18.08.2025, njofton me anë të shkresës me Nr.118 /10 Prot, datë 18.08.2025 "*Kthim përgjijge shkresës tuaj nr. 118/9, datë 29.07.2025*", ku shprehin dakortësinë mbi draft raportin. Në këtë mënyrë draft raporti kthehet në raport final.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Doktoraturë në "Shkencat Sociale dhe të Sjelljes"**

## I. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT DOKTORAL

| **Standardi I.1**<br><br>**Programi i studimit i ciklit të tretë doktoratë ofrohet nga institucione të arsimit të lartë që përmbushin kriteret ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i doktoratës ofrohet nga institucionet e llojit universitet ose akademi i akredituar në Republikën e Shqipërisë. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) është i akredituar me vendim Nr. 82, datë 22 Shtator 2023 nga Bordi i Akreditimit i Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë[1]. Në përfundim të procesit të vlerësimit të jashtëm, Bordi i Akreditimit ka dhënë një **vlerësim përfundimtar pozitiv** për institucionin e arsimit të lartë, Universiteti Europian i Tiranës. Si rezultat, institucioni është akredituar për një periudhë katërvjeçare, duke filluar nga data e marrjes së vendimit, me vlefshmëri deri më 21 shtator 2027. Ky vendim është mbështetur në gjetjet e dokumentuara gjatë vlerësimit dhe shoqërohet me një paketë rekomandimesh të përfshira në shtojcën përkatëse. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është ngarkuar me detyrën për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji, si dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Vendimi ka efekt të menjëhershëm[2]. Gjithashtu Universiteti Europian i Tiranës (UET) është ndër institucionet e parë në vend që ka marrë akreditimin ndërkombëtar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Mbretërisë së Bashkuar (QAA). Ky akreditim është dhënë pas një procesi të rreptë vlerësimi ndërkombëtar (International Quality Review – IQR), i cili mat institucione globale sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë së cilësisë të përcaktuara në Seksionin I të Standardeve dhe |

[1] *3.1 VBA Nr. 82 datë 22.09.2023 - Akreditimi Periodik Institucional_ASCAL_QAA.pdf*
[2] *3.1.1 Certifikate Akreditimi 05.07.2019.pdf*

| | |
|---|---|
| | Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG) [3],[4]. |
| **Kriteri 2.** Programi i doktoratës që ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit të jenë të akredituara në vendin e origjinës. | **N / A** |
| **Kriteri 3.** Programi i doktoratës licencohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. | Universiteti Europian i Tiranës (EUT) funksionon brenda një kuadri ligjor dhe rregullator të përcaktuar nga legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Ky kuadër përfshin:<br>a) **Ligji Nr. 80/2015** "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", i cili rregullon licencimin dhe akreditimin e institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë në Shqipëri[5].<br>b)**VKM Nr. 112, datë 23.02.2018** "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i Asociuar' dhe 'Profesor'", i cili përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien e këtyre titujve akademikë[6].<br>c)**Urdhri Nr. 1113, datë 04.03.2022** i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë, për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë nga "Doktoratë në Shkenca Sociale" në "Doktoratë në Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" në UET[7]. |

[3] *3.2 QAA Certificate of Accreditation.pdf 3.2 QAA Certificate of Accreditation.pdf*
[4] *3.2.1 Award of QAA international accreditation confirmation letter.pdf*
[5] *https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij-2/*
[6] *https://urdher-nr-112-date-05-07-2024-per-miratimin-e-kalendarit-per-procedurat-e-aplikimit-dhe-te-regjistrimit-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-per-vitin-akademik-2024-2025*
[7] *https://uet.edu.al/doktorata/*

| | |
|---|---|
| | Ky kuadër ligjor dhe rregullator siguron që UET të operojë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. |
| **Kriteri 4.** Programi i doktoratës hartohet nga ana e institucionit nëpërmjet procedurave të brendshme transparente dhe miratohet në përputhje me statutin, rregulloren dhe aktet e tjera organizative të institucionit. | Programi i doktoratës është hartuar nga institucioni përmes procedurave të brendshme transparente dhe miratohet në përputhje me statutin, rregulloren dhe aktet e tjera organizative të institucionit. Programi i doktoratës është hartuar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, në bashkëpunim me njësitë bazë të UET-it, përkatësisht Departamenti i Ekonomisë dhe Financës, Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm, Qendra për Metodologji dhe Kërkim Shkencor, Qendra për Kërkime Shkencore në Shëndetin Publik dhe Qendra për Studime Kulturore dhe Edukim Qytetar. Propozimi mori miratimin e Senatit Akademik (Vendimi Nr. 08, datë 26.03.2021, ndryshuar me Vendimin Nr. 8/1, datë 11.11.2021)[8] dhe të Bordit të Administrimit (Nr. 40, datë 26.04.2021).[9] Aplikimi iu dërgua Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe u miratua për të nisur kursin e parë në mars të vitit 2022 (Urdhri Nr. 111, datë 04.03.2022, i ndryshuar).[10]<br><br>Programi i doktoratës në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" pranë Universitetit Europian të Tiranës (UET) është rezultat i një procesi të mirëstrukturuar dhe transparent, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky program është hartuar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, në bashkëpunim me njësi të tjera akademike dhe kërkimore të UET-it, si Departamenti i Ekonomisë dhe Financës, Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm, Qendra për Metodologji dhe Kërkim Shkencor, Qendra për Kërkime Shkencore në Shëndetin Publik dhe Qendra për Studime Kulturore dhe Edukim Qytetar. Ky bashkëpunim ndërdisiplinor siguron një qasje të gjerë dhe të thelluar në fushën e shkencave sociale dhe të sjelljes. Mbwshtetur nw dokumentacionin programi doktoral drejtohet nga rregullorja e programit, e titulluar *"Rregullorja për Organizimin e Studimeve të Doktoratës në Shkenca Sociale dhe* |

[8] *1.6 Vendim Senati nr. 08 date 26.03.2021 miratimi dhe riorganizimi i programit.pdf*
[9] *1.7 Nr. prot 40, date 26.04.2021_Bordi i Administrimit.pdf*
[10] *3.8.1 Shembull_ informimi _Aplikim Doktoratë në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" 2023-2024.pdf*

| | |
|---|---|
| | *të Sjelljes"*[11],[12], *ku janë* përcaktuar qartë procedurat e brendshme mbi organizimin dhe rishikimin e programit. Sipas dokumentave të vëna në dispozicion vërejmë se këto procedura janë në përputhje me Statutin e UET-it[13] dhe aktet e tjera organizative, si dhe me Ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore përkatëse. Gjithashtu ka një korelacion midis programit doktoral dhe Politikave të Kërkimit Shkencor të UET-it[14] për periudhën 2021-2025, ku theksohet angazhimi i institucionit ndaj zhvillimit të bazuar në kërkimin shkencor dhe ku kjo politikë synon të krijojë ambjentin e duhur kërkimor shkencor brenda të cilit, stafi akademik dhe studentët të kenë mundësi të zhvillojnë ambiciet e tyre kërkimore shkencore. Gjithashtu ofrohet një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin dhe zbatimin e të gjithë menaxhimit të kërkimit në Universitetin Europian të Tiranës.<br>*Shih 1.5 Riorganizm Dr. Shkenca Sociale dhe të Sjelljes.pdf; 1.5.1 Riorganizimi Dr. Shkenca Sociale dhe te Sjelljes_saktesim.pdf* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në sa më sipër, Universiteti Europian i Tiranës ka përmbushur plotësisht kriteret për hartimin dhe miratimin e programit të doktoratës, duke ndjekur një proces të mirëorganizuar dhe transparent, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të arsimit të lartë në Shqipëri. Programi është hartuar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, në bashkëpunim me njësi të tjera akademike dhe kërkimore të UET-it, dhe është miratuar nga organet drejtuese të institucionit, përkatësisht Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Gjithashtu, programi është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe me Politikën e Kërkimit Shkencor të UET-it për periudhën 2021-2025. Rregullorja e programit përcakton procedura të brendshme transparente për organizimin dhe rishikimin e tij, duke reflektuar një angazhim institucional për cilësi dhe zhvillim të bazuar në kërkimin shkencor.* |

[11] *2.1 REGULATION of the Doctoral Program.pdf*
[12] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[13] *3. Statuti i UET.pdf*
[14] *8. Politika e kerkimit shkencor 2021-2025.pdf*

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br><br>**Programi i studimit i ciklit të tretë doktoratë ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe të kërkimit shkencor të institucionit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i doktoratës hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të vetë institucionit. | Programi i studimeve të ciklit të tretë – Doktoratë në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" i ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës (UET) është konceptuar dhe implementuar në përputhje të plotë me strategjinë institucionale të zhvillimit dhe kërkimit shkencor të këtij institucioni. Strategjia e Kërkimit Shkencor e UET për periudhën 2021–2025[15] përcakton qartë vizionin dhe misionin e institucionit për të promovuar një kërkim shkencor cilësor, të qëndrueshëm dhe të ndërdisiplinor. Objektivat strategjikë të kësaj strategjie përfshijnë: forcimin e kapaciteteve kërkimore, integrimin e kërkimit në mësimdhënie, nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe aplikimin e njohurive në shërbim të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik. Programi i doktoratës është ndërtuar mbi këto shtylla strategjike, duke u fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore të studentëve dhe stafit akademik në fushat e shkencave sociale dhe të sjelljes. Ai përfshin komponentë të rëndësishëm si metodologjia e avancuar e kërkimit, ndërdisiplinariteti dhe aplikimi praktik i njohurive, të cilat janë në përputhje me prioritetet e strategjisë së kërkimit shkencor të UET. Programi i doktoratës në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" i Universitetit Europian të Tiranës (UET) është ndërtuar në përputhje të plotë me dokumentet strategjike të institucionit, përkatësisht Planin Strategjik 2021–2025[16] dhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021–2025. Këto dokumente përcaktojnë objektivat e UET për të arritur standarde të larta në arsim dhe kërkim shkencor, të krahasueshme me tregun evropian të arsimit të lartë. Ato theksojnë rëndësinë e ekselencës në |

[15] *21.1 Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025.pdf*
[16] *3.6 Planit strategjik 2021-2025, i perditesuar.pdf*

| | |
|---|---|
| | kërkim, pjesëmarrjes aktive në projekte shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe zhvillimit të vazhdueshëm të stafit akademik. Sipas këtyre strategjive, UET synon të prodhojë dhe të ndajë njohuri shkencore, duke promovuar bashkëpunime me institucione evropiane dhe rajonale. Universiteti investon në kërkues të talentuar, përmirëson kapacitetet kërkimore dhe ofron akses në burime digjitale esenciale. Programi i doktoratës është projektuar për të ndihmuar në arritjen e këtyre objektivave, duke ofruar një kurrikulë që integron kërkimin shkencor me mësimdhënien dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen në projekte kërkimore që kanë ndikim në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik[17]. |
| **Kriteri 2.** Fusha e kërkimit e programit të doktoratës përputhet së paku me një nga fushat e veprimtarisë akademike të institucionit. | Programi i doktoratës në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" në Universitetin Europian të Tiranës (UET) është i ndërlidhur ngushtë me fushat kryesore të veprimtarisë akademike të institucionit, duke reflektuar një përputhje të qartë midis kërkimit shkencor dhe misionit të tij arsimor. Mbështetur nrë dokumentacionin e institucionit vërejmë që cikli i tretë i studimeveështrë një vazhdimrësi e programeve të studimit të dy niveleve të para të cilat janë përkatësisht në fusha si administrim publik, shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare, drejtësi, psikologji, edukim dhe arte, të cilat përbëjnë bazën e formimit akademik të institucionit. Ky cikël doktoral është një mundësi për të studiuar dhe krijuar paradigma në këto fusha përmes metodave kërkimore të avancuara. Studimet doktorale nga institucioni janë fokusuar tek tematika si: "Sjellja e individëve dhe aktorëve ekonomikë në raport me shtetin dhe shoqërinë", e cila shtrihet si një qasje multidisiplinare që përfshin analiza nga perspektiva të ndryshme akademike. Kjo qasje siguron që kërkimi i zhvilluar në kuadër të programit të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe në zhvillimin e mëtejshëm të fushave akademike të UET. Për më tepër, përputhja midis fushave kërkimore të doktoratës dhe veprimtarive akademike të UET siguron që programi të mbetet i rëndësishëm dhe të kontribuojë në mënyrë domethënëse në misionin e |

[17] *8. Politika e kerkimit shkencor 2021-2025.pdf*

| | |
|---|---|
| | universitetit për prodhimin e dijes, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxitjen e zhvillimit shoqëror[18]. |
| **Kriteri 3.** Programi i doktoratës ka të përcaktuara qartë emërtimin, organizimin, strukturën, përmbajtjen, qëllimin dhe objektivat e tij, të harmonizuara me ato të institucionit/institucioneve ofrues. | Programi i doktoratës në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" në Universitetin Europian të Tiranës (UET) është i strukturuar në mënyrë të qartë dhe të harmonizuar me strategjinë institucionale të universitetit. Ky program është riorganizuar dhe miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin Nr. 111, datë 04.03.2022, duke reflektuar përkushtimin e UET për të ofruar një formim të avancuar akademik dhe kërkimor në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.[19] Programi i Doktoratës në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes" në Universitetin Europian të Tiranës (UET) është konceptuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me strategjinë institucionale të zhvillimit dhe kërkimit shkencor për periudhën 2021–2025[20]. Struktura e programit është fleksibël, duke ofruar mundësi për studime me kohë të plotë (3 vjet) dhe me kohë të zgjatur (deri në 5 vjet), çka i përshtatet edhe profesionistëve në punë. Ai përfshin module teorike dhe metodologjike, seminare dhe etapa kërkimore, duke integruar kandidatët në grupe kërkimore dhe duke u ofruar mentorim të vazhdueshëm. Fushat kërkimore të programit përfshijnë ekonominë, psikologjinë, sociologjinë dhe studimet kulturore, të cilat janë në përputhje me prioritetet akademike dhe kërkimore të UET. Kjo përputhje siguron që programi të jetë relevant dhe të kontribuojë në misionin e universitetit për prodhimin e dijes, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin shoqëror. Rregullorja e programit[21] përcakton qartë emërtimin, organizimin, strukturën, qëllimin dhe objektivat e tij, duke përfshirë edhe kriteret e pranimit, procedurat e aplikimit dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve të doktoratës. Kjo transparencë dhe organizim i mirë strukturuar reflekton angazhimin e UET për të ofruar një program doktorature të cilësisë së lartë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. |

[18] *27. Programet dhe profilet per regjistrimet 24-25.pdf*
[19] *21.1 Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025.pdf*
[20] *Ibid*
[21] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programi i doktoratës hartohet dhe ofrohet me synimin për të nxitur zhvillimin shkencor ekonomik lokal dhe/ose kombëtar duke integruar në përmbajtje të tij strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit. | Programi i Doktoratës në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes në UET synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë dhe rajonit, duke integruar temat kërkimore me prioritetet kombëtare dhe agjendat ndërkombëtare si SDG-të e OKB-së, Rekomandimin e UNESCO-s për Shkencën e Hapur dhe Procesin e Bolonjës. Në qendër të këtij programi qëndron analiza e ndërveprimit midis individëve, aktorëve ekonomikë dhe shtetit, me fokus në sfida si rritja ekonomike, qeverisja, barazia sociale, shëndeti mendor dhe transformimet shoqërore. Kërkimet trajtojnë tema si sjellja fiskale, përfshirja financiare, inteligjenca artificiale dhe reforma e pensioneve, duke ofruar zgjidhje të bazuara në evidencë për politika më të efektshme. Programi mbështet gjithashtu një qasje gjithëpërfshirëse ndaj shëndetit mendor, veçanërisht për grupet vulnerabël, në përputhje me udhëzimet evropiane dhe prioritetet kombëtare. Duke promovuar parimet e Shkencës së Hapur dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, programi synon të krijojë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e politikave dhe integrimin evropian të vendit. |
| **Konkluzione** | *Bazuar në analizën përshkruese, konstatohet se Programi Doktoratë në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes është në një shkallë të lartë përputhshmërie me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe me prioritetet ndërkombëtare kërkimore dhe arsimore.*<br><br>*Tematikat kërkimore janë të qarta, të aktualizuara dhe të orientuara drejt zgjidhjes së sfidave të rëndësishme socio-ekonomike në nivel kombëtar dhe rajonal. Përfshirja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, integrimi i parimeve të Shkencës së Hapur dhe bashkëpunimet ndërkombëtare dëshmojnë për një qasje të qëndrueshme dhe të orientuar drejt impaktit. Për më tepër, adresimi i çështjeve të ndjeshme si shëndeti mendor i grupeve vulnerabël tregon ndjeshmëri sociale dhe përputhje me udhëzimet evropiane dhe kombëtare.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br><br>**Programi i studimit i ciklit të tretë doktoratë synon të plotësojë nevojat aktuale dhe afatgjata që ka vendi për studiues dhe kërkues shkencorë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për hartimin e programit të doktoratës, institucioni, njësia përgjegjëse apo grupi kërkimor, kryen studime dhe analiza mbi situatën, zhvillimet, nevojat, prioritetet në fushën e përgjithshme dhe specifike të programit të doktoratës të cilat bëhen pjesë e projekt propozimit përpara hapjes së programit. | Në përputhje me kërkesat e standardit për hartimin e programeve të studimeve të doktoratës, institucioni ka ndërmarrë një proces të strukturuar dhe të dokumentuar të analizës së kontekstit kombëtar dhe ndërkombëtar për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet në fushën e Shkencave Sociale dhe të Sjelljes. Kjo analizë është realizuar nga njësia përgjegjëse në bashkëpunim me grupe kërkimore dhe aktorë të interesit, duke identifikuar temat kyçe që përbëjnë bazën e programit. Programi i doktoraturës synon t'u përgjigjet kërkesave të tregut të punës[22] në sektorët publik, akademik, jofitimprurës dhe të konsulencës. Konkretisht, përfitues të drejtpërdrejtë të programit do të jenë:<br>• Institucionet e arsimit të lartë që kërkojnë staf akademik me gradë shkencore;<br>• Qendrat kërkimore dhe organizatat që merren me analiza politike, sociale dhe ekonomike;<br>• Administrata publike që ka nevojë për ekspertizë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave;<br>• Organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të që operojnë në Shqipëri dhe rajon;<br><br>Institucioni ka ndjekur një proces të strukturuar dhe të dokumentuar në hartimin e programit doktoral, duke kryer analiza sektoriale dhe vlerësime të situatës në fushat përkatëse, të mbështetura në dokumente strategjike institucionale si Strategjia e Kërkimit Shkencor[23] dhe Plani Strategjik 2021–2025[24]. Programi pasqyron përputhshmëri me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030 si dhe me nevojat e tregut të punës, duke siguruar qëllimshmëri, relevancë dhe impakt të lartë në zhvillimin kërkimor dhe shoqëror. Programi doktoral mbështetet në **Strategjinë e** |

[22] *4. Mission and Labor Market Survey.pdf*
[23] *21.1 Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025.pdf*
[24] *3.6 Planit strategjik 2021-2025, i perditesuar.pdf*

| | |
|---|---|
| | **Kërkimit Shkencor 2021–2025 të UET**, që ndërthur kërkimin me nevojat e tregut dhe vendit. UET zotëron akses në literaturë bashkëkohore dhe në **marrëveshje me institucione ndërkombëtare dhe revista shkencore**, duke siguruar cilësi të lartë në udhëheqjen shkencore dhe metodologjinë e kërkimit. Mekanizmat e zbatimit, monitorimit dhe financimit të kërkimit janë të konsoliduar në strukturat e brendshme të universitetit[25]. |
| **Kriteri 2.** Programi i doktoratës ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e kërkuesve shkencorë me njohuri të thelluara shkencore, aftësi dhe kompetencat në fushën e kërkimit e zbatimit dhe në përputhje me kërkesat dhe nevojat që ka vendi. | Ky program siguron gjithashtu monitorim të rreptë të ecurisë së doktorantëve dhe promovon kërkime të besueshme dhe me përgjegjësi shoqërore, duke u përqendruar në etikën dhe integritetin akademik. Gjatë verifikimit të dokumentacionin, institucioni ka hartuar objektiva te qarta mbi programin doktoral duke e qartësuar se projekti kërkimor "Sjellja e individit dhe aktorëve ekonomik në raport me shtetin dhe shoqërinë" ka për qëllim të analizojë ndryshimet e thella në shoqërinë shqiptare si pasojë e ndryshimit të regjimeve politike dhe procesit të demokratizimit. projekti shqyrton marrëdhëniet midis individit dhe shtetit, regjimin politik aktual, integrimin euroatlantik të Shqipërisë, sistemin ekonomik të tregut të lirë dhe ndikimin e tij në shoqëri, si dhe fenomenet kulturore dhe psikologjike që kanë formuar mentalitetet e reja. Ky projekt është një mundësi e shkëlqyer për të eksploruar fenomene të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që nuk janë studiuar mjaftueshëm në realitetin shqiptar, duke përdorur një metodologji dhe teori të avancuar nga fushat e Shkencave Sociale dhe të Sjelljes[26]. Projekti është ndërtuar në katër drejtimeve të mëdha kërkimore të projektit:<br>*1) "Ekonomiks";*<br>*2) "Shkenca politike dhe edukim qytetar";*<br>*3) "Psikologji";*<br>*4) "Sociologjia dhe studimet kulturore";*<br>Gjithashtu në rregulloren e programit[27] janë përcaktuar qartë në KREU III/STUDIMET E DOKTORATËS pika 3, theksohet qëllimi dhe organizimi i studimeve të doktoratës si dhe nënvizohen disa pika ku ndër to mund të përmendim: |

[25] *1.3 Analizë e prioriteteve të kërkimit shkencor_Shkenca Sociale.pdf*
[26] *1.2 PROJEKTI KËRKIMOR shkenca sociale edhe te sjelljes.pdf*
[27] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| | 3.4 *Studimet e doktoratës, si rregull, organizohen brenda një projekti të madh kërkimor, didaktik, kulturor, kërkimi të pavarur dhe realizohen në koordinim me veprimtaritë e kërkimit të çdo fakulteti apo të universitetit në tërësi. Ato mund të organizohen edhe si programe ndërdisiplinore ose të përbashkëta.*<br><br>3.5 *Studimet e doktoratës përmbajnë veprimtari didaktiko-shkencore të formimit të thelluar teorik, të përvetësimit të metodologjive të kërkimit, të realizuara nëpërmjet moduleve mësimore, seminareve, periudhave të kërkimit etj. Këto veprimtari lidhen me objektivat formues të programit të studimit të doktoratës dhe janë të kontrollueshme.*<br><br>Gjatë viteve 2020–2024, Universiteti Europian i Tiranës ka marrë pjesë në **projekte ndërkombëtare**, kryesisht në kuadër të programit **Erasmus+ CBHE** dhe **Digital Europe**, etj duke kontribuar në fusha prioritare për zhvillimin e arsimit të lartë dhe të shoqërisë shqiptare. Prania e projekteve ndërkombëtare ka një ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e studentëve doktorantë, duke u ofruar atyre mundësi të mëdha për rritjen profesionale dhe kërkimore[28].<br><br>Referuar dhe dokumentit; Përshkrimi i studimeve të doktoratës në "Shkenca Sociale"[29], nënvizohet se Universiteti Europian i Tiranës (UET) është në përputhje të plotë me kërkesat dhe kriteret e Kartës së Bolonjës dhe është universiteti i parë privat në Shqipëri që ofron ciklin e tretë të studimeve. Për UET, kërkimi shkencor, inovacioni dhe mobiliteti i stafit janë një gur themeli dhe pjesë kryesore e strategjisë së zhvillimit institucional. Për të ndërmarrë kërkim shkencor në nivelin më të lartë dhe të orientuar drejt politikave publike, Universiteti Europian i Tiranës bazohet në gamën e gjerë të ekspertizës që ka në shkencat sociale, humane, ekonomike dhe teknologjitë e informacionit, edukimit, dhe komunikimit |
| **Kriteri 3.** Programi i doktoratës hartohet dhe harmonizohet me programe të ngjashme të ofruar nga | Programi i doktoratës është konceptuar në përputhje me programe të ngjashme të institucioneve partnere brenda dhe jashtë vendit, si dhe me udhëzimet e Bashkimit Europian dhe organizmave ndërkombëtarë me të cilët Shqipëria bashkëpunon, |

[28] *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*
[29] *1.1 Përshkrimi i doktorates ne Shkenca Sociale.pdf*

| | |
|---|---|
| institucione partnere vendase apo të huaja, udhëzues, direktiva të BE, të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare me të cilat është partner apo bashkëpunon vendi ynë, me qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor. | me synimin për të forcuar bashkëpunimin dhe për të rritur cilësinë e kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Mbështetur në analizën SWOT gjatë aplikimit për hapjen/riorganizimit e programit të studimit, institucioni argumenton se: me kapacitete të plota logjistike dhe akademike, si dhe me një staf të kualifikuar me tituj shkencorë dhe përvojë në fushë, programi ofron një profil ndërdisiplinar të përshtatur me nevojat e tregut.<br><br>Bashkëpunimi i ngushtë me aktorët e tregut të punës dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve siguron lidhjen midis teorisë dhe praktikës. Gjithashtu, rritja e mundësive për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare për studentët dhe stafin përbën një tjetër avantazh për zhvillimin akademik dhe profesional[30]. Gjithashtu UET ka hartuar një rregullore për shkëmbimet studentore në kuadër të programit erasmus+ dhe diplomave të dyfishta (double degree), ku në pikën 2. Shkruhet: qëllimi i cili bazohet në parimin e lëvizshmërisë për stafin dhe studentët, shkëmbimin e praktikave më të mira midis institucioneve të arsimit të lartë dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet arsimit dhe tregut të punës.<br><br>Një nga veprimtaritë kryesore të Erasmus+ është Key Action 1, e cila ka për qëllim të rrisë lëvizshmërinë për studentët gjatë periudhës së studimeve të tyre dhe stafin akademik/administrativ. Këto aktivitete synojnë nxitjen e njohurive ndërmjet studentëve dhe stafit përmes shkëmbimit të praktikave më të mira, përmirësimit të aftësive të gjuhëve të huaja dhe aftësive përshtatëse me kulturën evropiane[31]. Gjithashtu senati akademik, ka miratuar nje document strategjik[32], mbi bashkëpunimin ndërkombëtar dhe menaxhimin e projektve 23-28, me qëllim ndërkombëtarizimit në fushën e rritjes dhe forcimit të ndërkombëtarizimit të institucionit. Ky dokument është hartuar me mbështetjen e universiteteve europiane partnere, në kuadër të projektit QUADIC të financuar nga Bashkimi Europian. Gjithashtu si më lartë cituar gjatë viteve 2020–2024, Universiteti Europian i Tiranës ka marrë pjesë në **projekte ndërkombëtare**, |

[30] *1.1 Përshkrimi i doktorates ne Shkenca Sociale.pdf*
[31] *10. Rregullore per shkembimet studentore Erasmus dhe diploma te dyfishta_Per studentet.pdf*
[32] *22.3 Strategy for International Cooperation and Project MAnagment 2023-2028'.pdf*

| | |
|---|---|
| | kryesisht në kuadër të programit **Erasmus+ CBHE** dhe **Digital Europe**, etj duke kontribuar në fusha prioritare për zhvillimin e arsimit të lartë dhe të shoqërisë shqiptare. Prania e projekteve ndërkombëtare ka një ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e studentëve doktorantë, duke u ofruar atyre mundësi të mëdha për rritjen profesionale dhe kërkimore[33]. |
| **Kriteri 4.** Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, mobilitetit dhe përfshirjen në veprimtaritë akademike të programit edhe të kërkuesve të huaj, programi i doktoratës mund të aplikohet pjesërisht ose i plotë edhe në gjuhën angleze. | Mbështetur në RVB e institucionit, pohohet se i gjithë profesorati i angazhuar në program kanë një përvojë të gjerë në ligjërimin në gjuhën angleze, kjo rrjedh në kuadër të shkëmbimeve Erasmus+ në universitete të njohura të BE-së, ashtu edhe në institucionet vendase. Gjatë periudhës 2020–2024, janë realizuar shkëmbime të shumta për qëllime mësimdhënieje dhe trajnimi si nga mbikëqyrësit akademikë ashtu edhe nga studentët e doktoraturës. Po ashtu, në kuadër të skemës së mobilitetit Erasmus+, staf akademik nga vendet e BE-së ka dhënë mësim në të gjitha ciklet e studimit në UET, përfshirë edhe programin e doktoratës. Disa shembuj përfshijnë:<br>• kursin "Future of European Integration" nga Petre Andrei University of Iasi (qershor 2024);<br>• ligjërata nga Prof. Asoc. Dr. Eduard Stoica mbi lidhjet historike dhe zhvillimet teknologjike mes Shqipërisë dhe Rumanisë;<br>• analiza të të dhënave nga rrjetet sociale nga Prof. Asoc. Dr. Razvan Serbu;<br>• metodologji kërkimi nga Prof. Carla Cristina Esteves (University of Minho) dhe Prof. Sonia de Sa (Rumani);<br>Kjo përvojë dëshmon për dimensionin ndërkombëtar dhe cilësinë akademike të programit[34], [35], [36], [37], [38], [39], [40], [41], [42]. |

[33] *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*
[34] *10.2 Call for Erasmus Exchange Doctoral Studies_Valadolid.pdf*
[35] *10.3 Call for Erasmus Exchange Doctoral Studies_Saarland.pdf*
[36] *10.4 Thirrje Erasmus_ University of Almeria - PhD students - 24-25.pdf*
[37] *10.5 Erasmus + Prof. Sónia de Sá - Teaching at the Doctoral School 2024.pdf*
[38] *10.6 18 prill _ Pitch Training-Horizon.pdf*
[39] *10.7 Trajnim Longitudinal Research and Observational Methodology_MAY 2023.pdf*
[40] *10.9 trajnim per përdorimin e software ZOTERO.pdf*
[41] *10. Rregullore per shkembimet studentore Erasmus dhe diploma te dyfishta_Per studentet.pdf*
[42] *22.5 Staff and Doctoral Student Exhange KA 171 2020-2024.pdf*

| Konkluzione | *Bazuar në materialet e paraqitura deri më tani, programi i doktoratës në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes i Universitetit Europian të Tiranës përmbush standardet e kërkuara. Programi është i përputhur me prioritetet kombëtare dhe zhvillimet socio-ekonomike të vendit, përfshin objektiva të qarta të të nxënit, mbështetet në kërkime të strukturuara dhe në përfshirjen e etikës akademike.*<br><br>*UET ka kapacitete të konsoliduara akademike dhe logjistike, përvojë pozitive në ofrimin e studimeve doktorale, staf me kualifikime të larta, si dhe bashkëpunime të gjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Prania e projekteve kërkimore ndërkombëtare dhe përfshirja aktive në mobilitetet Erasmus+ rrit cilësinë akademike dhe ndërkombëtarizimin e programit. Gjithashtu, programi ofrohet edhe në gjuhën angleze, duke mundësuar përfshirjen e kërkuesve dhe lektorëve të huaj.* |
|---|---|

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.4**<br><br>**Programi i doktoratës organizohet në përputhje me fushën akademike të njësisë përgjegjëse për programin.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i doktoratës organizohet në nivel njësie bazë ose njësie kryesore të cilat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe ecurinë e tij. | Programi i doktoratës organizohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara në kuadër të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Përmes bashkëpunimit me njësi të tjera të UET-it, si qendrat kërkimore dhe departamenti i ekonomisë, sigurohet ekspertiza e nevojshme për mbulimin e të gjitha nënfushave studimore të programit. Bazuar në rregulloren e doktoraturës[43] pika 4.4 *Grupi kërkimor mund të përbëhet nga anëtarë të personelit të një njësie bazë ose të disa njësive bazë. Në këtë rast njësia bazë përgjegjëse është njësia bazë e drejtuesit të grupit kërkimor.* |

[43] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| | Referaur RVB mbështetur në një marrëveshje bashkëpunimi[44], programi i doktoratës në Universitetin Europian të Tiranës (UET) është një iniciativë ndërdisiplinare e organizuar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, në bashkëpunim me njësi të tjera si Departamenti i Ekonomisë dhe Financës, Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm, Qendra për Metodologji dhe Kërkime Shkencore, Qendra për Kërkime Shkencore në Shëndetin Publik dhe Qendra për Studime Kulturore dhe Edukim Qytetar. Ky bashkëpunim ndërinstitucional siguron ekspertizën e nevojshme akademike dhe kërkimore për të mbuluar të gjitha nënsferat specifike të studimit të programit të doktoratës. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse ka profilin, përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të doktoratës. | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës, është Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara në UET, e cila zotëron profilin e duhur akademik, përvojën shumëvjeçare në fushën e kërkimit shkencor dhe kapacitete të mjaftueshme njerëzore, infrastrukturore dhe bashkëpunuese për ofrimin cilësor të këtij programi.<br><br>Ajo mbështetet gjithashtu nga qendrat kërkimore dhe departamente të tjera të universitetit, duke garantuar mbulim të plotë të fushës dhe cilësi akademike të lartë. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, si njësi përgjegjëse, demonstron një profil të konsoliduar akademik dhe kërkimor në fushën e shkencave sociale dhe të sjelljes.<br><br>Kjo njësi ka ndërtuar një bashkëpunim të gjerë me qendra kërkimore dhe departamente të tjera brenda UET, duke krijuar një rrjet institucional që mbulon në mënyrë të plotë dhe të integruar fushat e specializimit që përfshin programi. Prania e një stafi akademik[45] me grada shkencore dhe përvojë në drejtimin e kërkimeve doktorale, si dhe angazhimi i tyre në botime shkencore dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare, siguron cilësi dhe qëndrueshmëri në ofrimin e programit[46].<br><br>Përfshirja aktive në projekte[47] si Erasmus+, Jean Monnet dhe READ, si dhe bashkëpunimet me institucione të huaja, e |

[44] *22. Marreveshje Bashkepunimi Qendrat dhe Departamenti _UET.pdf*
[45] *Shih cv e stafit akademik nga aneks 25.1 deri tek aneks 25.29*
[46] *21.10 Lista e revistave ne Scopus - 2024_Njoftim Orientues.pdf*
[47] *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*

| | |
|---|---|
| | pozicionojnë këtë njësi si një aktor të rëndësishëm në kërkimin dhe arsimin e lartë në Shqipëri. Kjo demonstron jo vetëm kapacitetet ekzistuese, por edhe angazhimin për zhvillim të vazhdueshëm institucional dhe akademik. Gjithashtu, përvoja e mëparshme e UET në ofrimin e studimeve doktorale dhe vlerësimi pozitiv nga autoritetet akredituese përbëjnë një garanci të shtuar për përmbushjen e standardeve të cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të doktoratës është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. | Duke u bazuar në informacionin e dhënë, fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të doktoratës duket se është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit. Programi është organizuar sipas klasifikimit ndërkombëtar të arsimit ISCED dhe ndjek direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane[48]. Për më tepër, ndarja e fushave të studimit dhe mbulimi i nënfushave të ndryshme të shkencave sociale, si ekonomia, shkenca politike, psikologjia, dhe sociologjia[49], tregon një strukturë të mirë-organizuar dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të kërkimit dhe arsimit. Kjo i mundëson programit të ofrojë një bazë të fortë për zhvillimin e kërkimeve shkencore të avancuara dhe kontribuon në forcimin e lidhjeve ndërkombëtare në fushën e shkencave sociale. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera, fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të doktoratës është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive përgjegjëse në institucionet respective. | **N / A** |
| **Konkluzione** | *Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, vlerësohet që programi i doktoratës i UET ka arritur të përmbushë kërkesat dhe standardet e përcaktuara për program doktoral. Ky program* |

[48] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[49] *1.2 PROJEKTI KËRKIMOR shkenca sociale edhe te sjelljes.pdf*

| | |
|---|---|
| | *ka një qasje të theksuar ndërdisiplinare dhe është i përputhshëm me prioritetet kombëtare dhe europiane për zhvillimin e kërkimit shkencor.*<br><br>*Gjithashtu, është mbështetur nga një staf akademik me përvojë të pasur në kërkimin shkencor dhe angazhime ndërkombëtare, si dhe ofron mundësi për mobilitet dhe bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe angazhim në projekte të nivelit të lartë.*<br><br>*Në përputhje me këto përmbushje, programi ka siguruar një cilësi të lartë në mësimdhënie, kërkim dhe zhvillim profesional, duke kontribuar pozitivisht në fushën e Shkencave Sociale dhe të Sjelljes.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT DOKTORAL

| **Standardi II.1**<br><br>**Organizmi i programit bazohet në rregullore dhe udhëzues të posaçëm të programit të doktoratës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse për organizimin, zhvillimin e programit të doktoratës, përcakton në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programit të doktoratës dhe i përditëson ato në | Njësia përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e programit të doktoratës ka përcaktuar rregullat dhe procedurat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e programit. Këto rregulla janë të përditësuara vazhdimisht për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. Ato mbulojnë aspekte të ndryshme të procesit të mësimdhënies, mbështetjes kërkimore, vlerësimit të studentëve, si dhe bashkëpunimit me institucione të tjera akademike dhe profesionale. Përditësimi i rregullave synon |

| | |
|---|---|
| funksion të përmirësimit të cilësisë së tij. | rritjen e efikasitetit dhe cilësisë, duke pasur parasysh zhvillimet e reja në fushën e shkencave sociale dhe kërkimeve ndërkombëtare. *Shih: "Rregullore për organizimin e studimeve të doktoratës në "shkenca sociale dhe të sjelljes, kreu 3, pika 3"*[50]. |
| **Kriteri 2.** Elementët e organizimi të programit, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet, përcaktohen në rregulloren e tij dhe në akte të tjera të miratuara nga institucioni. | Elementët kryesorë të propozimit doktoral përfshijnë një përmbledhje të detajuar të kërkimit shkencor që do të zhvillohet[51]. Tek dokumenti doktoral i paraqitur në dosjen e vetvlerësimit janë përfshin disa pjesë kyçe si: *Hyrja dhe aspekti teorik*, *Deklarimin e problemit*, *Shqyrtimin e literaturës*, *Qëllimin e studimit*, *Pyetjet dhe/ose hipotezat*, *Dizenjimin e metodave dhe procedurave*, si dhe *Analizën e limitimeve dhe delimitimeve të studimit*. Gjithashtu elementët citohen dhe në rregulloren e programit të doktoraturës në KREU IV/ STUDIMEVE TË DOKTORATËS[52]<br><br>*Shih dhe aneks PROJEKTI KËRKIMOR shkenca sociale edhe te sjelljes.pdf;*<br>*Shih dhe aneks Analizë e prioriteteve të kërkimit shkencor_Shkenca Sociale.pdf;*<br>*Shih dhe Broshura e Dokumenteve A I and A II.pdf (plagjiatura, manipulimi, etj)*<br>*Shih dhe Kodi i Etikes.pdf;* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse harton dhe miraton manuale, udhëzues ose modele që shërbejnë si shembuj me elementët që duhet të përmbajë projekt propozimi. | Njësia përgjegjëse ka hartuar, miratuar dhe shpërndarë manuale, udhëzues dhe modele standarde që shërbejnë si orientim për përgatitjen e propozimeve kërkimore, duke siguruar qartësi, njëtrajtshmëri dhe cilësi në përmbajtje dhe formë. Në këtë kuadër mund të përmendim disa dokumente si:<br>a) Rregullorja e programit të doktoraturës[53] në KREU V/ PROCESET DHE DETYRIMET AKADEMIKE tek pika 6.3 Rregullat për paraqitjen e punimit dhe etika e kërkimit shkencor.<br>b) Guidelines on 'Ethics of Using Turnitin' for Administrators[54]. |

[50] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[51] *2.3 Elementet kryesore te propozimit doktoral.pdf*
[52] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[53] *Ibid*
[54] *21.3.1 Guidelines on Turnitin.pdf*

| | |
|---|---|
| | Sic e permendem dhe ne kriterin 2, dokumenti me elementët kryesore të propozimit doktoral[55] është një udhëzues i mirë për studentët. Më poshtë renditen disa formulare dhe formate për të orientuar studentët gjatë studimeve doktorale.<br>*Shih dhe aneks 2.4 Formulari i Propozimit Doktoral.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.2.10 Formati i Raportimit te Dites Doktorale.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.2.8 Formati i raportimit te punes kerkimore shkencore.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.5 Mbi punimin e diplomës_Doktorature.pdf* |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse harton dhe miraton udhëzues, modele për raportimin, vlerësimin dhe arritjet e doktorantëve gjatë gjithë vitit akademik dhe të studimeve. | Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara ka ndërtuar një sistem të strukturuar dhe të standardizuar për të monitoruar dhe vlerësuar progresin akademik të doktorantëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Nëpërmjet udhëzuesve dhe modeleve të miratuara nga njësia përgjegjëse, sigurohet raportimi i rregullt dhe gjithëpërfshirës i arritjeve akademike, që nga angazhimet teorike dhe metodologjike, pjesëmarrja në konferenca dhe publikime, deri te dorëzimi dhe mbrojtja e disertacionit. Vlerësimi bazohet në instrumente të qarta si raportet vjetore të progresit, Ditët Doktorale[56] dhe formate të posaçme të ecurisë, të cilat mbështeten nga takime periodike me udhëheqësin dhe struktura të tjera akademike. Një element i veçantë i këtij procesi është "Mbrojtja e Bardhë", një mbrojtje paraprake e disertacionit përpara se ai të paraqitet për mbrojtje finale, që ka për qëllim të garantojë cilësinë dhe pjekurinë shkencore të punës kërkimore[57],[58],[59],[60],[61].<br><br>*Shih dhe aneks 2.2.10.2 Liste Prezence Dite Doktorale.pdf* |

[55] *2.3 Elementet kryesore te propozimit doktoral.pdf*
[56] *2.2.1 Dita e I-re Doktorale.pdf*
[57] *6. Kerkimi Shkencor_Broshura e Dokumentave.pdf*
[58] *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*
[59] *30. Seancat e takimeve të grupeve kërkimore.pdf*
[60] *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*
[61] *2.2.9 Kolokiumi Doktoral.pdf*

| | |
|---|---|
| | *Shih dhe aneks 2.2.10 Formati i Raportimit te Dites Doktorale.pdf* |
| **Kriteri 5**. Njësia përgjegjëse harton dhe miraton udhëzues për hartimin e disertacionit, referimeve, prezantimeve, kontrollit të plagjiaturës. | Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara ka vendosur një kuadër të qartë dhe të strukturuar për të udhëzuar doktorantët dhe stafin akademik në çdo aspekt të hartimit dhe dorëzimit të disertacionit. Nëpërmjet udhëzuesve të miratuar nga njësia përgjegjëse, sigurohen standarde të detajuara për formatimin, strukturimin e punës kërkimore[62],[63],[64], etikën akademike,[65],[66] *(Shtrembërimi i të dhënave akademike: Duke ndryshuar/ndërhyrë në përmbajtjen, formën e të dhënave akademike të personelit, ose të studentëve (shembull: ndryshimi i të dhënave zyrtare, i notave, i shënimeve për prezencën nga dokumentet zyrtare të Universitetit; ndërhyrja në sistemet bazë të të dhënave elektronike/digiitale të Universitetit si dhe në çdo pajisje elektronike (kompjuter) që përmban të dhëna akademike ose administrative të stafit ose të studentëve, falsifikimi i të dhënave akademike në dokumentet e dikujt, ose të diplomës/ave)*[67],[68] si dhe procedurat e prezantimit dhe mbrojtjes së tezës.<br><br>Udhëzimet përfshijnë gjithashtu kritere mbi origjinalitetin dhe kontributin shkencor të punës, kërkesat për miratimin paraprak nga udhëheqësi shkencor dhe detaje teknike si faqosja dhe elementët formalë të kopertinës. Kontrolli i plagjiaturës[69] përbën një komponent thelbësor të këtij procesi dhe realizohet në përputhje me Kodin e Integritetit Akademik të Universitetit Europian të Tiranës dhe udhëzimet specifike për interpretimin e raporteve të Turnitin[70]. Këto standarde janë të dokumentuara në Rregulloren e Programit të Doktoraturës[71] dhe në Dokumentin |

62 *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
63 *2.4 Formulari i Propozimit Doktoral.pdf*
64 *2.5 Mbi punimin e diplomës_Doktorature.pdf*
65 *3. Statuti i UET.pdf*
66 *3.4 Rregullore e UET.pdf*
67 *3.5 Kodi i Etikes.pdf*
68 *3.5.2 Rregullat e Etikes Shtocje 1.pdf*
69 *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*
70 *21.3.1 Guidelines on Turnitin.pdf*
71 *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| | B.I të broshurës zyrtare[72], duke garantuar transparencë dhe një praktikë të unifikuar në menaxhimin e punës kërkimore.<br>*Shih dhe aneks 6. Kerkimi Shkencor_Broshura e Dokumentave.pdf* |
| **Kriteri 6.** Institucioni dhe njësia përgjegjëse harton tregues të matshëm lidhur me plagjiaturën bazuar në fushën e kërkimit dhe studimit, si dhe referenca lidhura me to duke u kujdesur që niveli i ngjashmërisë së disertacionit dhe punimeve shkencore të doktorantit të jenë nën 30%. | Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara kanë zhvilluar një mekanizëm të qartë dhe të matshëm për të garantuar integritetin akademik në punimet kërkimore të doktoraturës[73], në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Çdo disertacion i nënshtrohet analizës për plagjiaturë përmes sistemit Turnitin[74], i cili gjeneron një indeks ngjashmërie në përqindje. Në përputhje me Rregulloren e Universitetit[75], kufiri maksimal i pranueshëm për ngjashmërinë e përgjithshme është vendosur në ose nën 20%, ndërkohë që rastet që e tejkalojnë këtë prag i nënshtrohen rishikimit të detajuar dhe korrigjimeve të domosdoshme përpara dorëzimit përfundimtar.<br>Zyra e Studimeve të Doktoraturës dhe udhëheqësit shkencorë shqyrtojnë raportin e ngjashmërisë për të përjashtuar përputhjet e justifikueshme, si citime të referuara dhe fraza të zakonshme[76]. Për të forcuar ndërgjegjësimin dhe respektimin e normave të etikës shkencore, institucioni ka miratuar udhëzime të posaçme për studentët dhe stafin, organizon rregullisht trajnime mbi teknikat e parafrazimit dhe standardet e citimeve, si dhe ka përfshirë sanksione të qarta në Kodin e Etikës[77] për rastet e plagjiaturës. Kjo qasje e integruar dhe e mbështetur në instrumente të matshëm garanton besueshmërinë dhe cilësinë e prodhimit shkencor brenda programit të doktoraturës[78]. |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka ndërtuar një sistem të qartë, të dokumentuar dhe të zbatueshëm për kontrollin e plagjiaturës dhe ruajtjen e integritetit akademik në nivel doktorature.* |

[72] *2.5 Mbi punimin e diplomës_Doktorature.pdf*
[73] *3.5 Kodi i Etikes.pdf*
[74] *21.3.1 Guidelines on Turnitin.pdf*
[75] *3.4 Rregullore e UET.pdf*
[76] *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*
[77] *3.5 Kodi i Etikes.pdf*
[78] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Pragu i ngjashmërisë është i përcaktuar në mënyrë të matshme, procedurat janë të strukturuara, dhe ekzistojnë udhëzime të shpërndara për stafin dhe studentët.*<br>*Gjithashtu, janë të dukshme mekanizmat mbështetës si trajnime, verifikime paraprake dhe dispozita disiplinore në rast shkeljeje.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Përmbajtja e programit të doktoratës organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në udhëzues të hapësirës evropiane në arsimin e lartë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i doktoratës mund të përmbajë si pjesë të tij, lëndë të formimit teorik deri në 30 ECTS të cilat realizohen në vitin e parë të programit. | Programi i doktoraturës në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes është ndërtuar në përputhje me standardet kombëtare, duke përfshirë elemente të formimit teorik gjatë vitit të parë të studimeve, me një ngarkesë totale prej 20 ECTS. Kjo përfshin kurse të detyrueshme në metodologjinë e kërkimit në shkencat sociale dhe të sjelljes (5 ECTS), si dhe në teoritë bashkëkohore të fushës (5 ECTS), duke garantuar një bazë solide konceptuale dhe analitike për kandidatët[79].<br>Gjithashtu, një komponent i rëndësishëm është Provimi Përfundimtar (10 ECTS), i cili lidhet drejtpërdrejt me fushën kërkimore të secilit doktorant dhe siguron vlerësim të personalizuar dhe të thelluar të njohurive të fituara[80]. Në përputhje me kuadrin rregullator, programi respekton kufirin maksimal prej 30 ECTS për formimin teorik, duke vendosur një ekuilibër të duhur ndërmjet përgatitjes akademike dhe angazhimit kërkimor.<br>*Shih dhe aneks 3.4.4 Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës _Doktorature.pdf* |

[79] *2.16.1 Syllabus Doctoral Seminar in Research Methods in Social and Behavioural Studies 2022-2023.pdf*
[80] *2.2.9 Kolokiumi Doktoral.pdf*

| | |
|---|---|
| | *Shih dhe aneks 2.16.1 Syllabus Doctoral Seminar in Research Methods in Social and Behavioural Studies 2022-2023.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.16.1 Syllabus Doctoral Seminar in Research Methods in Social and Behavioural Studies 2023-2024.pdf* |
| **Kriteri 2.** Kohëzgjatja e normale e programit të doktoratës është 3 deri në 5 vite akademike dhe jo më shumë se dyfishi i kohës normale të saj. | Kohëzgjatja e programit të doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës është përcaktuar qartë në rregulloren përkatëse, duke respektuar standardet ligjore dhe praktikat më të mira në këtë fushë. Në Kreu III / Studiet doktorale, pika *3.3 Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor".* Programi parashikon një periudhë normale studimi prej tre deri në pesë vite akademike, me mundësi pezullimi për arsye të justifikuara deri në dy vite, me vendim të Komisionit të Dhënies së Diplomës.<br>Për kandidatët që ndjekin programin me kohë të zgjatur për shkak të angazhimeve profesionale akademike ose kërkimore, afati i përfundimit është i zgjatur deri në pesë vite[81]. Aktualisht nuk ka raste të pezullimit të studimeve apo diplomimi, por monitorimi i vazhdueshëm nga Departamenti dhe Zyra për Studime Doktorale garanton ndjekjen e progresit të kandidatëve dhe respektimin e afateve të parashikuara për mbrojtjen e tezës *(4.6. Zyra e Studimeve Doktorale ngrihet në nivel Universiteti, me vendim të Rektorit, i cili përcakton numrin e personelit dhe strukturën e saj. Ajo sherben si një "sportel unik" për të gjithë aspektet administrative dhe dokumentare të studimeve të doktoratës në UET).* |
| **Kriteri 3.** Përmbajtja e programit, organizimi, vlerësimi dhe monitorimi përafrohen me shembuj të ngjashëm në institucione ndërkombëtare të hapësirës evropiane të arsimit të lartë. | Programi i doktoraturës është konceptuar dhe zbatuar në përputhje me parimet dhe standardet e përcaktuara nga ESG 2015 (Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë), duke reflektuar përafrimin substancial me praktikat e institucioneve homologe në hapësirën EHEA[82]. Përmbajtja e programit, organizimi, mekanizmat e vlerësimit dhe të monitorimit akademik janë ndërtuar në përputhje me këto udhëzime, duke garantuar transparencë, |

[81] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[82] *17.1 Strategjia-per-sigurimin-e-cilesise-2023-2028.pdf*

| | |
|---|---|
| | koherencë dhe qëndrueshmëri cilësore[83]. Gjithashtu, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve ndërkombëtare, institucioni ka ndjekur një qasje aktive për të integruar praktika të mira të huaja në programin e tij, duke forcuar dimensionin ndërkombëtar dhe krahasueshmërinë e tij akademike. Mbështetur dhe në *21.1 Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025.pdf pika 13. Këkrimi, Zhvillimi dhe Transferimi I teknologjisë.* |
| **Kriteri 4.** Nëse programi i doktoratës përfshin formimin teorik, lëndët fokusohen në strukturimin e kërkimit shkencor të thelluar, metodave cilësore dhe sasiore të përpunimit të të dhënave, etikës së kërkimit shkencor dhe shkrimit të punimeve shkencore e të disertacionit të doktoratës. | Programi i doktoraturës në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes përmban një komponent të mirëstrukturuar të formimit teorik, i cili fokusohet në ndërtimin e kapaciteteve kërkimore të avancuara të kandidatëve. Përmes modulit të dedikuar mbi metodologjinë e kërkimit shkencor, studentët përfshihen në një trajnim të plotë mbi konceptimin, operacionalizimin dhe matjen e variablave kërkimorë, si dhe në përdorimin e metodave cilësore dhe sasiore për mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Silabusi përfshin gjithashtu tematika thelbësore mbi etikën e kërkimit, analizën e diskursit, eksperimentet dhe vlefshmërinë e tyre, si dhe teknika të avancuara statistikore, përfshirë regresionin linear dhe logjistik. Ky përmbajtje pasqyron një qasje të integruar dhe të përditësuar, e cila synon pajisjen e doktorantëve me aftësi të thella analitike dhe praktike në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe në përgatitjen e disertacionit të tyre.<br><br>*Shih dhe aneks 2.16.1 Syllabus Metoda Kerkimi 2022_2023.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.16.1Syllabus Theories and Contemporary debates in social and behavioural studies 2022-2023.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.16.2 Syllabus Metoda Kerkimi 2023_2024.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.16.3 Syllabus Teori dhe debate 2022_2023.pdf* |
| **Kriteri 5.** Nëse programi i doktoratës përfshin formimin teorik, lëndët përmbajnë njohuri të avancuara të debateve teorike, përqasjeve kërkimore, bashkëpunimeve | Programi i doktoratës siguron një përmbajtje të avancuar teorike përmes modulit "Teori dhe debatet bashkëkohore në shkencat sociale dhe të sjelljes", i cili trajton një gamë të gjerë çështjesh aktuale dhe ndërdisiplinore, duke përfshirë paradigma të reja teorike në ekonomi dhe ekonomi politike, qasje mbi institucionet politike dhe qeverisjen, sfida të reja të sigurisë, si dhe zhvillimet më të fundit në antropologji, psikoterapi, neuroshkencë dhe |

[83] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| ndërdisiplinore dhe zhvillimeve të fundit të fushës shkencore të doktorantit. | pedagogji. Këto tematika pasqyrojnë përpjekjen për të mbajtur studentët të përditësuar me zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse shkencore dhe për të nxitur një kuptim të thelluar e kritik të debateve teorike bashkëkohore. Lënda nxit integrimin e përqasjeve të ndryshme kërkimore dhe eksplorimin e bashkëpunimeve ndërdisiplinore, duke ndihmuar doktorantët të pozicionojnë kërkimin e tyre në kontekste më të gjera teorike dhe praktike.<br><br>*Shih dhe aneks 2.16.3 Syllabus Theories and Contemporary debates in social and behavioural studies 2023-2024.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.16.4 Syllabus - Teori dhe debate bashkekohore - Doktorature - english2023-2024.pdf*<br>*Shih dhe aneks 2.16.4 Syllabus Teori dhe debate 2023_2024.pdf*<br>*Shih dhe* 24.2 Orari Mesimor Doktorate 2023_2024 .pdf |
| **Kriteri 6.** Kur aplikohet, lëndët e formimit teorik të doktoratës vlerësohen me provim/e teorik në fushën përkatëse të studimeve, të organizuar nga personeli akademik i programit. Procedura e vlerësimit të njohurive të formimit teorik, të drejtat dhe detyrimet, përcaktohen në rregulloren e programit të doktoratës. | Procesi i vlerësimit të provimeve në programin e doktoratës është dizajnuar për të siguruar një mbikëqyrje të thelluar dhe një nivel të lartë përgatitjeje teorike dhe metodologjike të studentëve[84]. Provimi gjithëpërfshirës në fund të vitit të parë është një moment kyç për doktorantët, pasi teston aftësinë e tyre për të integruar dhe aplikuar njohuritë e fituara gjatë periudhës së parë të studimeve. Provimi i jep mundësinë studentëve të tregojnë se kanë arritur të kuptojnë thelbin e kërkimit shkencor dhe janë të gatshëm për sfidat e mëtejshme akademike[85].<br><br>Vlerësimi me sistemin **kalon/dështon** është i thjeshtë dhe efikas, duke përqendruar vëmendjen te standardet e kërkuara për të kaluar me sukses[86]. Në të njëjtën kohë, procedura e apelimit dhe mundësia për të kërkuar informacion të detajuar për rezultatet e provimeve e rrit transparencën dhe ndihmon në sigurinë se çdo provim është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive[87]. Ky sistem i organizuar mirë i vlerësimit dhe mbikëqyrjes është një pjesë thelbësore e strukturës akademike të programit[88], duke garantuar që doktorantët të jenë plotësisht të përgatitur për |

[84] *2.16.1 Syllabus Doctoral Seminar in Research Methods in Social and Behavioural Studies 2022-2023.pdf*
[85] *13.5 Mbi zhvillimin e provimit perfundimtar CE - 15 shtator 2023.pdf*
[86] *13.4 Per Provimin e Pergjithshem Perfundimtar CE_derguar me 9 shtator 2023.pdf*
[87] *3.4 Rregullore e UET.pdf*
[88] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| | kërkimet e tyre të mëtejshme dhe për të kontribuar me punë shkencore të cilësisë së lartë.<br><br>*Shih dhe aneks 11. Mesimdhenia dhe vleresimi.pdf*<br>Shih dhe aneks *20.1 Strategjia Student Centred Learning Teaching and Assessment Policy.pdf* |
| **Kriteri 7.** Në kuadër të përmirësimit të programit, njësia përgjegjëse ka të drejtën e ndryshimeve në përmbajtje të formimit teorik të programit të doktoratës, dokumenton procedurën dhe informon ministrinë përgjegjëse për arsimin. | Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara luan një rol kyç në këtë proces, duke bashkëpunuar me njësitë e tjera të Universitetit Europian të Tiranës (UET) dhe duke koordinuar përgatitjen e dokumenteve përkatëse. Ky departament është i vetëdijshëm për rëndësinë e përditësimit të programit, duke siguruar që ai të qëndrojë në harmoni me zhvillimet në fushat e studimit dhe kërkimit. Përditësimet dhe ndryshimet në programin e doktoratës janë të dokumentuara dhe të mbështetura në procedura të qarta dhe transparente, të cilat janë të përcaktuara në aktet rregullatore të universitetit dhe në aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Kjo siguron që çdo ndryshim të bëhet në përputhje me ligjet dhe standardet e arsimit të lartë në Shqipëri. Duke qenë se programi është ende i ri, deri më tani nuk ka pasur ndryshime të mëdha, por procesi i përmirësimit është i hapur dhe i gatshëm për adaptim në çdo kohë, për të garantuar cilësinë dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat moderne të arsimit dhe kërkimit shkencor.<br><br>*Shih Rregullore Për Organizimin e Studimeve të Doktoratës në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes KREU III STUDIMET E DOKTORATËS 3. Qëllimi dhe organizimi i studimeve të doktoratës[89], ".*<br>*Shih dhe aneks 22. Marreveshje Bashkepunimi Qendrat dhe Departamenti _UET.pdf*<br>*Shih dhe aneks 22.2 Lista e institucioneve bashkëpunuese per programin e doktoratës.pdf* |
| **Konkluzione** | *GVJ, në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit të kërkuar për programin e doktoratës, ka evidentuar një përmbushje të plotë të kërkesave të vendosura në aktet rregullatore dhe ligjore. Programi është ende në fazën e tij të* |

[89] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *hershme dhe, deri tani, nuk janë bërë ndryshime substanciale në përmbajtjen e tij.*<br><br>*Megjithatë, departamenti është i vetëdijshëm për nevojën e përditësimit të përmbajtjes teorike dhe metodologjike, dhe ka një procedurë të qartë për realizimin e këtyre ndryshimeve, të cilat dokumentohen dhe koordinohen me njësitë përkatëse të universitetit dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin. Ky proces siguron se programi i doktoratës do të vazhdojë të përmbushë standardet akademike dhe kërkesat e zhvillimeve shkencore në fushat përkatëse të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br><br>**Programi i doktoratës organizohet bazuar në projekte kërkimi dhe zhvillimi dhe harmonizohet me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe prioritetet e kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i doktoratës është pjesë e politikës institucionale të zhvillimit të kërkimit shkencor dhe ndërtohet në formën e një projekti afatgjatë kërkimi dhe zhvillimi në fushën e caktuar. | Programi i Doktoraturës në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes në UET përmbush në mënyrë të plotë standardin e integrimit institucional të kërkimit shkencor, duke u ndërtuar si pjesë përbërëse e politikës afatgjatë të universitetit për zhvillimin akademik dhe shkencor. Ai është i përfshirë në mënyrë organike në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021–2025 të UET[90],[91], që synon inovacionin, ndikimin social dhe kërkimin e orientuar drejt tregut. Programi shërben si një shtyllë qendrore në programin e madh shkencor të universitetit, duke kontribuar në projektet kërkimore prioritare dhe duke adresuar sfida të rëndësishme të transformimit socio-ekonomik në Shqipëri[92]. Me projektin e tij afatgjatë kërkimor mbi sjelljen e individëve dhe aktorëve ekonomikë ndaj shtetit dhe shoqërisë, programi demonstron një përqasje ndërdisiplinore dhe ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e politikave. Në këtë mënyrë, programi jo vetëm që |

[90] *3.6 Planit strategjik 2021-2025, i perditesuar.pdf*
[91] *5. Development Strategy of the Doctoral Program Social And Behavioural Studies.pdf*
[92] *8. Politika e kerkimit shkencor 2021-2025.pdf*





| | |
|---|---|
| | forcon kapacitetet kërkimore të UET-së, por gjithashtu përputhet me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në rritjen e profilit të arsimit të lartë dhe të shkencës shqiptare në kontekstin global[93]. |
| **Kriteri 2.** Projekti i doktoratës mund të hartohet me iniciativë individuale nga personeli akademik, nga grupi kërkimor i njësisë bazë, nga institucioni apo si propozim nga partnerë të jashtëm me të cilët institucioni bashkëpunon. | Institucioni ka hartuar një sërë dokumentash dhe rregulloresh që i lejon studentët, stafin apo grupin kërkimor të kenë mundësi të ideojnë dhe hartojnë me inciativën e tyre projekt propozimet e tyre doktorale. Kryesisht, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara së bashku me grupet kërkimore të brendshme dhe partnerët e jashtëm, kanë krijuar hapësirat e duhura për doktorantët dhe udhëheqësit shkencorë të orientohen drejt zgjidhjeve të aplikueshme[94],[95]. Ky pozicionim e bën programin e doktoraturës jo vetëm aktual, por edhe me ndikim të matshëm në proceset transformuese të vendit.[96]<br>*Shih dhe aneks 1.3 Analizë e prioriteteve të kërkimit shkencor_Shkenca Sociale.pdf* |
| **Kriteri 3.** Fusha kryesore dhe specifike e hulumtimit/kërkimit përzgjidhet në mënyrë të tillë që të jetë pjesë e fushës së studimeve të njësisë përgjegjëse. | Projekti i doktoraturës "Sjellja e individëve dhe aktorëve ekonomikë në raport me shtetin dhe shoqërinë" është plotësisht i përputhshëm me fushën e studimeve të njësisë përgjegjëse – Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara – duke u ndërtuar mbi bazën e disiplinave që ky departament mbulon, si shkencat politike, sociologjia, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe metodat e kërkimit[97]. Projekti është konceptuar në mënyrë të qëllimshme për të nxitur qasje ndërdisiplinore, duke përfshirë dimensione të ndryshme sociale, ekonomike, politike, psikologjike dhe kulturore, të cilat ndodhen brenda kompetencave akademike të njësisë[98]. Më tej, ekspertiza e nevojshme për trajtimin e këtyre çështjeve komplekse thellohet përmes bashkëpunimit me njësi të tjera akademike partnere |

[93] *22. Marreveshje Bashkepunimi Qendrat dhe Departamenti _UET.pdf*
[94] *21.1 Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025.pdf*
[95] *1.2 PROJEKTI KËRKIMOR shkenca sociale edhe te sjelljes.pdf*
[96] *1.1 Përshkrimi i doktorates ne Shkenca Sociale.pdf*
[97] *1.2 PROJEKTI KËRKIMOR shkenca sociale edhe te sjelljes.pdf*
[98] Përshkrimi i studimeve të doktoratës në "Shkenca Sociale"

| | |
|---|---|
| | brenda institucionit, duke garantuar kështu koherencë tematike dhe shkencore në përmbajtjen e programit të doktoratës[99],[100]. |
| **Kriteri 4.** Projekt propozimi i njësisë përgjegjëse, shqyrtohet nga Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor". | Procesi i miratimit të projekt-propozimeve brenda programit të doktoratës ndjek një strukturë të qartë institucionale që garanton cilësinë dhe përputhjen me standardet akademike. Çdo projekt i ri kërkimor i propozuar nga anëtarët e fakultetit dhe që synon të bëhet pjesë e programit të doktoraturës shqyrtohet fillimisht nga Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Ky komision vlerëson përmbajtjen shkencore, përshtatshmërinë tematike dhe përputhjen me objektivat e përgjithshme të programit. Pas këtij shqyrtimi fillestar, projekt-propozimi i kalon për miratim përfundimtar Senatit Akademik, duke siguruar një kontroll të shumëfishtë institucional për integritetin dhe cilësinë e kërkimit të integruar në program[101]. |
| **Kriteri 5.** Kandidati që kërkon të pranohet në programin e studimeve të doktoratës harton projektin individual për një fushë të veçantë kërkimi e cila përfshihet në projektin e doktoratës dhe e analizon atë gjerësisht në dokumentet e aplikimit. | Procesi i pranimit në programin e doktoraturës përfshin hartimin nga kandidati të një projekti individual kërkimor që lidhet ngushtësisht me tematikën dhe objektivat e projektit të përgjithshëm të doktoratës. Ky projekt individual përbën një komponent qendror të dokumentacionit të aplikimit dhe analizohet në mënyrë të hollësishme për të vlerësuar potencialin kërkimor dhe përputhshmërinë shkencore të kandidatit[102]. Çdo vit, grupi kërkimor shpall temat dhe projektet prioritare ku do të përfshihen kandidatët, duke udhëhequr procesin e përzgjedhjes në bashkëpunim me drejtuesin e Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara[103]. Përzgjedhja bazohet në kritere të përcaktuara dhe përfundon me miratimin e projekteve individuale të doktoraturës, duke garantuar koherencën tematike dhe cilësinë shkencore të kërkimit.<br><br>*Shih dhe aneks 2.17.1Formati i vleresimit te dosjes se kandidateve DR.pdf* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në të dhënat e evidentuara, rezulton se programi i doktoraturës përmbush në shkallë të kënaqshme standardin e përcaktuar për përzgjedhjen dhe integrimin e fushave kërkimore* |

[99] *22.2 Lista e institucioneve bashkëpunuese per programin e doktoratës.pdf*
[100] *22. Marreveshje Bashkepunimi Qendrat dhe Departamenti _UET.pdf*
[101] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[102] *2.4.1 Projekt Propozim Luljete Prekazi.pdf*
[103] *2.17.2 Shembull_Formular vleresimi i dosjes se kandidatit _ Edona Haxhija.pdf*

| | |
|---|---|
| | *brenda njësisë përgjegjëse. Projekti i doktoraturës është i lidhur ngushtë me fushat e studimit të Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara dhe hartimi i projekteve individuale kërkimore nga kandidatët zhvillohet në përputhje me prioritetet e shpallura nga grupi kërkimor.*<br>*Procedura e përzgjedhjes dhe miratimit të projekteve kërkimore, si dhe përfshirja e komisioneve dhe strukturave akademike përkatëse, dëshmon për një qasje të strukturuar dhe transparente që siguron cilësi dhe koherencë në formimin kërkimor të doktorantëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Kriteret e aplikimit përzgjedhjes dhe pranimit të kandidatëve përcaktohen nga njësia përgjegjëse e cila garanton transparencë në zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës, përcakton kriteret e aplikimit lidhur me gjuhën/gjuhët e huaja, mesataren e pranimit, fushën e studimit dhe programet e studimit të cilët pranohen si kandidatë, dokumentet e aplikimit etj. dhe i bën ato publike. | Programi i doktoraturës në UET ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të strukturuar kriteret e pranimit, duke garantuar një proces seleksionimi që siguron cilësinë akademike dhe përputhjen me kërkesat institucionale e ligjore. Institucioni kerkon plotesimin e stadarteve që tek hapja e thirrjes per aplikim *"Thirrje për aplikim për regjistrim në programin e doktoratës në "Shkenca Sociale dhe të Sjelljes", pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2023-2024"*[104]. Këto kritere përfshijnë nivelin e mëparshëm të studimeve, mesataren akademike, njohuritë gjuhësore sipas standardeve ndërkombëtare dhe angazhimin etik të kandidatëve, *shih: Rregulloren e programit të doktoraturës në KREU V STUDENTËT E PROGRAMEVE TË DOKTORATËS (DOKTORANTËT) 5.1. Pranimi në programet e doktoratës 5.1.1. Kriteret e Pranimit*[105]. |

[104] *2.8.2 Thirrja per aplikime DR UET 2023-2024.pdf*
[105] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| | Gjithashtu, publikimi i rregullt dhe transparent i këtyre kritereve në kanalet zyrtare të universitetit tregon angazhimin e njësisë përgjegjëse për të garantuar informim të gjerë[106] dhe barazi në akses për të gjithë aplikantët e interesuar. |
| **Kriteri 2.** Në programet e doktoratës aplikojnë dhe pranohen kandidatët e punësuar si personel akademik në institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë, si personel kërkimor në një institucion kërkimor dhe që plotësojnë kriteret ligjore e ato specifike të përcaktuara në programin e studimit. | Programi i doktoraturës ofron mundësi pranimi për kandidatë që janë të punësuar si staf akademik apo kërkimor në institucione të arsimit të lartë ose kërkimore, për sa kohë ata plotësojnë kriteret e kërkuara ligjore dhe akademike[107]. Kjo qasje nxit integrimin e studimeve doktorale me aktivitetin kërkimor dhe mësimdhënës, duke kontribuar në zhvillimin profesional të stafit dhe përforcimin e kapaciteteve kërkimore të institucioneve[108].<br><br>Procesi i përzgjedhjes zhvillohet mbi bazën e meritës dhe transparencës, në përputhje me kuotat e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke siguruar standarde të barabarta për të gjithë aplikantët[109], [110], [111], [112], [113], [114]. |
| **Kriteri 3.** Kandidatët që aplikojnë për të vazhduar programin e doktoratës dëshmojnë se kanë njohuri të thelluara teorike në fushën përkatëse të studimit, aftësi dhe kompetenca si të menduarit krijues, aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore, kompetencë për të menaxhuar | Përzgjedhja e kandidatëve për programin e doktoratës bazohet jo vetëm në përmbushjen e kritereve të aplikimit, por edhe në një vlerësim të thelluar të aftësive kërkimore dhe arritjeve profesionale të kandidatëve. Këto përfshijnë njohuri të thelluara teorike, aftësi për të zgjidhur probleme kërkimore, krijimtari dhe menaxhim të kompleksitetit të kërkimit[115].<br><br>Gjithashtu, arritjet personale, si propozimet e qëndrueshme të doktoraturës, publikimet, pjesëmarrja në konferenca dhe projekte kërkimore, janë të rëndësishme për të siguruar që kandidatët janë të përgatitur për të kryer kërkime origjinale dhe për të respektuar standardet akademike të larta[116]. Kjo qasje siguron që doktorantët |

[106] *2.8.2.1 Hapet thirrja per Doktorature 2023-2024_WEB_UET.pdf*
[107] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[108] *2.18.1 Skeda fituesit _ doktoratura _ 2023-2024.pdf*
[109] *2.9.1 MAS_Kuota_2021-2025.pdf*
[110] *2.7.2 MAS_Alokimi i kuotave 2023-2024.pdf*
[111] *2.7.1 MAS Kërkesë për verifikimin dhe çertifikimin e kapaciteteve akademike_kuota_ 23-24.pdf*
[112] *2.7 Vendim Senati_Miratim Projektesh_kuota_2023-2024.pdf*
[113] *2.6.2 MAS Kthim përgjigje _Kuotata_2022-2023.pdf*
[114] *2.6.1.1 MAS Kuota_viti akademik 2021-2022.pdf*
[115] *2.15 Projektet Doktorale Individuale_Udheheqesve_ISCED.pdf*
[116] *2.18.1 Skeda fituesit _ doktoratura _ 2023-2024.pdf*

| | |
|---|---|
| kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit. | të jenë në gjendje të kontribuojnë në kërkimin shkencor në mënyrë të avancuar dhe të respektojnë kërkesat e institucionit.[117] |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse miraton projektet individuale të kërkimit të kandidatëve vetëm për ato drejtime, fusha e të cilave përfshihet në fushën e programit të miratuar të doktoratës që ajo ofron. | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës ka një proces të rreptë të miratimit të projekteve individuale kërkimore, duke siguruar që këto projekte të jenë në përputhje me fushat dhe drejtime që përfshihen në programin e miratuar të doktoratës. Kjo qasje garanton që projektet kërkimore të mbështesin qëllimet dhe prioritetet akademike të programit dhe që kandidatët të kontribuojnë në zhvillimin e fushave specifike të studimeve sociale dhe sjelljes. Projektet kërkimore të miratuara gjatë viteve akademike 2021-2024 pasqyrojnë këtë angazhim dhe përshtatje me fushat e programit, duke forcuar kështu koherencën dhe integritetin e programit të doktoratës[118]. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse miraton kritere shtesë pranimi si intervista, referenca, testime ose provime si dhe dokumente të tjera shtesë të bëra publike paraprakisht. | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës ka një sistem të qartë dhe të hapur për procesin e pranimit, ku çdo kriter shtesë, si intervistat, testimet, provimet, dhe dokumentet e tjera, bëhen të disponueshme për kandidatët përpara aplikimit[119]. Ky proces siguron një transparencë të plotë, duke përfshirë publikimin e listës së projekteve kërkimore dhe mbikëqyrësve të mundshëm, të cilët mund të konsultohen nga aplikantët për t'u siguruar që interesat e tyre kërkimore janë në harmoni me projektet e ofruara[120].<br><br>Kriteret shtesë të pranimit, si CV-ja, referencat dhe propozimi individual i kërkimit, janë elemente të rëndësishme që përdoren për të vlerësuar më thellë aplikantët dhe për të siguruar se ata janë të përgatitur për të ndërmarrë kërkime origjinale dhe të avancuara[121]. Procesi i përzgjedhjes është gjithashtu i bazuar në merita dhe kontribuon në përzgjedhjen e kandidatëve më të aftë, duke siguruar që ata që hyjnë në program janë të kualifikuar dhe të përgatitur për kërkimin shkencor në nivelin më të lartë[122]. |

[117] *28. Lista e Doktoranteve ne Mesimdhenie.pdf*
[118] *2.15 Projektet Doktorale Individuale_Udheheqesve_ ISCED.pdf*
[119] *28. Lista e Doktoranteve ne Mesimdhenie.pdf*
[120] *2.15 Projektet Doktorale Individuale_Udheheqesve_ ISCED.pdf*
[121] *2.17.2 Shembull_Formular vleresimi i dosjes se kandidatit _ Edona Haxhija.pdf*
[122] *2.18.1 Skeda fituesit _ doktoratura _ 2023-2024.pdf*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Njësia përgjegjëse përcakton kriteret specifike që kandidati duhet të plotësojë për të transferuar studimet në programin e studimit, sipas fushës së kërkimit dhe i bën ato publike paraprakisht | Njësia përgjegjëse e programit të doktoratës ka përcaktuar një set të qartë kriteresh për kandidatët që dëshirojnë të transferojnë studimet në programin e doktoratës, duke i bërë ato publike paraprakisht. Shih; Broshura e dokumentave[123] *D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve (ndryshuar me Vendim Senati Nr. 21, date 20.12.2023) D.II.8. Transferimi dhe mobiliteti i studentëve në programet e Ciklit të Tretë D.II.8.1.Për programet e doktoratës kërkesat për transferim shqyrtohen rast pas rasti prej Departametit përgjegjës dhe grupi kërkimor që drejton projektin kërkimor përkatës, mbështetur në Rregulloren e programit të studimit.*<br><br>Studentit mund t'i njihen/ekuivalentohen lëndë të kryera në programe të tjera të ciklit të tretë si lëndë të vitit të parë teorik (Metoda kërkimi dhe 1 seanca teorike). Në çdo rast, studenti duhet t'i nënshtrohet provimit përfundimtar për gjendjen teorike të disiplinës në rast se nuk e ka shlyer një të tillë. Kandidatët që transferojnë studimet e tyre duhet të përmbushin të njëjtat kërkesa si ata që aplikojnë për herë të parë, përfshirë përshtatshmërinë e studimeve të mëparshme me programin e doktoratës të ofruar nga UET. Kjo përfshin kërkesën që tema e kërkimit të jetë në përputhje me një nga fushat e miratuara të programit dhe që të ketë një udhëheqës të disponueshëm për të udhëhequr projektin kërkimor të kandidatëve. Ky proces i qartë dhe transparent siguron që transferimi i kandidatëve të bëhet në përputhje me standardet akademike dhe kërkesat e programit, duke mbajtur nivelin e kërkuar të cilësisë për kërkimin shkencor[124]. |
| **Kriteri 7.** Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia përgjegjëse bazuar në analizë të mirëfilltë të kapaciteteve pritëse të cilat verifikohen dhe certifikohen nga ministria | Referuar dokumentacionit dhe vizitave nw institucion njësia përgjegjëse për programin e doktoratës e ka përcaktuar numrin e studentëve doktorantë duke u bazuar në një analize të thelluar të kapaciteteve dhe mundësive, të cilat janë verifikuar dhe çertifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit[125],[126],[127]. Gjithashtu përcaktimi i kuotave është bazuar në kapacitetet e disponueshme të institucionit dhe ky program doktoral, |

[123] *2.12 Broshura e Dokumenteve_Mbi transferimet_Doktorature.pdf*
[124] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[125] *2.6.1.1 MAS Kuota_viti akademik 2021-2022.pdf*
[126] *2.6.2 MAS Kthim përgjigje _Kuotata_2022-2023.pdf*
[127] *2.7.2 MAS_Alokimi i kuotave 2023-2024.pdf*

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për arsimin dhe bëhen publike. | mbështetur dhe në dokumenationin që institucioni disponon është verifikuar nga Ministria përpara pranimit të kandidatëve[128]. Kapacitetet pritëse janë miratuar nga Senati Akademik dhe është njoftuar ministria përkatëse për të dhënat paraprakisht, brenda afateve kohore të parashikuara për vitin akademik[129],[130],[131]. Procesi i pranimit të kandidatëve ka filluar pas verifikimit dhe çertifikimi nga MASH, duke garantuar që procedurat përkatëse janë në përputhje me normat dhe rregulloret zyrtare. |
| **Kriteri 8.** Studimet e doktoratës zhvillohen pranë njësisë përgjegjëse si pjesë e projektit kërkimor shkencor të aprovuar dhe me financim të siguruar nga burimet financiare të institucionit apo projektit. | Studimet e doktoratës zhvillohen brenda njësisë përgjegjëse, që është Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, si pjesë e një projekti kërkimor shkencor të aprovuar[132]. Ky projekt kërkimor, i quajtur "Sjellja e individëve dhe e aktorëve ekonomikë në raport me shtetin dhe shoqërinë," është integruar në programin e doktoratës dhe ka financim të siguruar nga burimet financiare të institucionit apo nga burime të tjera të dedikuara për projektin[133]. Kjo strukturë e integruar siguron që doktorantët të zhvillojnë kërkime të thelluara dhe të lidhura ngushtë me sfidat dhe transformimet socio-ekonomike dhe politike që lidhen me objektet e studimit të projektit[134],[135]. |
| **Konkluzione** | *Në përputhje me standardet e përcaktuara për zhvillimin e studimeve të doktoratës, njësia përgjegjëse ka siguruar integrimin e programit të doktoratës brenda një projekti kërkimor shkencor të miratuar dhe financiarisht të mbështetur.*<br><br>*Ky projekt kërkimor, i cili adreson një fushë specifike të studimit, është në përputhje me prioritetet kërkimore të institucionit dhe siguron mundësi për zhvillim të thelluar të studimeve dhe kërkimit ndërdisiplinor. Gjithashtu, mbështetja financiare është e siguruar, duke garantuar kështu vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e projektit kërkimor. Kjo strukturë e integruar dhe mbështetja financiare e garantuar janë në përputhje me* |

[128] *2.7.1 MAS Kërkesë për verifikimin dhe çertifikimin e kapaciteteve akademike_kuota_ 23-24.pdf*
[129] *2.8.1 Vendim i Dekanit fituesit_humbesit_2023-2024.pdf*
[130] *2.6 Vendim i Senatit _miratimi projekteve te doktorates-2022.pdf*
[131] *2.7 Vendim Senati_Miratim Projektesh_kuota_2023-2024.pdf*
[132] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[133] *1.1 Përshkrimi i doktorates ne Shkenca Sociale.pdf*
[134] *1.2 PROJEKTI KËRKIMOR shkenca sociale edhe te sjelljes.pdf*
[135] *1.3 Analizë e prioriteteve të kërkimit shkencor_Shkenca Sociale.pdf*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *kërkesat për një program të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të doktoratës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br><br>**Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo doktorant nga aplikimi, pranimi deri përfundim të studimeve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e aplikantëve në fazën e aplikimit. | Njësia përgjegjëse ka siguruar një sistem të përshtatshëm për ruajtjen e dokumentacionit të aplikantëve, duke mbajtur të gjitha dokumentet e aplikimit në dy forma: elektronike dhe në letër. Ky proces është realizuar në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Sociale të Aplikuara dhe Zyrën e Studimeve të Doktoraturës *KREU IV Institution accredited European University of Tirana ORGANIZIMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS (4.6. Zyra e Studimeve Doktorale ngrihet në nivel Universiteti, me vendim të Rektorit, i cili përcakton numrin e personelit dhe strukturën e saj. Ajo sherben si një "sportel unik" për të gjithë aspektet administrative dhe dokumentare të studimeve të doktoratës në UET)*, duke siguruar një menaxhim të duhur dhe të disponueshëm të të dhënave, që përputhet me kërkesat për transparencë dhe ndjekje të procesit të aplikimit[136]. Kjo qasje e dyfishtë kontribuon në ruajtjen e integritetit dhe efikasitetin e procesit të pranimit[137]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e procesit të përzgjedhjes dhe vendimmarrjes të kandidatëve aplikantë dhe | Njësia përgjegjëse ka implementuar një sistem të dyfishtë për ruajtjen e dokumentacionit të procesit të përzgjedhjes dhe vendimmarrjes së kandidatëve aplikantë dhe fitues. Të gjithë dokumentet e lidhura me këtë proces ruhen si në formë elektronike, ashtu edhe në kopje fizike. Ky sistem siguron ruajtjen dhe menaxhimin e informacionit në mënyrë të sigurt dhe transparente, duke garantuar që proceset e ankimimit dhe |

[136] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[137] *2.17 Dosje aplikimi D I.pdf*





| | |
|---|---|
| fitues dhe garanton transparencë në vendimmarrje e proceset e ankimimit. | vendimmarrjes të jenë të hapura dhe të monitorueshme. Kjo qasje rrit transparencën dhe besueshmërinë e procesit të pranimit dhe të vendimmarrjes[138],[139],[140],[141]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse mban në formë elektronike dhe në letër të dhënat e çdo doktoranti në lidhje me veprimtaritë akademike dhe kërkimore shkencore të tij gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve. | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës siguron që të dhënat për çdo doktorant, përfshirë aktivitetet e tij akademike dhe kërkimore shkencore, të ruhen në mënyrë të detajuar dhe të organizuar[142]. Informacioni për botimet dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore, si dhe të dhëna të tjera relevante, ruhet si në formë elektronike[143],[144] ashtu edhe në letër, dhe organizohet në dosje të veçanta për çdo doktorant, si dhe në tabela të dhënash në skedarë Excel,[145],[146],[147]. Kjo mundëson një administrim efikas dhe një mbikëqyrje të vazhdueshme të aktivitetit kërkimor të doktorantëve, ndërsa Zyra e Studimeve të Doktoraturës është përgjegjëse për administrimin dhe arkivimin e të gjithë këtij dokumentacioni[148]. |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse mban në formë elektronike dhe në letër raportimet, komunikimet zyrtare, raportet e vlerësimit të ecurisë dhe të progresit të doktorantit. | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës siguron ruajtjen e të gjitha dokumenteve të rëndësishme, përfshirë raportet e vlerësimit të ecurisë dhe progresit të doktorantëve[149], në forma elektronike dhe fizike[150]. Raportet[151] e ecurisë dorëzohen nga doktorantët në mënyrë elektronike dhe në kopje fizike, duke siguruar një sistem të dubluar dhe të organizuar për menaxhimin e informacionit[152],[153]. Komunikimi zyrtar ndërmjet njësisë dhe doktorantëve bëhet përmes postës elektronike[154] dhe faqes së internetit të institucionit, duke siguruar transparencën dhe |

[138] *2.18.1 Skeda fituesit _ doktoratura _ 2023-2024.pdf*
[139] *2.18.2 Skeda jo fituesit_doktoratura_2023-2024 .pdf,*
[140] *2.17.2 Shembull_Formular vleresimi i dosjes se kandidatit _ Edona Haxhija.pdf*
[141] *2.18.3. Doktorante aktive 2021-2024.pdf*
[142] *26. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf*
[143] *26.1 Manuali i Studentit_LMS.pdf*
[144] *26.2 Manuali i Pedagogut_LMS.pdf*
[145] *25. Tabele_permbledhese_Udheheqesit.pdf*
[146] *27. Programet dhe profilet per regjistrimet 24-25.pdf*
[147] *6.1 Tabela e Veprimtarise Kerkimore.pdf*
[148] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[149] *2.17.1Formati i vleresimit te dosjes se kandidateve DR.pdf*
[150] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[151] *2.2.8 Formati i raportimit te punes kerkimore shkencore.pdf*
[152] *3.4.5 Broshura _Mbi funksionimin e sekretarise mesimore.pdf*
[153] *3.8 Per miratimin e dokumentit Politika dhe procedurat e informimit publik.pdf*
[154] *26. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf*

| | |
|---|---|
| | efikasitetin në proceset e komunikimit dhe menaxhimit të dokumenteve të lidhura me programin e doktoratës[155]. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse ve në dispozicion të studentëve sistemin elektronik antiplagjiaturë si dhe mekanizma tjerë të vetëkontrollit për eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale. | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës siguron përdorimin e sistemeve elektronike të antiplagjiaturës, si Turnitin, për të mbrojtur integritetin akademik dhe për të eliminuar plagjiaturën[156]. Ky sistem ndihmon studentët të verifikojnë origjinalitetin e punimeve të tyre dhe ofron udhëzime se si të interpretohet raporti i origjinalitetit[157]. Po ashtu, rregullorja e programit të doktoratës dhe kodi i etikës së kërkimit përcaktojnë parimet dhe praktikat për të siguruar kërkimin shkencor etike dhe për të mbrojtur të drejtat e pronësisë intelektuale[158],[159].[160] Këto mekanizma ndihmojnë studentët të ndërtojnë një praktikë akademike të ndershme dhe të përgjegjshme[161], [162], [163] |
| **Kriteri 6.** Njësia përgjegjëse harton në mënyrë periodike raportime mbi ecurinë e programit të doktoratës dhe studentëve individualisht dhe informon Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor". | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës realizon raportime të rregullta mbi ecurinë e programit dhe të studentëve individualisht, duke siguruar një proces të vazhdueshëm monitorimi dhe vlerësimi[164]. Zyra e Studimeve të Doktoraturës mban dhe administron të gjitha raportet e progresit të studentëve, përfshirë ato të Ditëve të Doktoratës[165],[166],[167],[168],[169],[170],[171],[172] dhe harton raporte përkatëse mbi aktivitetet e realizuara në kuadër të programit[173]. Këto raporte janë një pjesë e rëndësishme e procesit të vlerësimit dhe i dërgohen Komisionit të Përhershëm për |

155 *2.2.9 Kolokiumi Doktoral.pdf*
156 *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
157 *21.3.1 Guidelines on Turnitin.pdf*
158 *3.5 Kodi i Etikes.pdf*
159 *3.5.1 Rregullat e Etikes.pdf*
160 *3.5.2 Rregullat e Etikes Shtocje 1.pdf*
161 *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*
162 *3.4 Rregullore e UET.pdf*
163 *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
164 *2.2.8 Formati i raportimit te punes kerkimore shkencore.pdf*
165 *2.2.1 Dita e I-re Doktorale.pdf*
166 *2.2.2 Dita e 2-e Doktorale.pdf*
167 *2.2.3 Dita e 3-te Doktorale.pdf*
168 *2.2.4 Dita e 4-te Doktorale.pdf*
169 *2.2.5 Dita e 5-te Doktorale.pdf*
170 *2.2.6 Dita e 6-te Doktorale.pdf*
171 *2.2.7 Dita e 7-te Doktorale.pdf*
172 *2.2.10.1 Dite Doktorale Bledar Hodo.pdf*
173 *21.8 Alban Reli_Progress Report_Example.pdf*

| | |
|---|---|
| | dhënien e gradës shkencore "Doktor", i cili merr kopje të raporteve çdo vit për të siguruar që programi të përmbushë standardet dhe objektivat e tij[174]. |
| **Konkluzione** | *Në përputhje me standardin e kërkuar, njësia përgjegjëse ka krijuar një sistem të qartë dhe efikas për monitorimin e ecurisë së programit të doktoratës dhe për studentët individualisht. Të gjitha raportet e progresit të studentëve, përfshirë ato të Ditëve të Doktoratës, administrohen nga Zyra e Studimeve të Doktoraturës dhe përpunohen në mënyrë periodike. Komisioni i Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" merr raporte vjetore për të siguruar që programi dhe aktivitetet e tij përmbushin kërkesat dhe objektivat e caktuara.*<br><br>*Ky proces i raportimit dhe vlerësimit ka siguruar një nivel të lartë të transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke përmbushur plotësisht kërkesat e standardit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT

| **Standardi III.1**<br><br>**Strukturat përgjegjëse për zhvillimin dhe mbështetjen e programit të doktoratës kanë të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë në aktet rregullatore dhe harmonizojnë veprimtaritë e tyre në funksion të programit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse për organizimin, zhvillimin e | Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, në përputhje me Rregulloren e Programit të Doktoraturës, siguron |

[174] *21.7 Raporti i punes kerkimore shkencore - shtator 2024.pdf*

| | |
|---|---|
| programit të doktoratës garanton plotësimin e standardeve akademike dhe ofron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e projektit kërkimor shkencor. | përmbushjen e standardeve akademike përmes një kuadri të strukturuar që i orienton studentët në çdo hap të procesit të zhvillimit të projekt-propozimit kërkimor deri në finalizimin e disertacionit[175]. Ky proces mbështetet nga një kalendar akademik i qartë, organizimi i orëve mësimore[176] në metodologji[177]dhe teori bashkëkohore[178], si dhe përcaktimi i objektivave të matshme si prezantimi në konferenca[179] dhe botimi shkencor,[180],[181],[182],[183],[184]. Për më tepër, ofrohet infrastrukturë fizike e përshtatshme, përfshirë qasjen në biblioteka[185] dhe burime digjitale, si dhe një sistem funksional mbështetës që përfshin LMS-në[186] për menaxhimin e dokumentacionit dhe komunikimit akademik[187]. Struktura institucionale[188],[189], e përbërë nga fakulteti[190], departamenti[191], shkolla e doktoraturës dhe njësi të tjera mbështetëse[192], garanton koordinimin dhe funksionimin e qëndrueshëm të programit[193]. Këto elementë dëshmojnë për angazhimin e institucionit në krijimin e një mjedisi akademik të qëndrueshëm dhe kërkimorisht produktiv[194],[195],[196].,[197] |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse bashkërendon në funksion të realizimit të projektit | Njësia përgjegjëse në Programin e Doktoraturës në UET demonstron një angazhim të qartë dhe të strukturuar për bashkërendimin efektiv të procesit mësimor dhe kërkimit |

[175] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[176] *24.2 Orari Mesimor Doktorate 2023_2024 .pdf*
[177] *2.16.1 Syllabus Metoda Kerkimi 2022_2023.pdf*
[178] *2.16.1Syllabus Theories and Contemporary debates in social and behavioural studies 2022-2023.pdf*
[179] *10.11 Invitation for 3rd International Conference _ 2024-FREE.pdf*
[180] *8. Politika e kerkimit shkencor 2021-2025.pdf*
[181] *24. Kalendari akademik Doktoratë 2022-2023.pdf*
[182] *24.1 Kalendari akademik Doktoratë 2023-2024.pdf*
[183] *24.4 Kalendar 2024-2025.pdf*
[184] *21.10 Lista e revistave ne Scopus - 2024_Njoftim Orientues.pdf*
[185] *21.12. Biblioteka.pdf*
[186] *26. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf*
[187] *3.4.5 Broshura _Mbi funksionimin e sekretarise mesimore.pdf*
[188] *33. F.IV.Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit.pdf*
[189] *3. Statuti i UET.pdf*
[190] *35. Endorsment of the Dean of Faculty.pdf*
[191] *33. F.IV.Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit.pdf*
[192] *34. Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave.pdf*
[193] *3.4 Rregullore e UET.pdf*
[194] *22.1 Udhëzues Zyra për Projekte dhe Ndërkombëtarizim.pdf*
[195] *22.2 Lista e institucioneve bashkëpunuese per programin e doktoratës.pdf*

[197] *21.1 Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025.pdf*





| | |
|---|---|
| kërkimor shkencor, veprimtaritë akademike, kërkimore-shkencore dhe krijuese të doktorantëve. | shkencor[198],[199]të doktorantëve në funksion të realizimit të projekteve të tyre të disertacionit. Kjo arrihet përmes një rruge të paracaktuar që fillon me ndjekjen e leksioneve dhe vijon me vlerësime periodike që lidhin drejtpërdrejt progresin akademik me projektin kërkimor. Vlerësimi i vazhdueshëm përmes Raporteve të Ecurisë[200] dhe Raporteve të Ditëve të Doktoraturës[201] siguron monitorim të rregullt dhe ndërhyrje të menjëhershme për rregullime në dizajnin kërkimor[202],[203]. Mbrojtja e Bardhë para mbrojtjes finale garanton respektimin e standardeve shkencore, ndërsa seminaret dhe puna e organizuara nga udhëheqësit dhe departamenti mbështesin rritjen e cilësisë së punës së doktorantëve[204],[205]. Ky sistem i integruar dhe i mbështetur në mentorim aktiv, strukturë të qartë dhe vlerësim të vazhdueshëm kontribuon ndjeshëm në realizimin në kohë dhe me cilësi të lartë të projekteve disertacionale[206]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse, nëse përmbush detyrimet ligjore dhe standardet e cilësisë, mund të ofrojë më shumë se një projekt kërkimor në fushën e kërkimit që mbulon. | Njësia përgjegjëse, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të përcaktuara nga kuadri rregullator, ka të drejtë të ofrojë më shumë se një projekt kërkimor brenda fushës së vet të ekspertizës akademike dhe shkencore[207]. Aktualisht, megjithëse institucioni zotëron kapacitete për të zhvilluar projekte të tjera kërkimore, në praktikë është duke zbatuar vetëm një projekt kërkimor, që mbështet programin e doktoraturës në fushën e Studimeve Sociale dhe të Sjelljes[208],[209]. Kjo qasje mund të shihet si një strategji për të konsoliduar cilësinë dhe strukturën e programit ekzistues, me synimin që në të ardhmen të zgjerohet portofoli i projekteve |

198 *2.16.1 Syllabus Metoda Kerkimi 2022_2023.pdf*
199 *2.16.3 Syllabus Teori dhe debate 2022_2023.pdf*
200 *21.7 Raporti i punes kerkimore shkencore - shtator 2024.pdf*
201 *16.1 Activities_ Shembuj Njoftimi Dite Doktorale_Kolokium.pdf*
202 *10.7 Trajnim Longitudinal Research and Observational Methodology_MAY 2023.pdf*
203 *2.2.8 Formati i raportimit te punes kerkimore shkencore.pdf*
204 *2.2.11 Formati i vleresimit te Oponentit per Mbrojtje te Bardhe.pdf*
205 *2.2.12 Formati i Vleresimt metodologjik.pdf*
206 *2.2.10 Formati i Raportimit te Dites Doktorale.pdf*
207 *1.1 Përshkrimi i doktorates ne Shkenca Sociale.pdf*
208 *1.2 PROJEKTI KËRKIMOR shkenca sociale edhe te sjelljes.pdf*
209 *1.3 Analizë e prioriteteve të kërkimit shkencor_Shkenca Sociale.pdf*

| | |
|---|---|
| | kërkimore në varësi të kapaciteteve akademike dhe bashkëpunimeve institucionale[210]. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura ndërmjet dy ose më shumë njësive bazë, njëra prej njësive bazë caktohet përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në marrëveshje ndërmjet tyre dhe më pas ato koordinojnë veprimtaritë në funksion të programit. | Në rastet kur fushat e kërkimit ndërthuren ndërmjet dy ose më shumë njësive bazë, praktika institucionale e UET parashikon që një prej njësive të caktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit, nëpërmjet një marrëveshjeje të dakordësuar ndërmjet njësive përkatëse. Kjo qasje është zbatuar në mënyrë efektive nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, i cili ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi më 22 nëntor 2021 me një sërë njësish të tjera brenda institucionit, duke mundësuar një strukturë të koordinuar për mbështetjen dhe zhvillimin e kërkimeve ndërdisiplinore[211]. *Në kuadër të kësaj marrëveshjeje:*<br>• *Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës dhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm kontribuojnë me ekspertizë në fushën e ekonomisë dhe politikave zhvillimore;*<br>• *Qendra për Metodologji dhe Kërkim Shkencor mbështet me kapacitete në metodologji kërkimi dhe organizimin e seminareve trajnuese;*<br>• *Qendra për Studime Kulturore dhe Edukim Qytetar ofron ekspertizë për temat e kulturës dhe edukimit qytetar demokratik;*<br>• *Qendra për Kërkime Shkencore në Shëndetin Publik kontribuon në psikologji, politikat shëndetësore dhe aspekte të tjera të shëndetit publik.*<br>Ky bashkëpunim i ndërmjetëm jo vetëm që përmbush kërkesat për ndërthurjen e fushave të kërkimit, por krijon një mjedis të favorshëm për zhvillimin e projekteve kërkimore komplekse dhe të orientuara nga nevojat reale të shoqërisë[212],[213]. Përmes këtij mekanizmi koordinues, sigurohet integriteti akademik, |

[210] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[211] *22. Marreveshje Bashkepunimi Qendrat dhe Departamenti _UET.pdf*
[212] *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*
[213] *22.3 Strategy for International Cooperation and Project MAnagment 2023-2028'.pdf*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | mbështetja teknike dhe mbikëqyrja e duhur për projektet ndërdisiplinore të doktorantëve[214],[215]. | | | |
| *Konkluzione* | *Mbështetur në të dhënat e paraqitura në pjesën përshkrimore, standardi i lidhur me ofrimin e projekteve kërkimore në përputhje me detyrimet ligjore dhe standardet e cilësisë vlerësohet si i përmbushur. Edhe pse aktualisht ofrohet vetëm një projekt kërkimor, institucioni ka krijuar një kuadër bashkëpunues ndërinstitucional dhe zotëron kapacitetet për të zgjeruar fushat e kërkimit në të ardhmen. Marrëveshjet me njësitë e tjera dhe qendrat kërkimore brenda institucionit tregojnë një angazhim të qartë për ndërdisiplinaritet dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë në kërkimin shkencor.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.2**<br><br>**Njësia përgjegjëse garanton personelin e nevojshëm akademik, administrativ dhe mbështetës për zhvillimin e programit dhe realizimin e objektivave të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik i angazhuar në programin e doktoratës është i kategorisë "Profesor" me eksperiencë të gjatë në fushën e kërkimit brenda vendit dhe në universitete partnere të njohura në botë. Ata kanë veprimtari të pasur kërkimore, botuese dhe | Bazuar në informacionin e paraqitur, kriteri mbi cilësinë dhe përvojën e personelit akademik të angazhuar në programin e doktoratës vlerësohet plotësisht i përmbushur. Programi mbështetet nga një trupë e gjerë akademikësh të nivelit "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar", me eksperiencë të konsiderueshme kërkimore dhe botuese, të dokumentuar përmes CV-ve dhe pranisë së tyre në databaza ndërkombëtare të indeksuara. Gjithashtu, përfshirja e eksperiencës së tyre në universitete partnere ndërkombëtare përforcon dimensionin cilësor dhe ndërkombëtar të programit[216]. |

[214] *22.2 Lista e institucioneve bashkëpunuese per programin e doktoratës.pdf*
[215] *22.1 Udhëzues Zyra për Projekte dhe Ndërkombëtarizim.pdf*
[216] *25.1 Admir Jance - CV ENG.pdf,;25.2 Adrian Papajani - Anglisht.pdf; 25.3 Agron Cuka.pdf; 25.4 Aleksander Dhima.pdf; 25.5 Anilda Bozdo.pdf; 25.6 BELINA BUDINI CV.pdf; 25.7 Blendi Lami - CV.pdf;25.8 Bujar Kapexhiu cv.pdf; 25.9 Dorina DERVISHI.pdf; 25.10 Drita Kruja CV English.pdf; 25.11 Edi Puka - CV.pdf; 25.12 Elida Miraj.pdf;25.13 Erika Melonashi.pdf; 25.14 Ferit Duka.pdf; 25.15 Hysen Muceku CV.pdf; 25.16 Irina Canco.pdf;*





| | |
|---|---|
| renditen lart në fushën përkatëse të studimeve në databazat e indeksuara në nivel ndërkombëtar. | Referuar *(25. Tabele_permbledhese_Udheheqesi)* të dhënat për stafin akademik për programin e studimit që kanë udhëhequr doktorantët në katër vite akademike janë si më poshtë vijon:<br>Viti akademik **2021 – 2022:**<br>6 Prof.Dr;<br>3 Prof.As;<br>Viti akademik **2022 – 2023:**<br>6 Prof.Dr;<br>5 Prof.As;<br>Viti akademik **2023 – 2024:**<br>13 Prof.Dr;<br>11 Prof.As;<br>Viti akademik **2024 – 2025:**<br>5 Prof.Dr;<br>6 Prof.As; |
| **Kriteri 2.** Udhëheqësi/it me titull akademik "Profesor" mund të drejtojë jo më shumë se 3 doktorantë njëkohësisht dhe ata me titull akademik "Profesor i asociuar" jo më shumë se 2, brenda dhe jashtë institucionit. | Referuar të dhënave të paraqitura, kriteri për ngarkesën maksimale të udhëheqësve të doktoraturës është i përmbushur plotësisht. Respektohen kufizimet ligjore të përcaktuara në Rregulloren e Programeve të Doktoraturës, sipas të cilave udhëheqësit me titull "Profesor" mund të mbikëqyrin deri në 3 doktorantë, dhe ata me titull "Profesor i asociuar" deri në 2, brenda dhe jashtë institucionit[217]. Zbatimi i këtij standardi dokumentohet në mënyrë të qartë përmes vendimeve për ndarjen e kuotave të aprovuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit[218], [219], [220], [221]. |

*25.17 Ketrina Cabiri Mijo - CV.pdf; 25.18 Kreshnik Bello 20 Jan 2025 english.pdf; 25.19 Kreshnik Bello 20 Janar 2025 shqip.pdf; 25.20 Kristaq Xharo - CV.pdf; 25.21 Nevila Nika.pdf; 25.22 Otjela Lubonja Anglisht.pdf; 25.23 Piro Misso cv.pdf; 25.24 Ramazan Peku.pdf; 25.25 Selami Xhepa_2025.pdf; 25.26 Shefqet Muci - CV.pdf, 25.27 Shqipe Zani cv.pdf; 25.28 Voltisa Gjergji.pdf; 25.29 Xhezair Zaganjori.pdf*

[217] *25. Tabele_permbledhese_Udheheqesit.pdf*

[218] *2.9.1 MAS_Kuota_2021-2025.pdf*

[219] *2.7.2 MAS_Alokimi i kuotave 2023-2024.pdf*

[220] *2.6.2 MAS Kthim përgjigje _Kuotata_2022-2023.pdf*

[221] *2.6.1.1 MAS Kuota_viti akademik 2021-2022.pdf*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Kriteret për përzgjedhjen e udhëheqësit, përcaktohet në rregulloren e programit të studimit dhe në akte të tjera të njësisë përgjegjëse. Në këto akte përcaktohen edhe modalitetet e ndryshimit apo zëvendësimit të udhëheqësit në rastet kur është e nevojshme dhe e argumentuar. | Sipas informacionit të paraqitur, ky kriter është plotësisht i përmbushur. Rregullorja e Programit të Doktoraturës[222] përcakton qartë kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e udhëheqësve të doktoratës, si dhe modalitetet për ndryshimin ose zëvendësimin e tyre në rastet kur është e nevojshme[223]. Kriteret për përzgjedhjen e udhëheqësve janë të detajuara, duke përfshirë kërkesën që udhëheqësit të mbajnë tituj akademikë të lartë, si "Profesor i Asociuar" ose "Profesor", dhe të udhëheqin grupe kërkimore, *Shih cv nga aneks 25.1 deri 25.29.*<br><br>Po ashtu, udhëheqësit mund të mbikëqyrin vetëm deri në 3 doktorantë për profesorët dhe deri në 2 për profesorët e asociuar, duke garantuar një mentorim cilësor[224]. Në rast të pamundësisë për të vazhduar rolin e udhëheqësit, është parashikuar një procedurë për zëvendësim, e cila mund të bëhet pa ndërprerë progresin e kërkimit të kandidatëve. |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse garanton se çdo udhëheqës ka kapacitetin për të kryer udhëheqjen e studentit të doktoratës në aktivitetet e kërkimit dhe detyrat respektive didaktike. | Ky kriter është plotësisht i përmbushur, dhe kjo mund të konfirmohet përmes disa faktorëve kyç që janë evidentuar në dokumentacionin e ofruar:<br><br>1. **Kualifikimi dhe ekspertiza e udhëheqësve**: Udhëheqësit janë të certifikuar me tituj akademikë të lartë si "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" dhe kanë ekspertizën e duhur për të udhëhequr kërkimin shkencor të nivelit të doktoratës. Kjo është e dokumentuar përmes CV-ve të tyre, të cilat tregojnë përvojën akademike dhe kërkimore të tyre. *Shih cv nga aneks 25.1 deri 25.29*<br><br>2. **Ngarkesa e punës e kufizuar**: Rregullorja e Programit të Doktoraturës përcakton kufizime të qarta për numrin e doktorantëve që mund të mbikëqyrin profesorët dhe profesorët e asociuar, duke siguruar një angazhim të mjaftueshëm për çdo kandidat dhe duke ruajtur cilësinë e mentorimit[225].<br><br>3. **Përputhja e projektit kërkimor**: Në fazën e aplikimit, kandidatët për doktoraturë janë të informuar për projektet |

[222] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[223] *2.7.1 MAS Kërkesë për verifikimin dhe çertifikimin e kapaciteteve akademike_kuota_ 23-24.pdf*
[224] *25. Tabele_permbledhese_Udheheqesit.pdf*
[225] *25. Tabele_permbledhese_Udheheqesit.pdf*

| | |
|---|---|
| | kërkimore të udhëheqësve dhe mund të zgjedhin projektin që përputhet me interesat e tyre kërkimore. Ky proces i përafron më mirë kërkesat dhe objektivat e doktoratës me kërkimet e udhëheqësve[226],[227],[228].<br>4. **Përgjegjësitë dhe detyrat e udhëheqësit**: Rregullorja e Programit të Doktoraturës përcakton qartë përgjegjësitë e udhëheqësit, duke siguruar një kuadër të qartë për komunikimin dhe pritshmëritë mes udhëheqësit dhe studentit[229].<br>5. **Dokumentet e Ditës së Doktoratës**: Departamenti siguron dokumente të veçanta për çdo ditë doktorale, që ndihmojnë udhëheqësin dhe studentin të mbajnë një kurs të qartë dhe të matshëm për progresin në kërkimin shkencor[230],[231].<br>Këto elemente janë të rëndësishme për të siguruar që çdo udhëheqës ka kapacitetin dhe mundësitë e nevojshme për të udhëhequr kërkimin e studentëve të doktoraturës dhe për të garantuar një zhvillim cilësor të projekteve kërkimore[232],[233],[234],[235]. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik i angazhuar në programin e doktoratës është pjesë aktive e veprimtarive në fushën kërkimore, projekte, referime, botime shkencore, revista, libra a monografi etj dhe përfshin në to studentin në udhëheqje. | Duke u mbështetur në disa aspekte të rëndësishme që vlerësojnë angazhimin e personelit akademik në fushën kërkimore dhe përfshirjen e studentëve të doktoratës në këto aktivitete:<br>1. **Angazhimi në projekte kërkimore**: Personeli akademik është aktiv në projekte kërkimore, që janë thelbësore për zhvillimin e kërkimit shkencor në nivelin e doktoratës. Ky angazhim e ndihmon zhvillimin e ekspertizës kërkimore dhe rrit cilësinë e mundësive për doktorantët[236],[237]. |

[226] *1.2 PROJEKTI KËRKIMOR shkenca sociale edhe te sjelljes.pdf*
[227] *1.1 Përshkrimi i doktorates ne Shkenca Sociale.pdf*
[228] *2.4.1 Projekt Propozim Luljete Prekazi.pdf*
[229] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[230] *2.2.10.1 Dite Doktorale Bledar Hodo.pdf*
[231] *2.2.10.2 Liste Prezence Dite Doktorale.pdf*
[232] *2.7 Vendim Senati_Miratim Projektesh_kuota_2023-2024.pdf*
[233] *2.6 Vendim i Senatit _miratimi projekteve te doktorates-2022.pdf*
[234] *2.8 Vendimi Senati_Projekt i Ri_2024-2025.pdf*
[235] *25. Tabele_permbledhese_Udheheqesit.pdf*
[236] *22.3 Strategy for International Cooperation and Project MAnagment 2023-2028'.pdf*
[237] *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*

| | |
|---|---|
| | 2. **Publikime shkencore**: Siç pasqyrohet në lista të projekteve dhe publikimeve, personeli akademik ka kontribuar me artikuj shkencorë, libra, monografi dhe publikime në revista të njohura ndërkombëtare, duke garantuar një lidhje të ngushtë mes kërkimit të zhvilluar dhe veprimtarisë akademike[238],[239],[240]<br>3. **Përfshirja e studentëve të doktoratës**: Doktorantët përfshihen aktivisht në aktivitetet kërkimore dhe botuese nën mbikëqyrjen e udhëheqësve të tyre. Ky bashkëpunim ofron mundësi për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe shkencore të studentëve, duke i integruar ata në proceset akademike dhe botuese që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në fushat e tyre të studimit.<br>4. **Mbështetje për zhvillimin akademik të studentëve**: Udhëheqësit e doktoraturës janë të angazhuar në veprimtari që mundësojnë publikimin e kërkimeve të studentëve, si dhe organizimin e konferencave dhe aktiviteteve shkencore, që ndihmojnë në rritjen e cilësisë dhe pranueshmërisë ndërkombëtare të punimeve të doktorantëve[241],[242],[243],[244].<br>Ky angazhim i personelit akademik në kërkim dhe botime shkencore ndihmon në garantimin e një cilësie të lartë të kërkimit shkencor dhe ofron mundësi të drejtpërdrejta për zhvillimin e aftësive të doktorantëve[245]. |
| **Konkluzione** | *Personeli akademik i angazhuar në programin e doktoratës është i gjithi me tituj, dhe aktiv duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në fushën kërkimore dhe akademike. Ata janë pjesë e projekteve kërkimore, botimeve shkencore dhe aktiviteteve të tjera që përfshijnë revistat, librat dhe* |

[238] *32. DSHSA_ per raportimin e punes kerkimore shkencore 2023-2024.pdf*
[239] *21.11 Seancat e takimeve të grupeve kërkimore - 20 tetor 2023.pdf*
[240] *30. Seancat e takimeve të grupeve kërkimore.pdf*
[241] *28. Lista e Doktoranteve ne Mesimdhenie.pdf*
[242] *21.10 Lista e revistave ne Scopus - 2024_Njoftim Orientues.pdf*
[243] *10.11 Invitation for 3rd International Conference _ 2024-FREE.pdf*
[244] *10.14 Opportunity for Publication in Bulgarian Journal _CSpace_.pdf*
[245] *29. Raporti vjetor 2023-2024.pdf*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *monografitë, duke siguruar mundësi të vazhdueshme për zhvillimin e doktorantëve.*<br>*Përfshirja e studentëve në këto veprimtari kërkimore dhe botuese është një aspekt i rëndësishëm që vërteton nivelin e angazhimit të profesorëve në mbështetje të zhvillimit të aftësive kërkimore të doktorantëve, duke rritur kështu cilësinë dhe ndikimin e kërkimeve shkencore.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Udhëheqësi ka përgjegjësi për ecurinë e studimeve, punës kërkimore dhe e mbështet atë në mënyrë të vazhdueshme për arritjen e objektivave.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Udhëheqësi është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës kërkimore të studentit. | Kriteri është i plotësuar, pasi udhëheqësit e doktoratës janë të angazhuar në mënyrë të strukturuar dhe sistematike për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për kandidatët[246]. Përmes udhëzimeve të qarta dhe mbikëqyrjes të rregullt, ata ndihmojnë studentët të zhvillojnë kërkimin e tyre, duke siguruar përputhshmërinë me standardet akademike dhe përgatitjen e disertacionit[247],[248],[249]. Praktikat si organizimi i ditëve doktorale[250],[251] dhe vlerësimi i raporteve[252] të ecurisë janë mjete të rëndësishme që mundësojnë vlerësimin dhe përcaktimin e detyrave të ardhshme për kandidatët, duke siguruar kështu një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor të kërkimit[253],[254],[255]. |

[246] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[247] *2.3 Elementet kryesore te propozimit doktoral.pdf*
[248] *2.4 Formulari i Propozimit Doktoral.pdf*
[249] *2.5 Mbi punimin e diplomës_Doktorature.pdf*
[250] *2.2.10.1 Dite Doktorale Bledar Hodo.pdf*
[251] *2.2.10.2 Liste Prezence Dite Doktorale.pdf*
[252] *21.7 Raporti i punes kerkimore shkencore - shtator 2024.pdf*
[253] *5. Development Strategy of the Doctoral Program Social And Behavioural Studies.pdf*
[254] *29. Raporti vjetor 2023-2024.pdf*
[255] *32. DSHSA_per raportimin e punes kerkimore shkencore 2023-2024.pdf*





| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Udhëheqësi shkencor është garantuesi për realizimin e projektit kërkimor shkencor të studentit doktorant duke ofruar eksperiencën e vet, udhëzimet e duhura dhe mbështetjen e vazhdueshme të tij në përmbushje të qëllimit dhe objektivave. | Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se udhëheqësit shkencorë përmbushin detyrat e tyre si mentor dhe mbikëqyrës të procesit kërkimor të doktorantëve, sipas parashikimeve në rregulloren e programit të doktoraturave[256]. Ata sigurojnë mbështetje të vazhdueshme në çdo fazë të kërkimit, duke përfshirë udhëzime mbi metodologjinë e kërkimit, struktura e disertacionit dhe literaturën e duhur[257],[258] Vlerësimet periodike dhe raportet e ecurisë janë mjete të rëndësishme për monitorimin e përparimit dhe përcaktimin e hapave të ardhshëm[259],[260],[261],[262]. Po ashtu, sigurohet integriteti i kërkimit dhe respektimi i standardeve etike, duke parandaluar plagjiaturën[263] dhe duke garantuar cilësinë e punës kërkimore të studentëve[264]. Këto praktika ndihmojnë që doktorantët të arrijnë me sukses qëllimet e projektit të tyre kërkimor dhe të plotësojnë kërkesat akademike të programit[265],[266],[267], [268]. |
| **Kriteri 3.** Udhëheqësi shkencor punon për përditësimin e njohurive dhe aftësive didaktike të studentit në fushën e studimit dhe e përfshin atë në veprimtari akademike të mësimdhënies në ciklin e parë dhe të dytë në programet që institucioni ofron. | Udhëheqësit shkencorë janë të angazhuar në përditësimin e njohurive dhe aftësive didaktike të studentëve të doktoratës, duke i përfshirë ata në aktivitete akademike që përfshijnë mësimdhënien në ciklin e parë dhe të dytë. Ky angazhim siguron që doktorantët të zhvillojnë jo vetëm aftësitë e kërkimit, por edhe ato pedagogjike, duke kontribuar aktivisht në mësimdhënie në UET dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë[269],[270]. Kjo praktikë përforcon cilësinë akademike dhe përgatitjen profesionale të doktorantëve për karrierën e tyre në mjedisin akademik dhe kërkimor. |

[256] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[257] *6. Kerkimi Shkencor_Broshura e Dokumentave.pdf*
[258] *11. Mesimdhenia dhe vleresimi.pdf*
[259] *2.2.12 Formati i Vleresimt metodologjik.pdf*
[260] *2.2.8 Formati i raportimit te punes kerkimore shkencore.pdf*
[261] *2.3 Elementet kryesore te propozimit doktoral.pdf*
[262] *2.5 Mbi punimin e diplomës_Doktorature.pdf*
[263] *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*
[264] *8. Politika e kerkimit shkencor 2021-2025.pdf*
[265] *21.8 Alban Reli_Progress Report_Example.pdf*
[266] *21.1 Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025.pdf*
[267] *20.1 Strategjia Student Centred Learning Teaching and Assessment Policy.pdf*
[268] *30. Seancat e takimeve të grupeve kërkimore.pdf*
[269] *28. Lista e Doktoranteve ne Mesimdhenie.pdf*
[270] *32. DSHSA_per raportimin e punes kerkimore shkencore 2023-2024.pdf*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe udhëheqësit e programit të doktoratës përzgjidhen nga njësia përgjegjëse pas konsultimit me Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor". Miratimi i udhëheqësit shkencor bazohet në përputhshmërinë e fushës së studimeve të tij, arritjeve dhe projektit të doktorantit. | Ky proces i miratimit dhe përzgjedhjes së udhëheqësve shkencorë për programin e doktoratës është i qartë dhe i strukturuar mirë, duke siguruar që udhëheqësit të jenë të kualifikuar dhe të përputhen me fushat e studimit dhe projektet kërkimore të doktorantëve. Konsultimi me Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" dhe miratimi i Senatit Akademik janë hapa të rëndësishëm që sigurojnë përputhshmërinë dhe cilësinë e udhëheqjes shkencore[271],[272],[273]. Ky proces mbështet gjithashtu zhvillimin e projekteve kërkimore të doktoratës që janë në përputhje me standardet dhe kuotat e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke e garantuar një nivel të lartë akademik dhe kërkimor në programin e doktoratës[274],[275],[276],[277],[278],[279]. |
| **Kriteri 5.** Udhëheqësi shkencor kryesor dhe udhëheqësi tjetër (kur programi i studimeve të doktoratës ofrohet nga më shumë se një institucion) siguron/jnë që studentët e doktoratës të marrin mbështetje të mjaftueshme dhe udhëzime për të lehtësuar punën e tyre për arritjen e suksesit. | **N / A** |
| **Kriteri 6.** Njësia përgjegjëse siguron që udhëheqësi ka kohën e mjaftueshme dhe jep | Ky proces i menaxhimit të ngarkesës mësimore dhe mbikëqyrjes së kandidatëve për doktoraturë është në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e institucionit[280]. Përcaktimi i numrit maksimal të doktorantëve që një udhëheqës mund të mbikëqyrë siguron që çdo udhëheqës të ketë kohë të |

[271] *2.6 Vendim i Senatit _miratimi projekteve te doktorates-2022.pdf*
[272] *2.7 Vendim Senati_Miratim Projektesh_kuota_2023-2024.pdf*
[273] *2.8 Vendimi Senati_Projekt i Ri_2024-2025.pdf*
[274] *2.9.1 MAS_Kuota_2021-2025.pdf*
[275] *2.6.1.1 MAS Kuota_viti akademik 2021-2022.pdf*
[276] *2.6.2 MAS Kthim përgjigje _Kuotata_2022-2023.pdf*
[277] *2.7.2 MAS_Alokimi i kuotave 2023-2024.pdf*
[278] *2.7.1 MAS Kërkesë për verifikimin dhe çertifikimin e kapaciteteve akademike_kuota_ 23-24.pdf*
[279] *5. Development Strategy of the Doctoral Program Social And Behavioural Studies.pdf*
[280] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| mbështetjen e nevojshme për studentin e doktoratës. | mjaftueshme për të ofruar mbështetje të personalizuar dhe cilësore për çdo kandidat[281],[282]. Kjo është e rëndësishme për të garantuar një përvojë të shkëlqyer akademike dhe përparim të qëndrueshëm të kërkimit[283].<br><br>Përgatitja e ngarkesës mësimore çdo vit akademik dhe shpërndarja e orëve mësimore është një masë e rëndësishme për të menaxhuar kohën dhe burimet e nevojshme për mbikëqyrjen dhe mbështetje të kandidatit për doktoraturë, duke siguruar që nuk ka ngarkesa të tepërta që mund të ndikojnë në cilësinë e mbikëqyrjes dhe kërkimit[284],[285],[286]. |
| **Kriteri 7.** Në bashkëpunim me studentin, njësia përgjegjëse garanton vijimësi në udhëheqjen e tij në rastet e zëvendësimit të udhëheqësit për shkaqe të ndryshme. | Ky proces i zëvendësimit të udhëheqësit është i rregulluar në mënyrë të qartë nga Rregullorja e Studimeve të Doktoraturës dhe garanton që, në rast nevoje, të sigurohet vijimësia e kërkimit dhe mbikëqyrjes për doktorantin[287]. Kur ndodh nevoja për zëvendësim të udhëheqësit, mundësia që doktoranti të propozojë një udhëheqës të ri është një masë që garanton përputhshmërinë e kërkimeve të studentit me udhëheqësin dhe objektivat e projektit të tij. Kjo rregullore siguron një proces të drejtë dhe transparent, duke mundësuar që çdo ndërhyrje të jetë e menduar dhe të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për doktorantin gjatë gjithë periudhës së studimeve të tij[288],[289],[290],[291]. |
| **Kriteri 8.** Takimet ndërmjet udhëheqësit dhe doktorantit janë zyrtare e të dokumentuara dhe shërbejnë për vlerësimin e raporteve të progresit të doktorantit. | Takimet ndërmjet udhëheqësit dhe doktorantit janë të strukturuara dhe të dokumentuara në mënyrë të detajuar për të siguruar një monitorim të vazhdueshëm të përparimit të kërkimit të doktorantit[292]. Protokolli i takimeve përfshin mbajtjen e shënimeve formale, siç parashikohet në Rregulloren e Programit të Doktoraturës, dhe përfshin elementë si Raporti i |

[281] *31.G-II-2-1 Ngarkesa e stafit.pdf*
[282] *25. Tabele_permbledhese_Udheheqesit.pdf*
[283] *30. Seancat e takimeve të grupeve kërkimore.pdf*
[284] *24. Kalendari akademik Doktoratë 2022-2023.pdf*
[285] *24.1 Kalendari akademik Doktoratë 2023-2024.pdf*
[286] *24.4 Kalendar 2024-2025.pdf*
[287] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[288] *2.1 REGULATION of the Doctoral Program.pdf*
[289] *1.6 Vendim Senati nr. 08 date 26.03.2021 miratimi dhe riorganizimi i programit.pdf*
[290] *1.5 Riorganizm Dr. Shkenca Sociale dhe të Sjelljes.pdf*
[291] *1.5.1 Riorganizimi Dr. Shkenca Sociale dhe te Sjelljes_saktesim.pdf*
[292] *2.2.10.2 Liste Prezence Dite Doktorale.pdf*

| | |
|---|---|
| | Ditëve Doktorale[293]. Ky raport, i cili mbledh të dhëna të detajuara për progresin e doktorantit, siguron një dokumentim të qartë dhe të rregullt të aktivitetit akademik, që mund të përdoret për vlerësimin dhe monitorimin e angazhimit dhe zhvillimit të kërkimit[294],[295]. Ky proces ndihmon në përmirësimin e ndërveprimit dhe koordinimit midis udhëheqësit dhe doktorantit, duke siguruar gjithashtu një mbështetje të vazhdueshme në zhvillimin e disertacionit[296],[297]. |
| **Kriteri 9.** Udhëheqësi shkencor jep konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, për realizimin e projektit kërkimor shkencor të doktoratës dhe në bazë të ecurisë, miraton planin e veprimtarive në vijim. | Udhëheqësi shkencor luan një rol kyç në vlerësimin e vazhdueshëm të progresit të doktorantit, duke siguruar që kërkimi të mbetet në nivelin e duhur akademik dhe duke ndihmuar në përmirësimin e mundshëm të tij. Kjo përfshin shqyrtimin e raporteve të shkruara të doktorantit dhe ofrimin e mbështetjes dhe udhëzimeve për të adresuar çdo mangësi që mund të identifikohen[298]. Udhëheqësi gjithashtu është përgjegjës për monitorimin e përmbushjes së standardeve kërkimore, duke siguruar që hulumtimi të jetë në përputhje me kërkesat akademike dhe të publikueshme. Në përputhje me Rregulloren e Programit të Doktoraturës[299], udhëheqësi jep një vlerësim të strukturës së punës së dorëzuar nga doktoranti, duke e klasifikuar atë si të dobët, të mirë, shumë të mirë ose të shkëlqyer, dhe ofron sugjerime për përmirësim deri në takimin e ardhshëm[300],[301],[302]. Pjesë e procesit është edhe caktimi i detyrave të reja që duhet të realizohen, si leximi i mëtejshëm i materialeve, shkruajtja e kapitujve të rinj ose rishikimi i dizajnit të kërkimit, duke siguruar një drejtim të vazhdueshëm dhe një zhvillim të suksesshëm të kërkimit të doktoraturës[303],[304]. |

[293] *2.2.10 Formati i Raportimit te Dites Doktorale.pdf*
[294] *2.2.12 Formati i Vleresimt metodologjik.pdf*
[295] *3.5.3 Broshura e Dokumenteve A I and A II.pdf*
[296] *2.2.10.1 Dite Doktorale Bledar Hodo.pdf*
[297] *6. Kerkimi Shkencor_Broshura e Dokumentave.pdf*
[298] *2.2.13 ANEKS-APROVIM PËR KALIM NË MBROJTJE FINALE.pdf*
[299] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[300] *2.3 Elementet kryesore te propozimit doktoral.pdf*
[301] *2.2.8 Formati i raportimit te punes kerkimore shkencore.pdf*
[302] *21.8 Alban Reli_Progress Report_Example.pdf*
[303] *2.2.10.1 Dite Doktorale Bledar Hodo.pdf*
[304] *2.5 Mbi punimin e diplomës_Doktorature.pdf*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 10.** Udhëheqësi shkencor garanton plotësimin e të gjitha vërejtjevedhe rekomandimet e jurisë kur disertacioni rikthehet për plotësime. | Udhëheqësi shkencor ka një rol të drejtpërdrejtë në sigurinë që kandidati për doktoraturë ka adresuar të gjitha komentet dhe rekomandimet e dhëna nga juria gjatë procesit të parambrojtjes dhe mbrojtjes. Ky proces është thelbësor për finalizimin e disertacionit dhe përgatitjen e kandidatit për një mbrojtje të suksesshme. Udhëheqësi shkencor është i detyruar të sigurojë që çdo rishikim, përmirësim ose plotësim i kërkuar të bëhet dhe të jetë në përputhje me standardet akademike dhe kërkesat e departamentit dhe jurisë.Për më tepër, prania e udhëheqësit shkencor gjatë mbrojtjes është e domosdoshme për të mbështetur kandidatët dhe për të siguruar që procesi të zhvillohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregullore. Ky angazhim tregon angazhimin e udhëheqësit për të garantuar cilësinë e kërkimit dhe përfundimin me sukses të procesit të doktoraturës[305], [306], [307] |
| **Konkluzione** | *Udhëheqësi shkencor i programit të doktoratës në UET ka përgjegjësinë për të siguruar që kandidatët për doktoraturë të realizojnë kërkimin e tyre në përputhje me standardet akademike të vendosura. Ky proces përfshin vlerësimin e vazhdueshëm të progresit të studentëve, si dhe ofrimin e udhëzimeve dhe mbështetjes për të adresuar çdo koment dhe rekomandim të dhënë nga juria dhe departamenti.*<br><br>*Për më tepër, udhëheqësi është i angazhuar në mbikëqyrjen e plotësimit të detyrave dhe kërkesave të vendosura, si dhe është i pranishëm gjatë mbrojtjes së disertacionit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e kërkuara. Nëpërmjet raporteve të Ditëve Doktorale dhe përditësimit të planit të veprimtarive, udhëheqësi siguron një mbikëqyrje cilësore dhe efektive të procesit të doktoraturës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[305] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[306] *2.11 Broshura_ Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore.pdf*
[307] *13.1 Plotesimi i detyrimeve akademike per marrjen e grades _Doktor_ 29 Maj 2024.pdf*

| **Standardi III.4**<br><br>**Njësia përgjegjëse garanton infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme në funksion të programit të doktoratës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse e programit të doktoratës ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme për të realizuar mirëfunksionimin e tij. | Njësia përgjegjëse e programit të doktoratës ka siguruar mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e programit. Disponimi i zyrave për departamentin, udhëheqësit të doktoratës, shefin e departamentit dhe dekanin e fakultetit siguron një strukturë të qartë dhe të organizuar administrativisht[308]. Gjithashtu, ofrimi i aksesit të studentëve të doktoratës në të gjitha objektet e universitetit, përfshirë klasa, bibliotekë dhe laboratorë, mbështet procesin e kërkimit dhe studimit në mënyrë efektive. Kjo mundëson një përvojë akademike dhe kërkimore të plotë dhe të integruar për doktorantët.Verifikuar dhe nga vizita dy ditore nw institucion[309]. |
| **Kriteri 2.** Studentët e pranuar në programin e studimit, kanë kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e kërkimor shkencor. | Ky kriter është i plotësuar në mënyrë të plotë, pasi programi i doktoratës siguron kushtet e nevojshme për realizimin e studimeve akademike dhe kërkimore shkencore. Studentët kanë akses në hapësira të dedikuara për lexim dhe stacione pune, të cilat ofrojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e kërkimeve. Për më tepër, mbështetja administrative dhe teknike është e siguruar përmes koordinatori të shkollës së doktoraturës dhe sekretarisë, që funksionojnë si pika kontaktuese për studentët. Gjithashtu, shërbimi IT siguron mjete të domosdoshme si llogari universitare, akses në sisteme të menaxhimit të të dhënave dhe programe si Turnitin për kontrollin e plagjiaturës[310],[311].Orari fleksibël i bibliotekës dhe aksesimi i laboratorëve në fundjavë sigurojnë që studentët të kenë mundësi të plota për të menaxhuar kohën dhe kërkimet e tyre. Ky përkrahje administrativë dhe teknike është thelbësore për të garantuar suksesin e studentëve të doktoratës. |
| **Kriteri 3.** Programi i doktoratës ka në dispozicion | Ky kriter është i plotësuar në mënyrë të plotë, pasi programi i doktoratës siguron akses të mjaftueshëm dhe të përditësuar në |

[308] *2.1 RREGULLORE Programi Doktorature.pdf*
[309] *Minuta Dr Shkencat e sjelljes.pdf*
[310] *21.3.1 Guidelines on Turnitin.pdf*
[311] *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*

| | |
|---|---|
| një bibliotekë shkencore të pasur me botime dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së. | burime të informacionit dhe teknologji të avancuar për kërkime shkencore. Biblioteka shkencore e universitetit është e pasur me botime të ndryshme, si dhe ofron koleksione elektronike që përfshijnë revista, e-libra dhe baza të dhënash si EBSCO, Sage dhe RESEARCH4LIFE, duke siguruar informacion të nevojshëm për studentët e doktoratës[312],[313],[314],[315]. Po ashtu, programi ofron mjete të avancuara për analiza të të dhënave, si SPSS, dhe sistemin Turnitin për kontrollin e plagjiaturës[316],[317],[318],[319],[320]që janë thelbësore për zhvillimin e kërkimit shkencor. Institucioni gjithashtu siguron akses në materialet kërkimore dhe ndihmon në ruajtjen e rezultateve të punës kërkimore të studentëve. Kjo mbështetje teknologjike dhe burimesh është një element i rëndësishëm për suksesin e programit dhe për cilësinë e kërkimit shkencor të realizuar nga doktorantët. |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse garanton mbështetjen logjistike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe veprimtarive publikuese dhe botuese. | Ky kriter është i plotësuar në mënyrë të plotë, pasi programi ofron një mbështetje të vazhdueshme logjistike dhe akademike për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe aktiviteteve publikuese dhe botuese. Aktivitetet e tilla si seminaret dhe trajnime të ndryshme për shkrim shkencor, metodologjinë e kërkimit, dhe menaxhimin e projekteve kërkimore janë shembuj të mbështetjes që ofrohen për studentët e doktoratës.<br><br>Programi ka ofruar mundësi për ndarjen e eksperiencave dhe mësimeve nga profesionistë të fushave të ndryshme si nga universitetet ndërkombëtare[321] dhe ekspertë të njohur, si Prof. Sonia da Sa[322] dhe Prof. Carla Cristina Steves Martins. Për më tepër, pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të ndihmohen për përdorimin e mjeteve si Zotero[323] për menaxhimin e referencave |

[312] *3.6 Planit strategjik 2021-2025, i perditesuar.pdf*
[313] *5. Development Strategy of the Doctoral Program Social And Behavioural Studies.pdf*
[314] *8. Politika e kerkimit shkencor 2021-2025.pdf*
[315] *21.1 Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025.pdf*
[316] *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*
[317] *10.7 Trajnim Longitudinal Research and Observational Methodology_MAY 2023.pdf*
[318] *10.8 Trajnim online Erasmus REzEB.pdf*
[319] *10.6 18 prill Pitch Training-Horizon.pdf*
[320] *10.9 trajnim per përdorimin e software ZOTERO.pdf*
[321] *16.2 Open Lecture_Guest _IASI_Romania.pdf*
[322] *10.5 Erasmus + Prof. Sónia de Sá - Teaching at the Doctoral School 2024.pdf*
[323] *10.9 trajnim per përdorimin e software ZOTERO.pdf*

| | |
|---|---|
| | dhe kanë marrë trajnim për shkrimin e propozimeve kërkimore[324], si dhe menaxhimin e projekteve kërkimore përmes sesioneve të specializuara. Ky lloj mbështetjeje është thelbësor për zhvillimin e aftësive kërkimore të doktorantëve dhe përkrahja e tyre për të arritur rezultate të suksesshme në kërkimin shkencor. |
| **Kriteri 5.** Në fushat ku është e nevojshme kryerja e punës së doktoratës në laboratorë kërkimorë, njësia përgjegjëse garanton laboratorë të certifikuar ose bashkëpunon me institucione të tjera partnere jashtë institucionit për realizimin e punës kërkimore shkencore. | **N / A** |
| **Kriteri 6.** Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme në institucion ose në institucionin partner për një periudhë së paku 6 mujore. | **N / A** |
| **Kriteri 7.** Njësia përgjegjëse ve në dispozicion të programit doktoral sistemin elektronik të administrimit të informacionit për te mirëmenaxhuar raportimet, komunikimet, raportet e | Ky kriter është i plotësuar në mënyrë të plotë. Programi i doktoratës ka implementuar një sistem të avancuar elektronik për administrimin e informacionit që mundëson menaxhimin efikas të raportimeve, komunikimeve dhe vlerësimeve të progresit të studentëve. Sistemi Informativ i Menaxhimit të Mësimit (LMS)[325],[326] është një mjet kyç për ndjekjen e aktivitetit akademik të doktorantëve, duke mundësuar ngarkimin e materialeve akademike, raporteve të progresit[327],[328], |

[324] *10.6 18 prill _ Pitch Training-Horizon.pdf*
[325] *26.2 Manuali i Pedagogut_LMS.pdf*
[326] *26.1 Manuali i Studentit_LMS.pdf*
[327] *29. Raporti vjetor 2023-2024.pdf*
[328] *32. DSHSA_per raportimin e punes kerkimore shkencore 2023-2024.pdf*

| | |
|---|---|
| vlerësimit të ecurisë dhe të progresit të doktorantit. | planprogrameve[329] dhe leksioneve[330]. Ky sistem siguron që të gjithë informacionet të jenë të centralizuara dhe të aksesueshme, duke përmirësuar menaxhimin dhe mbikëqyrjen e ecurisë së studentëve të doktoratës. |
| **Kriteri 8.** Njësia përgjegjëse siguron kapacitetet e mjaftueshme për të udhëhequr doktorantët deri në fund të programit dhe të monitorojë progresin e doktorantit duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me udhëheqësin, si dhe të sigurojë raportimet e rregullta gjatë gjithë periudhës. | Njësia përgjegjëse siguron një strukturë të mirëorganizuar dhe kapacitete të mjaftueshme për mbështetje dhe monitorim të vazhdueshëm të doktorantëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Programi i doktoratës ofron një sërë mekanizmash për të siguruar kontakt të ngushtë dhe udhëheqje të vazhdueshme, duke përfshirë:<br>1. **Kurs mësimor**[331],[332],[333]dhe **provime**[334],[335] që ofrojnë një bazë solide akademike;<br>2. **Ditët e doktoratës**[336],[337],[338],[339],[340],[341],[342],[343] ku studentët prezantojnë progresin e punës së tyre kërkimore;<br>3. **Raportet e progresit**[344],[345],[346],[347]që dokumentojnë zhvillimin e kërkimit dhe vlerësimin e tij nga udhëheqësit shkencorë;<br>4. **Kolokiumi**[348] si mundësi për diskutime shkencore dhe feedback nga kolegët dhe ekspertët; |

[329] *27. Programet dhe profilet per regjistrimet 24-25.pdf*
[330] *26. Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS.pdf*
[331] *2.16.1 Syllabus Doctoral Seminar in Research Methods in Social and Behavioural Studies 2022-2023.pdf*
[332] *2.16.1 Syllabus Metoda Kerkimi 2022_2023.pdf*
[333] *2.16.3 Syllabus Teori dhe debate 2022_2023.pdf*
[334] *2.2.9 Kolokiumi Doktoral.pdf*
[335] *13.5 Mbi zhvillimin e provimit perfundimtar CE - 15 shtator 2023.pdf*
[336] *2.2.1 Dita e I-re Doktorale.pdf*
[337] *2.2.2 Dita e 2-e Doktorale.pdf*
[338] *2.2.3 Dita e 3-te Doktorale.pdf*
[339] *2.2.4 Dita e 4-te Doktorale.pdf*
[340] *2.2.5 Dita e 5-te Doktorale.pdf*
[341] *2.2.6 Dita e 6-te Doktorale.pdf*
[342] *2.2.7 Dita e 7-te Doktorale.pdf*
[343] *2.2.10.1 Dite Doktorale Bledar Hodo.pdf*
[344] *2.2.8 Formati i raportimit te punes kerkimore shkencore.pdf*
[345] *2.2.10 Formati i Raportimit te Dites Doktorale.pdf*
[346] *2.2.11 Formati i vleresimit te Oponentit per Mbrojtje te Bardhe.pdf*
[347] *2.2.12 Formati i Vleresimt metodologjik.pdf*
[348] *2.2.9 Kolokiumi Doktoral.pdf*

| | |
|---|---|
| | 5. **Trajnimet[349],[350],[351]dhe leksionet e hapura[352]** që kontribuojnë në zhvillimin e aftësive kërkimore dhe profesionale të studentëve;<br>6. **ASD (Ditët e Studimeve Shqiptare)** që ofrojnë mundësi për diskutime dhe përfshirje në aktivitete akademike relevante për kontekstin shqiptar;<br><br>Këto aktivitete sigurojnë një mbështetje të vazhdueshme për doktorantët dhe garantiojnë që ata të mbajnë kontakte të vazhdueshme me njësinë përgjegjëse dhe me mentorët e tyre, ndërkohë që sigurojnë vlerësime të rregullta të progresit të tyre. |
| **Konkluzione** | *Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës ka siguruar kapacitete adekuate për mbështetje dhe monitorim të doktorantëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Pavarësisht se janë ofruar kurse mësimorë, ditë doktorale, raportet e progresit, kolokiume, trajnime dhe leksione të hapura, janë siguruar gjithashtu mundësi për kontakt të vazhdueshëm me mentorët dhe mbështetje të qëndrueshme nga njësia përgjegjëse.*<br><br>*Këto aktivitete dhe mekanizma garantiojnë një mbështetje të vazhdueshme dhe vlerësim të ecurisë, duke siguruar përmbushjen e kritereve të programit dhe zhvillimin akademik të studentëve të doktoraturës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br><br>**Institucioni siguron partneritet dhe bashkëpunim me institucione të cilat mbështesin veprimtarinë kërkimore shkencore të studentit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse siguron marrëveshje me | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës ka siguruar marrëveshje të rëndësishme me institucione të arsimit të lartë |

[349] *10.7 Trajnim Longitudinal Research and Observational Methodology_MAY 2023.pdf*
[350] *10.6 18 prill _ Pitch Training-Horizon.pdf*
[351] *10.9 trajnim per përdorimin e software ZOTERO.pdf*
[352] *16.2 Open Lecture_Guest _IASI_Romania.pdf*

| | |
|---|---|
| institucione të arsimit të lartë, institute kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, që mbështesin shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës, si dhe veprimtaritë të tjera akademike e kërkimore. | dhe institute kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, duke mundësuar shkëmbime të personelit akademik dhe studentëve të doktoratës[353]. Këto marrëveshje kanë rezultuar në mundësi bursa mobiliteti për studentët e doktoratës përmes Erasmus+, duke u ofruar atyre mundësi për përvojë ndërkombëtare. Gjithashtu, stafi akademik ka përfituar nga mobilitetet Erasmus+ për të zhvilluar leksione të hapura në universitetet e BE-së dhe OECD, duke pasuruar kështu përvojën akademike dhe kërkimore të gjithë pjesëmarrësve[354]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse siguron përfshirjen në programin e doktoratës të personelit akademik si udhëheqës shkencor, lektor ose si bashkëpunëtorë shkencorë të doktorantëve të paktën të një universiteti në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës. | Njësia përgjegjëse për programin e doktoratës ka siguruar përfshirjen e personelit akademik ndërkombëtar si udhëheqës shkencorë, lektorë dhe bashkëpunëtorë shkencorë nga universitete të njohura të vendeve të Bashkimit Evropian, OECD-së dhe G20-ës. Lektorat dhe aktivitete të tilla janë realizuar me lektorë të ftuar nga vende si Rumania[355], Portugalia[356] dhe Italia, të cilët kanë mbajtur leksione për studentët e doktoraturës në UET, duke përfshirë kështu një përvojë të pasur dhe ndërkombëtare për studentët[357]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse siguron marrëveshje me të paktën një universitet nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës që garanton programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës së paku për një periudhë 3 mujore. | Njësia përgjegjëse ka nënshkruar marrëveshje me të paktën tre universitete nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian – Universiteti i Almerias (Spanjë)[358], Universiteti Saarland (Gjermani) dhe Universiteti Valladolid (Spanjë)[359] – që u mundësojnë studentëve të doktoraturës shkëmbime akademike të paktën tre-mujore përmes programit Erasmus+. Kjo siguron një përvojë ndërkombëtare të thelluar për doktorantët dhe përforcon dimensionin global të programit[360]. |

[353] *22.2 Lista e institucioneve bashkëpunuese per programin e doktoratës.pdf*
[354] *22.5 Staff and Doctoral Student Exhange KA 171 2020-2024.pdf*
[355] *16.2 Open Lecture_Guest _IASI_Romania.pdf*
[356] *10.5 Erasmus + Prof. Sónia de Sá - Teaching at the Doctoral School 2024.pdf*
[357] *10.2 Call for Erasmus Exchange Doctoral Studies_Valadolid.pdf*
[358] *0.4 Thirrje Erasmus_ University of Almeria - PhD students - 24-25.pdf*
[359] *10.2 Call for Erasmus Exchange Doctoral Studies_Valadolid.pdf*
[360] *22.6 Total Staff Exchange.pdf*

<table>
<tr><td colspan="1">Kriteri 4. Njësia përgjegjëse siguron marrëveshje me institucione ndërkombëtare që sigurojnë përfshirjen e studentëve doktorantë në projekteve kërkimore të përbashkëta. Për shkencat albanologjike bashkëpunimi mund të jetë edhe me një Institucion të Arsimit të Lartë apo qendër kërkimore në Kosovë dhe në trojet shqiptare.</td><td colspan="4">Njësia përgjegjëse ka lidhur marrëveshje me institucione ndërkombëtare dhe rajonale—përfshirë projektet COST Action, AKKSHI, Erasmus CBHE, Jean Monnet, Visegrad dhe Horizon—që u mundësojnë doktorantëve të përfshihen aktivisht në projekte kërkimore të përbashkëta[361]. Të dhënat e tabelës së projekteve të UET tregojnë qartë financimet, donatorët dhe stafin përkatës, ndërsa 52 projekte të koordinuara nga Zyra e Projekteve dhe Ndërkombëtarizimit përfshijnë doktorantë dhe anëtarë të programit të doktoraturës, duke vërtetuar nivelin e lartë të angazhimit ndërkombëtar dhe bashkëpunimit shkencor[362].</td></tr>
<tr><td colspan="1">Kriteri 5. Institucioni krijon mekanizmat e nevojshme për zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimeve të doktoratës me universitete homologe në rajon ose në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës.</td><td colspan="4">Ky kriter është pjesërisht i përmbushur: institucioni ka krijuar të gjithë mekanizmat e nevojshëm ligjorë dhe organizativë për nisjen e programeve të përbashkëta doktorature me partnerë homologë në BE, OECD ose G20, por deri tani ende nuk ka nisur asnjë program të tillë.<br><br>Kjo tregon një gatishmëri dhe kapacitet institucional për bashkëpunim të thellë ndërkombëtar, <u>por mungesa e përvojës konkrete në zhvillimin e programeve të përbashkëta mbetet një boshllëk që duhet adresuar në të ardhmen</u>[363],[364],[365].</td></tr>
<tr><td colspan="1">Konkluzione</td><td colspan="4">Sipas gjetjeve, institucioni ka krijuar të gjitha mekanizmat ligjorë dhe organizativë të nevojshëm për zhvillimin e programeve të përbashkëta doktorature me partnerë homologë në BE, OECD e G20, duke demonstruar kapacitet dhe interesa për bashkëpunim ndërkombëtar.<br><br>Megjithatë, deri tani nuk është konkretizuar asnjë program i tillë, që tregon një boshllëk midis potencialit institucional dhe zbatimit praktik të tij, gjë <u>që duhet adresuar në të ardhmen.</u></td></tr>
<tr><td>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
</table>

[361] *22.1 Udhëzues Zyra për Projekte dhe Ndërkombëtarizim.pdf*
[362] *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*
[363] *10.1 Vendim i Senatit Rregullore për shkëmbimet studentore Erasmus +.pdf*
[364] *110. Rregullore per shkembimet studentore Erasmus dhe diploma te dyfishta_Per studentet.pdf*
[365] *10.1.2 Vendim i Senatit Rregullore per shkembimet e personelit_ Erasmus+.pdf*





| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.6<br><br>**Institucioni përgjegjës për programin e doktoratës dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe siguron mjetet e duhura të financimit dhe mbështetjes së studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni nëpërmjet raporteve dhe auditevefinanciare dëshmon ecuri pozitive dhe qëndrueshmëri në gjenerimin dhe përdorimin e të ardhurave financiare. | Mbështetur në raportet dhe auditimet financiare të institucionit institucioni dëshmon një performancë të qëndrueshme dhe përdorim efektiv të të ardhurave për mbështetjen e programeve akademike, duke përfshirë doktoraturën. Referuar raporteve audituese vërehet koherencë dhe rregullisi në realizimin e tyre, shih anekset 23.4&5&6, të cilat janë dhe në përputhje me ligjet kombëtare dhe dokumentet kryesore të UET, duke vërtetuar transparencën dhe përgjegjshmërinë financiare të institucioni[366], [367], [368], [369], [370], [371], [372] |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse siguron nëpërmjet institucionit, projekteve ose financimeve nga subjekte të tjera fondet e nevojshme për zhvillimin e projektit të kërkimit shkencor. | Njësia përgjegjëse siguron financimet e nevojshme për projektet kërkimore-shkencore përmes një kombinationsh burimesh—përfshirë bursa studimi të pjesshme nga UET, fonde nga projekte kombëtare e ndërkombëtare (Erasmus+ KA1/KA2, AKKSHI, Horizon etj.)[373] dhe vetëfinancimin nga kandidatët—duke garantuar që çdo doktorant të ketë mbështetje të qëndrueshme financiare gjatë gjithë zhvillimit të disertacionit si dhe vetëfinancimi nga kandidatët për doktoraturë. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimeve të doktoratës mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për kërkim. | Gjatë periudhës së vlerësimit, programi i doktoratës ka demonstruar një mbulim financiar të qëndrueshëm dhe të diversifikuar. Financimi sigurohet kryesisht nga projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare (p.sh. Erasmus+, Horizon Europe, COST, AKKSHI, READ), që ofrojnë fonde të mjaftueshme për studime kërkimore cilësore, përmirësimin e |

366 *23.4 RAPORT AUDITIMI 2021.pdf*
367 *23.5 RAPORT AUDITIMI 2022.PDF*
368 *23.6 RAPORT AUDITIMI 2023.PDF*
369 *23. Tabelat 18.1_18.2_Të dhëna financiare.pdf*
370 *23.1 Pasqyrat Financiare 2021 me shënime.pdf*
371 *23.2 Pasqyrat Financiare 2022 me shënime.pdf*
372 *23.3 Pasqyrat Financiare 2023 me shënime.pdf*
373 *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*





| | |
|---|---|
| | infrastrukturës shkencore dhe mbështetjen e doktorantëve e të stafit akademik[374].<br><br>Këto projekte i japin universitetit akses në metodologji bashkëkohore dhe nxisin kërkimin ndërdisiplinor, duke reduktuar varësinë nga buxheti vendor. Ky diversifikim i burimeve financiare forcon qëndrueshmërinë afatgjatë dhe krijon një bazë të besueshme financimi për zhvillimin e programit të doktoratës. Zyra për Projekte dhe Ndërkombëtarizim (ZPI) ka luajtur një rol kyç në këtë proces. Gjatë viteve 2020–2024, ZPI menaxhoi 52 projekte ndërdisiplinore kërkimore me përfshirjen aktive të doktorantëve dhe stafit akademik, duke forcuar partneritetet strategjikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë[375]. Ky nivel i lartë angazhimi solli përmirësime të prekshme në laboratorët kërkimorë dhe infrastrukturën mbështetëse për doktorantët, reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë akademike të programit të doktoratës. Të dhënat tregojnë qartë se investimet e sigurta dhe të larmishme në këtë mënyrë kanë sjellë ndikim konkret në zhvillimin shkencor të doktorantëve. Duke analizuar diversifikimin e financimeve dhe rezultatet e prekshme në infrastrukturë dhe cilësi, mund të konkludojmë se programi i doktoratës përmbush me sukses kërkesat e standardit mbi mbështetjen buxhetore. Kështu, përveç stabilitetit të lartë financiar, programi demonstron edhe kapacitet të fortë për përmirësim cilësor të vazhdueshëm, duke kontribuar pozitivisht në avancimin akademik të doktorantëve.<br><br>Zyra për Projekte dhe Ndërkombëtarizim (ZPI) ka luajtur një rol thelbësor, duke menaxhuar gjatë viteve 2020–2024 një total prej 52 projektesh ndërdisiplinore, ku janë përfshirë mbikëqyrës dhe doktorantë të programit[376]. Këto projekte kanë çuar në përmirësime konkrete në laboratorët modernë, ngritjen e kapaciteteve kërkimore dhe zhvillimin e partneriteteve strategjike. Po ashtu, janë siguruar fonde për mbështetjen e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në konferenca, trajnime dhe publikime shkencore. Një aspekt i rëndësishëm i |

[374] *Ibid*
[375] *22.1 Udhëzues Zyra për Projekte dhe Ndërkombëtarizim.pdf*
[376] *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*

| | |
|---|---|
| | mbështetjes financiare është edhe politika e heqjes së tarifës për pjesëmarrje dhe publikim në Konferencat dhe Revistat Shkencore Ndërkombëtare të UET. Kjo masë lehtëson përfshirjen aktive të doktorantëve në komunitetin akademik dhe inkurajon shpërndarjen e gjetjeve kërkimore pa barrë financiare.<br><br>Bazuar në të dhënat dhe masat e ndërmarra, vlerësohet se standardi për mbështetjen financiare të programit të doktoratës është përmbushur plotësisht, duke garantuar qëndrueshmëri dhe kushte të favorshme për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe formimin akademik të doktorantëve[377]. |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse siguron të ardhura nga shërbime ndaj subjekteve të tjera në kuadër të zhvillimi të programit të doktoratës dhe i përdor ato në funksion të zhvillimit të programit. | **N / A** |
| **Kriteri 5.** Struktura e shpërndarjes së buxhetit financiar të programit të studimeve të doktoratës përputhet me politikën dhe nevojat e kërkimit shkencor të institucionit. | Struktura e shpërndarjes së buxhetit për programin e doktoraturës është në përputhje të plotë me politikat institucionale dhe nevojat kërkimore të universitetit. Institucioni demonstron një qasje të qartë strategjike në alokimin e burimeve financiare për kërkim, duke synuar mbështetjen e drejtpërdrejtë të kandidatëve për doktoraturë dhe të stafit akademik.<br><br>Buxheti i dedikuar për kërkimin përfshin qasje në platforma dhe mjete të specializuara si Turnitin dhe SPSS, si dhe akses të gjerë në biblioteka dixhitale ndërkombëtare (EBSCO, SAGE, RESEARCH4LIFE etj.)[378], të cilat janë thelbësore për zhvillimin e kërkimeve cilësore. Gjithashtu, janë përfshirë fonde për mbulimin e tarifave të publikimeve dhe për pjesëmarrjen në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe publikime në revista institucionale të indeksuara si *JusticiaS* dhe *Economicus*.<br><br>Përveç fondeve të brendshme, institucioni ndjek dhe përfiton në mënyrë aktive financime të jashtme përmes projekteve si Erasmus+, Horizon Europe, COST Action dhe AKKSHI. Këto |

[377] *22.3 Strategy for International Cooperation and Project MAnagment 2023-2028'.pdf*
[378] *21.3.1 Guidelines on Turnitin.pdf*

| | |
|---|---|
| | burime të jashtme sigurojnë vazhdimësinë dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në program. Bazuar në këto elemente, vlerësohet se standardi për përputhjen e strukturës së buxhetit me politikat institucionale dhe nevojat kërkimore është **plotësisht i përmbushur**, duke reflektuar një menaxhim efektiv dhe të qëndrueshëm të financave në funksion të objektivave akademike dhe shkencore të programit të doktoraturës. |
| **Kriteri 6.** Financimet e jashtme të përfituara për kërkim shkencor janë tregues të veprimtarisë kërkimore me nivel të lartë dhe administrohen për mbarëvajtjen e programit përkatës të studimeve. | Financimet e jashtme të përfituara nga institucioni për kërkim shkencor dëshmojnë një aktivitet të qëndrueshëm dhe cilësor kërkimor, në përputhje me prioritetet strategjike të institucionit dhe të programit të doktoraturës. Universiteti Evropian i Tiranës ka treguar aftësi të konsoliduara në sigurimin dhe administrimin e granteve kombëtare dhe ndërkombëtare përmes pjesëmarrjes në projekte si Erasmus+, Horizon Europe, COST Action dhe AKKSHI[379]. Këto financime mbështesin drejtpërdrejt aktivitetet kërkimore të kandidatëve për doktoraturë dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së kërkimit shkencor dhe të infrastrukturës mbështetëse[380].Buxheti i dedikuar për kërkimin përfshin akses në mjete dhe databaza të rëndësishme për kërkim shkencor (si Turnitin[381], SPSS, EBSCO, SAGE, RESEARCH4LIFE), si dhe mbështetje për publikime dhe pjesëmarrje në konferenca. Kjo tregon një përkushtim të qartë institucional për të garantuar një mjedis të favorshëm për kërkimin dhe për zhvillimin profesional të doktorantëve. Bazuar në gjetjet, ky standard konsiderohet plotësisht i përmbushur, pasi institucioni ka krijuar mekanizmat e duhur për sigurimin, administrimin dhe orientimin e fondeve të jashtme drejt objektivave kërkimore të programit të doktoraturës. |
| **Kriteri 7.** Modalitetet e përdorimit të të ardhurave nga projektet dhe shërbimet ndaj subjekteve të tjera rregullohen me akte të posaçme të njësisë kryesore | Institucioni ka vendosur një praktikë të qëndrueshme për sigurimin dhe përdorimin e të ardhurave nga projektet dhe shërbimet që ofron ndaj subjekteve të tjera. Modalitetet e përdorimit të këtyre të ardhurave rregullohen me akte të posaçme të njësisë kryesore dhe miratohen nga administratori, |

379 *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*
380 *22.3 Strategy for International Cooperation and Project MAnagment 2023-2028'.pdf*
381 *21.3 Udhezues per stafin dhe studentet mbi plagjiaturen.pdf*

| | |
|---|---|
| dhe miratohen nga administratori i saj. | duke siguruar transparencë dhe përputhshmëri me politikat institucionale[382].<br><br>UET demonstron një angazhim të vazhdueshëm në sigurimin e financimeve të jashtme përmes pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare[383]. Këto të ardhura janë përdorur për zhvillimin e infrastrukturës kërkimore, ngritjen e kapaciteteve akademike dhe për mbështetjen e aktiviteteve kërkimore të studentëve të doktoraturës. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe praktikat institucionale, ky skriter konsiderohet i përmbushur plotësisht, pasi të ardhurat nga projektet administrohen në mënyrë të strukturuar dhe në funksion të qëllimeve kërkimore të programit të doktoraturës. |
| **Kriteri 8.** Përdorimi i mjeteve financiare të alokuara për zhvillimin e programit të doktoratës është objekt i raportimit dhe auditimit të vazhdueshëm. | Institucioni ka vendosur mekanizma të qartë për raportimin dhe auditimin e përdorimit të mjeteve financiare të alokuara për zhvillimin e programit të doktoratës. Përdorimi i të ardhurave që burojnë nga shërbimet dhe projektet ndjek procedura të rregulluara nga aktet e brendshme të institucionit dhe kërkon miratim nga administratori, duke garantuar kontroll dhe transparencë financiare. Raportimi i rregullt dhe auditimi i veprimeve financiare kontribuojnë në sigurimin e pajtueshmërisë me politikat institucionale dhe legjislacionin përkatës. Kjo qasje dokumenton angazhimin e institucionit për menaxhim të përgjegjshëm të burimeve dhe për sigurimin e një baze të qëndrueshme financiare për funksionimin dhe zhvillimin e programit të doktoratës. |
| **Kriteri 9.** Kandidatët e pranuar mund të përfitojnë nga financimi i siguruar nga institucioni, të ardhurat dytësore apo të vetëfinancohen për studimet e doktoratës. | Institucioni u ofron kandidatëve të pranuar në programin e doktoratës mundësi të shumta për mbulimin e kostove të studimeve, përfshirë financimin e siguruar nga vetë institucioni, të ardhura dytësore nga projekte apo angazhime të tjera, si dhe vetëfinancimin. Përdorimi i fondeve për këtë program zbatohet në përputhje me rregulloret dhe procedurat që vlejnë për të gjitha programet e tjera të institucionit.<br><br>Këto mekanizma mbështetëse, të kombinuara me qasjen e njëjtë rregullatore për menaxhimin financiar, sigurojnë barazi trajtimi |

[382] *22.1 Udhëzues Zyra për Projekte dhe Ndërkombëtarizim.pdf*
[383] *22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024_Doktoratura.pdf*





| | |
|---|---|
| | për doktorantët dhe ruajnë qëndrueshmërinë administrative dhe financiare të programit. |
| **Konkluzione** | *Institucioni siguron burime të ndryshme financimi për kandidatët e doktoratës, përfshirë fonde të brendshme, projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe mundësinë e vetëfinancimit. Modalitetet e përdorimit të fondeve rregullohen me akte të posaçme dhe miratohen nga organet përkatëse, duke garantuar transparencë dhe pajtueshmëri me rregulloret institucionale. Përdorimi i buxhetit është objekt raportimi dhe auditimi të rregullt, dhe struktura e shpërndarjes financiare përputhet me nevojat kërkimore të programit të doktoratës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. KËRKIMI SHKENCOR, ARRITJET DHE REZULTATET

| **Standardi IV.1**<br><br>**Ngritja e vazhdueshme e nivelit teorik dhe nxitja e punës kërkimore janë pjesë e planit të veprimtarive të kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Niveli i zhvillimit të kërkimit shkencor ndihmon në aftësimin e studentit për të përfunduar me sukses programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe në përmbajtjen e programit të doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës (UET), rezulton se ky program është projektuar të zhvillohet brenda një mjedisi që promovon kërkimin shkencor dhe angazhimin akademik të studentëve në mënyrë progresive dhe të strukturuar. Institucioni paraqet disa mekanizma konkretë që synojnë mbështetjen aktive të |

| | |
|---|---|
| | studentëve për përfundimin me sukses të studimeve doktorale, si më poshtë:<br><br>1. **Përfshirja e studentëve në projektet kërkimore të mbikëqyrësve**<br><br>Nga takimet me studentët e doktoraturës ata u shprehën se inkurajohen të integrohen në projektet kërkimore të mbikëqyrësve të tyre, duke mundësuar një sinkronizim të objektivave kërkimore dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm akademik. Ky mekanizëm konsiderohet si një mënyrë efektive për të nxitur përkushtimin e studentëve ndaj kërkimit dhe për të siguruar progresin sistematik të tyre drejt përfundimit të studimeve.<br><br>2. **Mbështetje në metodologji dhe teori kërkimore**<br><br>Programi ofron module të dedikuara për formimin metodologjik dhe teorik të studentëve, me fokus në dizajnin kërkimor dhe zhvillimin e aftësive për formulimin, zbatimin dhe menaxhimin e një projekti kërkimor shkencor. Një shembull i dokumentuar është ofrimi i moduleve trajnuese gjatë periudhës janar–shkurt 2025 mbi aspektet themelore të përgatitjes së projektit kërkimor, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, si dhe menaxhimin etik të kërkimit. Ky komponent vlerësohet si thelbësor për aftësimin teknik dhe konceptual të studentëve.<br><br>3. **Zhvillimi i seancave metodologjike dhe diskutimit akademik**<br><br>Institucioni ka vendosur një praktikë të rregullt të seancave metodologjike, të cilat shërbejnë si hapësira ndërveprimi akademik për prezantimin dhe shqyrtimin e projekteve kërkimore nga studentët e doktoraturës. Të drejtuara nga anëtarë të kualifikuar të stafit akademik (me tituj Prof. Dr., Prof. Assoc. dhe Dr.[384]), këto seanca kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së kërkimit dhe promovimin e kulturës së kritikës shkencore. Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe strukturës |

[384] CV e stafit

| | |
|---|---|
| | së programit, konstatohet se niveli i zhvillimit të kërkimit shkencor në kuadër të programit të doktoraturës në UET përbën një komponent të integruar dhe funksional, i cili mbështet aftësimin e studentëve për të përfunduar me sukses programin e tyre studimor. |
| **Kriteri 2.** Studentët e doktoratës marrin pjesë në aktivitetet e parashikuara të doktoratës jashtë punës kërkimore të tyre si ligjërata, seminare, debate ndërdisiplinare, të organizuara në kuadër të programit të doktoratës, ndjekin prezantime të doktorantëve dhe të projekteve kërkimore edhe kur kjo nuk lidhet drejtpërdrejt me interesin e kërkimit të studentit. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) promovon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit akademik të studentëve të doktoraturës, duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre përtej angazhimeve kërkimore të ngushta. Kjo përfshirje realizohet përmes aktiviteteve dhe strukturave të mëposhtme:<br>1. Angazhimi në Aktivitetet Ndërdisiplinore<br>Studentët e doktoraturës janë të përfshirë në aktivitete ndërdisiplinore si pjesë e programit, duke marrë pjesë në *Ditët e Doktoraturës*, kolokiume dhe seminare të organizuara nga Shkolla e Doktoraturës[157]. Këto aktivitete nxisin ndërveprimin ndërdisiplinor dhe ndihmojnë në zhvillimin e kapaciteteve akademike të studentëve[385].<br>2. Mjedisi Mësimor i Përbashkët<br>UET ofron një mjedis bashkëpunues ku studentët e doktoraturës inkurajohen të ndajnë eksperiencat e tyre me kolegët nga fusha të ndryshme, duke promovuar kështu një shkëmbim të vlefshëm metodologjik dhe praktik. Ky mjedis mbështet krijimin e një komuniteti akademik të hapur dhe gjithëpërfshirës.<br>3. Leksionet: Seminari Doktoral në Metodologji dhe Teori Bashkëkohore në Shkencat Sociale dhe të Sjelljes<br>Studentët kanë mundësinë të marrin pjesë në seminare dhe leksione të avancuara që trajtojnë tema bashkëkohore në metodologjinë e kërkimit dhe teoritë në shkencat sociale dhe të sjelljes, duke ndërtuar një bazë të fortë akademike për punën e tyre kërkimore.<br>4. Mbrojtja e Bardhë dhe Mbrojtja Finale<br>Universiteti ka konceptuar proceset e *Mbrojtjes së Bardhë* dhe *Mbrojtjes Finale* si ngjarje akademike të hapura, ku studentët |

[385] 10.3 Call for Erasmus Exchange Doctoral Studies_Saarland; 2.11 Call for papers DSSH 2025; 10.8 Trajnim online Erasmus REzEB; 16.2 Dita doktorale dhe kolokiumi doktoral 7 Dhjetor 2023

| | |
|---|---|
| | kanë mundësinë të përfshihen si pjesëmarrës apo dëgjues, duke përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga procesi i prezantimit dhe vlerësimit të projekteve kërkimore. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore siguron mekanizma promovimi dhe mbështetje për studentët që të marrin pjesë në aktivitete dhe veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit në fushën e veprimtarisë së tyre. | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Universiteti Europian i Tiranës (UET), konstatohet se institucioni ofron një sërë mekanizmash të qëndrueshëm për të nxitur dhe mbështetur përfshirjen aktive të studentëve të doktoraturës në veprimtari shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, në përputhje me fushën e tyre të kërkimit. Në mënyrë të veçantë, vlerësohen këto aspekte:<br><br>**Pjesëmarrja në konferenca dhe aktivitete akademike**<br><br>Institucioni paraqet të dhëna që dëshmojnë angazhimin e studentëve të doktoraturës në konferenca shkencore dhe aktivitete ndërkombëtare të zhvilluara në bashkëpunim me rrjete dhe institucione akademike evropiane. Pjesëmarrja e tyre në këto aktivitete ofron mundësi për rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe promovimin e rezultateve të punës shkencore.<br><br>**Mbështetje financiare dhe logjistike për mobilitetin akademik**<br><br>UET ofron mbështetje të strukturuar për studentët që aplikojnë për pjesëmarrje në aktivitete jashtë vendit, përmes mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit, tarifave të regjistrimit apo kostove të publikimit. Po ashtu, studentët përfitojnë nga mundësitë e mobilitetit që krijohen përmes përfshirjes në projekte me financim ndërkombëtar (Erasmus+, IPA, etj.), si dhe nga bashkëpunimet institucionale me universitete të huaja.<br><br>**Angazhim i brendshëm akademik dhe shkencor**<br><br>Institucioni organizon rregullisht aktivitete të brendshme me natyrë akademike, si leksione të hapura, konferenca shkencore, workshop-e dhe tryeza diskutimi, ku studentët e doktoraturës ftohen aktivisht të prezantojnë dhe diskutojnë projekte |

| | |
|---|---|
| | kërkimore. Këto aktivitete krijojnë një mjedis të gjallë akademik dhe inkurajojnë zhvillimin e aftësive prezantuese dhe kritike.<br><br>**Mekanizma të vazhdueshëm informimi dhe inkurajimi**<br><br>UET mbështet vazhdimisht studentët e doktoraturës edhe përmes një procesi të rregullt informimi dhe inkurajimi për aplikim në thirrje për pjesëmarrje në veprimtari shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kjo qasje proaktive e institucionit rrit ndërgjegjësimin, motivimin dhe përfshirjen e studentëve në zhvillimin e karrierës së tyre akademike dhe kërkimore. Institucioni ka vënë në funksion një sërë mekanizmash promovimi dhe mbështetjeje, të cilat kontribuojnë ndjeshëm në përfshirjen e studentëve të doktoraturës në aktivitetet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me standardin përkatës të këtij kriteri. |
| **Kriteri 4.** Studentët doktorantë bëhen pjesë e aktiviteteve kërkimore, projekteve dhe veprimtarive të tjera të njësisë përgjegjëse. | Studentët kanë marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, janë angazhuar në projekte kërkimore dhe kanë raportuar një sërë publikimesh shkencore, siç përshkruhet në dokumentin mbi Aktivitetin Kërkimor. Të dhënat përmbledhëse përfshijnë 10 artikuj të indeksuar në Scopus, 7 artikuj të botuar jashtë vendit, 17 pjesëmarrje në ASD (Aktivitete Shkencore të Doktoraturës), 10 konferenca kombëtare (përveç ASD), 12 artikuj në revista shkencore shqiptare, 34 konferenca ndërkombëtare dhe 17 projekte ndërkombëtare.<br><br>Megjithatë, gjatë shqyrtimit të listës së artikujve është vënë re se disa publikime të raportuara si arritje kërkimore ndodhen aktualisht në proces rishikimi ose në përgatitje, dhe nuk janë ende të botuara. Kjo përfshin, ndër të tjera, artikullin **I. Xh, N. & Treska, T. (2024)** me titull "The impact of information and communication technology in instruction at university" (IJKL), i cili është në shqyrtim në një revistë të renditur në Scopus (Q3), por statusi in review nuk përbën ende publikim të realizuar dhe nuk duhet raportuar si i tillë. E njëjta vlen për dorëshkrimin **Logu, K. (2024)** me titull "Pragmatic aspect of Albanian political populism in the formation of the foreign policy |

| | |
|---|---|
| | agenda", i cili është në proces përgatitor për revistën Journal of Economic Cooperation and Development[386].<br><br>Për të garantuar përputhjen me standardet ndërkombëtare të raportimit shkencor dhe transparencën akademike, rekomandohet që të bëhet dallim i qartë midis publikimeve të përfunduara dhe atyre në proces, dhe që publikimet të verifikohen mbi baza objective dhe te vendosen në dokumentet mbështetëse (p.sh. përmes DOI, indeksimit aktual në Scopus/Web of Science). Megjithëse aktivitetet kërkimore të studentëve janë të lavdërueshme dhe tregojnë përkushtim, nevojitet një qasje më e strukturuar për të rritur cilësinë dhe sasinë e publikimeve në revista me impakt ndërkombëtar të verifikuar. |
| **Kriteri 5.** Studentët doktorantë promovohen në zhvillimin e aftësive të komunikimit, didaktike duke u angazhuar në mësimdhënie në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. | Angazhimi i studentëve të doktoraturës në procesin mësimor përbën një komponent të rëndësishëm për zhvillimin e aftësive të tyre të komunikimit, transmetimit të dijes dhe formimit didaktik. Kjo praktikë është gjithashtu një kërkesë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi, i cili parashikon që studentët e doktoraturës të përfshihen në veprimtari mësimore.[387]<br><br>Në përputhje me këtë kërkesë ligjore, studentët e doktoraturës pranë Universitetit Europian të Tiranës (UET) janë angazhuar në mësimdhënie, kryesisht në programet e ciklit të parë, brenda UET apo edhe në institucione të tjera të arsimit të lartë në vend. |
| **Konkluzione** | *Bazuar në të dhënat dhe evidencat e ofruara, vlerësohet se programi i doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës është i strukturuar për të ofruar një mjedis kërkimor të përshtatshëm dhe mbështetës për zhvillimin teorik dhe praktik të studentëve. Ka përpjekje të qarta për të përfshirë studentët në projekte kërkimore të mbikëqyrësve, në aktivitete ndërdisiplinare, si dhe në seanca metodologjike që nxisin reflektim dhe zhvillim akademik. Gjithashtu, angazhimi në mësimdhënie dhe pjesëmarrja në veprimtari të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit është i dokumentuar.*<br><br>*Megjithatë, një vërejtje e rëndësishme lidhet me dokumentimin dhe klasifikimin e publikimeve shkencore. Disa publikime të* |

[386] 6.1 Tabela e Veprimtarise Kerkimore
[387] Doctoral Student Folder (Hard Copy)/28. Lista e Doktoranteve ne Mesimdhenie

| | |
|---|---|
| | *raportuara janë ende në proces rishikimi ose përgatitjeje, dhe jo të botuara në revista të indeksuara, çka kufizon saktësinë dhe peshën e treguesve të raportuar.*<br><br>*Kjo sugjeron nevojën për përmirësim në strukturimin dhe monitorimin e prodhimit shkencor të studentëve, veçanërisht në drejtim të publikimeve në revista ndërkombëtare me faktor impakti dhe të indeksuara.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Veprimtaria akademike dhe shkencore e doktorantëve është pjesë integrale e veprimtarive të institucionit dhe ndihmon në rritjen e performancës së kërkimit shkencor në nivel institucional.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentëve u krijohen mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore të institucionit të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjekin studimet e doktoratës. | Programi i doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës (UET) ofron një mjedis aktiv dhe të strukturuar për përfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore të lidhura ngushtë me fushën e tyre studimore. Studentët marrin pjesë rregullisht në konferencën ndërkombëtare vjetore Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH), e organizuar nga vetë institucioni. Kjo konferencë strukturohet sipas pesë panelesh që përputhen me fakultetet dhe fushat kërkimore të UET, duke mundësuar që studentët të aplikojnë dhe të prezantojnë kërkimet në kontekste që reflektojnë interesat e tyre shkencore dhe tematike[388]. Për shembull, DSSH 2024 u zhvillua më 11–12 prill dhe kishte për temë "Jetesa në një Epokë Teknologjike", duke përfshirë panele mbi transformimin teknologjik, inteligjencën artificiale, drejtësinë dhe kujdesin shëndetësor. Konferenca zhvillohet në gjuhën angleze dhe materialet përkatëse publikohen gjithashtu në këtë gjuhë, duke shtuar një dimension ndërkombëtar të dukshëm në përfshirjen e studentëve. |

[388] 22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024 Doktoratura

| | |
|---|---|
| | Përtej konferencave, studentët e doktoraturës inkurajohen të marrin pjesë edhe në projekte kërkimore institucionale, të financuara nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare si Erasmus+, AKKSHI dhe COST Action, të cilat mbështesin zhvillimin e kompetencave të tyre kërkimore në mënyrë ndërdisiplinore dhe të orientuar drejt praktikës akademike[389].<br><br>Gjithashtu, pjesëmarrja në Ditët e Doktoraturës, kolokiumet dhe mbrojtjet e brendshme të punimeve përbën një tjetër mekanizëm aktiv për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe përfshirjen e studentëve në jetën akademike të institucionit. Këto ngjarje krijojnë hapësira për prezantim, reflektim dhe vlerësim të ndërsjellë të projekteve të tyre. Bazuar në sa më sipër, vlerësohet se kriteri përfshihet në mënyrë të strukturuar dhe funksionale në jetën akademike të institucionit dhe kontribuon ndjeshëm në zhvillimin shkencor të studentëve të doktoraturës. |
| **Kriteri 2.** Studentëve u krijohen mundësitë të zbatojnë metodologjitë e reja të kërkimit që ata aplikojnë në dobi të institucionit. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) ka krijuar mekanizma të qartë dhe funksionalë për të mundësuar që studentët e doktoraturës jo vetëm të ekspozohen, por edhe të aplikojnë metodologji të avancuara kërkimore në kuadër të angazhimit të tyre shkencor. Një prej mënyrave përmes së cilës kjo realizohet është përfshirja e studentëve në projekte ndërkombëtare shkencore dhe të ndërtimit të kapaciteteve, të cilat u japin atyre qasje të drejtpërdrejtë në praktika të avancuara metodologjike dhe në mjedise kërkimore ndërkombëtare[390].<br><br>Përmes këtyre angazhimeve, studentët kontribuojnë në përmbushjen e objektivave kërkimore të institucionit, duke aplikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë njohuritë dhe metodologjitë që zhvillojnë gjatë studimeve të tyre. Kjo qasje përforcon rolin e studentëve të doktoraturës si pjesë aktive dhe kontribuese në zhvillimin akademik dhe shkencor të institucionit. |
| **Kriteri 3.** Doktorantët mbështeten të përfshijnë në punën e tyre kërkimore personel akademik dhe | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, konstatohet se përfshirja e personelit akademik dhe e studentëve të tjerë në punën kërkimore të doktorantëve realizohet kryesisht përmes mobiliteteve të zhvilluara në kuadër të marrëveshjeve të |

[389] Dita Doktorale 11.05.2023; 2.2.3.1 Dita Doktorale III E enjte 11 maj 2023 Ora 16.00; Aula Magna; 16.2 Dita doktorale dhe kolokiumi doktoral 7 Dhjetor 2023; 2.2.10.1 Dite Doktorale Bledar Hodo
[390] 163 22.4 PROJEKTE KU UET MERR PJESË 2020-2024 Doktoratura

| | |
|---|---|
| studentë të institucionit ose institucioneve partnere. | bashkëpunimit me institucione partnere, kryesisht universitete dhe institute kërkimore nga vendet e Bashkimit Evropian dhe OECD-së[391]..<br><br>Këto mobilitete kanë shërbyer si platforma efektive për ndërveprim akademik, duke mundësuar kontakte të drejtpërdrejta, shkëmbim përvojash dhe bashkëpunime në projekte kërkimore të përbashkëta. Ato gjithashtu kanë krijuar mundësi për përfshirjen e personelit dhe studentëve në tematika kërkimore të ndërlidhura, në përputhje me fushat e ekspertizës. Megjithatë, vlerësohet se ekzistojnë fusha që mund të përmirësohen më tej. Konkretisht, evidentohet nevoja për:<br><br>• forcimin e **tracing mechanisms** që mundësojnë ndjekjen e progresit kërkimor dhe kontributit të doktorantëve në kornizën më të gjerë të kërkimit institucional;<br>• vlen të konsiderohet **zhvillimi i mekanizmave të strukturuar për mbështetjen e inovacionit dhe patentimit**, në rastet kur kërkimi doktoral prodhon ide me potencial praktik apo teknologjik. Krijimi i një strukture të tillë do të përforconte lidhjen midis kërkimit shkencor, sipërmarrjes dhe transferimit të dijes në shoqëri dhe tregun e punës;<br><br>Një formë e kësaj bashkëpunese pasqyrohet edhe në realizimin e botimeve të përbashkëta mes studentëve të doktoraturës dhe personelit akademik, që konsiderohen si tregues i përfshirjes kërkimore të ndërsjellë. Ndër vite, konkretisht në periudhën 2020–2024, janë raportuar gjithsej 28 mobilitete për studentët e doktoraturës, përfshirë 10 mobilitete në funksion të mësimdhënies dhe 18 për trajnime, si dhe 62 mobilitete të stafit akademik, prej të cilave 46 në kuadër të mësimdhënies dhe 16 për trajnime. |
| **Kriteri 4.** Institucioni krijon mekanizmat e duhur mbështetës për promovimin e arritjeve të studentëve, patentimin e rezultateve, | Universiteti Europian i Tiranës ka vendosur disa mekanizma formalë për promovimin e arritjeve të studentëve të doktoraturës, të përcaktuara në dokumentin "Broshura e Dokumenteve në Mbështetje të Zbatimit të Statutit dhe |

[391] 164 22.6 Total Staff Exchange

| | |
|---|---|
| zhvillimin e mëtejshëm të ideve inovative që ata kanë. | Rregullores së UET"[392]. Sipas këtij dokumenti, Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" përzgjedh çdo vit "Doktoraturën e Vitit", e cila publikohet nga UET Press, shtëpia botuese institucionale.<br><br>Për më tepër, UET Press ka krijuar një Seksion të Disertacioneve, përmes të cilit mundësohet publikimi pa pagesë i disertacioneve të përzgjedhura të studentëve të doktoraturës. Ky është një mjet i vlefshëm për promovimin e punës kërkimore dhe për nxitjen e cilësisë akademike. Megjithëse bëhet fjalë për një proces akreditimi të parë për programin e doktoraturës, ekzistojnë përvoja të mëparshme që dëshmojnë se studentët kanë pasur mundësinë të botojnë në mënyrë të strukturuar dhe institucionale përmes këtij kanali. |
| **Kriteri 5.** Institucioni përfshin studentët doktorantë në veprimtari të tjera jashtë programit të doktoratës, organet drejtuese dhe grupe pune. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) ka nisur të zhvillojë një praktikë të qëndrueshme që synon përfshirjen e studentëve të doktoraturës në aktivitetet kërkimore të institucionit. Kjo qasje pasqyron përpjekjet për të ndërtuar një mjedis kërkimor gjithnjë e më të integruar dhe bashkëpunues. Ndërsa për momentin përfshirja e studentëve në këto veprimtari mbetet ende në nivele modeste, pritet që me konsolidimin e partneriteteve dhe zgjerimin e bashkëpunimeve, kjo pjesëmarrje të rritet ndjeshëm në vitet në vijim. |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e vetëvlerësimit dhe analizën e kriterëve përkatës, vlerësohet se aktiviteti akademik dhe shkencor i studentëve të doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës është i integruar në mënyrë funksionale në veprimtarinë e përgjithshme të institucionit. Studentët marrin pjesë në konferenca të organizuara nga UET, përfshihen në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe kontribuojnë në jetën akademike përmes kolokiumeve, trajnimeve dhe botimeve. Mekanizmat mbështetës si UET Press dhe përzgjedhja e "Doktoraturës së Vitit" përbëjnë forma konkrete të promovimit institucional të arritjeve të tyre.*<br><br>*Për më tepër, ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme për të fuqizuar përfshirjen e studentëve në mobilitete dhe bashkëpunime ndërkombëtare, me pjesëmarrje të dokumentuar* |

[392] 3.4.1 broshura e dokumenteve_2019

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *në programe si Erasmus+ dhe COST. Departamentet, veçanërisht ai i Shkencave Sociale të Aplikuara, kanë kapacitete të mjaftueshme për të mbështetur integrimin e doktorantëve në kërkim dhe për të rritur më tej kontributin e tyre në objektivat shkencore të institucionit.*<br><br>*Megjithatë, disa fusha mund të përmirësohen më tej. Konkretisht, nevojitet një dokumentim më i detajuar mbi përfshirjen e drejtpërdrejtë të doktorantëve në projekte kërkimore specifike dhe rezultatet konkrete që rrjedhin nga ky bashkëpunim.*<br><br>*Gjithashtu, mund të mendohet për zhvillimin e mekanizmave të strukturuar për mbështetjen e inovacionit dhe patentimit të ideve që lindin nga kërkimi doktoral.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Institucioni ka prioritet kryesor ndërkombëtarizimin e studimeve në programin e doktoratës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i doktoratës përfshin doktorantë të regjistruar, që vijnë nga Kosova dhe trojet shqiptare, si edhe nga diaspora shqiptare. | Sipas të dhënave në këtë program studimi numri i studentëve të regjistruar në tre vite akademike është si më poshtë vijon:<br><br>Viti akademik 2021 – 2022 18 studentë;<br><br>Viti akademik 2022 – 2023 13 studentë;<br><br>Viti akademik 2023 – 2024 41 studentë;<br><br>Aktualisht, në program janë të regjistruar katër studentë nga Kosova, duke dëshmuar një hap të parë drejt diversifikimit gjeografik të trupës studentore dhe promovimit të bashkëpunimit akademik rajonal.<br><br>Rregullorja e Programit të Doktoraturës parashikon dispozita të qarta për pranimin e kandidatëve me shtetësi të huaj, duke i konsideruar si të tillë të gjithë aplikantët që nuk kanë shtetësi |





| | |
|---|---|
| | shqiptare[393]. Në përputhje me këtë rregullore, kandidatët e huaj ndjekin të njëjtat kritere dhe procedura për pranimin si kandidatët vendas. Për aplikantët që kanë përfunduar studimet e ciklit të dytë jashtë Shqipërisë, kërkohet njohja e diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, programi ofron fleksibilitet gjuhësor, duke u mundësuar kandidatëve të ndjekin studimet në gjuhën shqipe ose angleze. Në rast se kandidati zgjedh gjuhën shqipe dhe nuk ka një diplomë të marrë në një institucion shqiptar, kërkohet dëshmi për njohjen e gjuhës shqipe. |
| **Kriteri 2.** Programi i doktoratës mundëson regjistrimin e doktorantëve që vijnë nga vende të tjera. | Programi i doktoraturës i ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës është i hapur për aplikantë ndërkombëtarë dhe krijon mundësi reale për regjistrimin e doktorantëve që vijnë nga vende të tjera. Kjo përfshihet në politikat institucionale[394] për ndërkombëtarizimin dhe reflektohet në dokumentacionin rregullator të programit, duke përfshirë procedurat e pranimit, kriteret e përzgjedhjes dhe mbështetjen gjatë integrimit akademik të studentëve të huaj. Në kuadër të bashkëpunimeve me universitete dhe institute kërkimore të huaja, UET ka mundësuar mobilitet hyrës për studentë dhe staf akademik, si dhe ka marrë pjesë në projekte që mbështesin mobilitetin e doktorantëve nga vende të BE-së dhe OECD-së. Për më tepër, gjuha e huaj e përdorur në pjesë të programit dhe fleksibiliteti në drejtim të mentorimit të disertacioneve në gjuhë të huaj janë elementë që e bëjnë programin të aksesueshëm për studentët ndërkombëtarë.<br><br>Gjithashtu, janë të nevojshme hapa të mëtejshëm për të fuqizuar dimensionin ndërkombëtar të programit, përmes promovimit të synuar në rrjete akademike ndërkombëtare dhe përmirësimit të shërbimeve mbështetëse për studentët e huaj, si orientimi, mbështetja administrative dhe integrimi social. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimeve të doktoratës inkurajon mobilitetin e | **N / A** |

[393] 2.1. Regulation of Doctoral Program
[394] Ibid

| | |
|---|---|
| studentëve të huaj pranë institucionit ofrues. | |
| **Kriteri 4.** Programi i studimeve të doktoratës mundëson zhvillimin e së paku një eventi shkencor ndërkombëtar në 2 vjet të organizuar nga njësia përgjegjëse (simpozium, konferencë, kongres) i cili inkurajon pjesëmarrjen e kërkuesve të huaj. | Në kuadër të angazhimit për ndërkombëtarizimin e veprimtarisë akademike, Universiteti Europian i Tiranës (UET) organizon çdo vit konferencën ndërkombëtare Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH), një aktivitet i qëndrueshëm dhe tashmë i konsoliduar që nga viti 2014. Kjo konferencë shërben si një platformë për prezantimin dhe diskutimin e temave kërkimore me fokus në zhvillimet sociale, ekonomike, juridike dhe teknologjike që lidhen me Shqipërinë, rajonin dhe më gjerë.<br><br>Konferenca strukturohet në panele tematike të ndërlidhura me fakultetet e UET dhe synon të krijojë një hapësirë për shkëmbim profesional ndërmjet studiuesve shqiptarë dhe të huaj. Në mënyrë të veçantë, ajo inkurajon pjesëmarrjen e doktorantëve, stafit të ri akademik si dhe profesorëve të ftuar nga universitete evropiane, duke nxitur dialogun shkencor ndërkombëtar dhe mundësi për bashkëpunime afatgjata. Prezantimet në konferencë realizohen në gjuhën angleze, duke rritur aksesin dhe përfshirjen e kërkuesve të huaj. Edicioni i radhës i DSSH do të mbahet në prill 2025 dhe do të jetë edicioni i 12-të. Tema qendrore për këtë vit është "Nxitja e Inovacionit në Kuadrin e Agjendës së Re Konkurruese të BE-së", duke reflektuar orientimin e institucionit drejt standardeve evropiane të kërkimit dhe integrimit akademik. Panelët përfshijnë fusha si inteligjenca artificiale, integrimi ligjor dhe politik në BE, inovacioni në media dhe edukim, bashkëpunimi në STEM dhe zhvillimet në fushën e mjekësisë. Ky aktivitet përmbush kërkesën e standardit për zhvillimin e eventeve shkencore ndërkombëtare në një ritëm të rregullt dhe përbën një komponent kyç në strategjinë e ndërkombëtarizimit të programit të doktoraturës në UET. |
| **Kriteri 5.** Institucioni mbështet pjesëmarrjen e studentëve në eventendërkombëtare në të cilat prezantohen rezultatet e kërkimit të programit të doktoratës. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) mbështet në mënyrë të strukturuar pjesëmarrjen e studentëve të doktoraturës në aktivitete ndërkombëtare ku prezantohen rezultatet e kërkimit shkencor. Studentëve u ofrohet informacion i vazhdueshëm mbi mundësitë për përfshirje në projekte dhe evente ndërkombëtare, si dhe mbështetje konkrete për të marrë pjesë në to. |

| | |
|---|---|
| | Gjatë periudhës së raportuar, studentët kanë përfituar hapësira akademike për prezantimin e kërkimeve të tyre në 34 konferenca ndërkombëtare, ndërsa 28 mobilitete janë realizuar me mbështetje financiare për të mbuluar tarifat e pjesëmarrjes dhe/ose shpenzimet e udhëtimit. Kjo tregon angazhim të qartë institucional për të promovuar përfaqësimin dhe përfshirjen e doktorantëve në hapësira shkencore ndërkombëtare. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbështet publikimin e punimeve kërkimore të udhëheqësve shkencorë doktorantëve dhe personelit akademik, pjesë e programit të doktoratës. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) ofron mbështetje të strukturuar për publikimin e punimeve kërkimore të personelit akademik dhe studentëve të përfshirë në programin e doktoraturës, përmes platformave të veta botuese. Konkretisht, udhëheqësit shkencorë dhe studentët e doktoraturës kanë mundësinë të publikojnë pa pagesë në një sërë revistash shkencore të UET, të ndara sipas fushave përkatëse të studimit.<br><br>Revistat përfshijnë: – *Jus & Justicia* (ISSN 2223-8654), e cila mbulon fushën e shkencave juridike – *Economicus* (ISSN 2223-6295), për shkencat ekonomike – *Polis* (ISSN 2223-8174), me fokus në shkencat sociale dhe politike– *Medicus* (ISSN 2663-7758), për shkencat mjekësore dhe shëndetësore– *Ingenious* (ISSN 2789-480), e dedikuar fushave të teknologjisë dhe inxhinierisë. |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vlerësimin e të gjashtë kritereve, rezulton se Universiteti Europian i Tiranës (UET) ka ndërmarrë hapa të qëndrueshëm dhe të dokumentuar drejt ndërkombëtarizimit të programit të doktoraturës. Programi përfshin studentë nga Kosova dhe diaspora shqiptare, dhe mbështetet nga një kuadër rregullator që favorizon pranimin dhe përfshirjen e kandidatëve me shtetësi të huaj. Organizimi i rregullt i konferencës ndërkombëtare Ditët e Studimeve Shqiptare, me pjesëmarrje të kërkuesve të huaj dhe doktorantëve, përmbush kërkesën për zhvillimin e eventeve shkencore ndërkombëtare.*<br><br>*Studentët përfitojnë nga mundësitë për mobilitet dhe prezantim të punimeve në konferenca ndërkombëtare, me mbështetje financiare për tarifat dhe udhëtimet. Gjithashtu, institucioni ofron hapësira për publikime akademike falas në revistat e UET, dhe mbështet publikimin e punimeve të udhëheqësve shkencorë dhe stafit akademik të përfshirë në programin e doktoraturës.* |

| | |
|---|---|
| | *Në tërësi, veprimtaritë dhe mekanizmat e ngritura tregojnë një angazhim të qartë dhe të vazhdueshëm për të fuqizuar dimensionin ndërkombëtar të programit. Megjithëse ka hapësirë për zgjerim të mëtejshëm në drejtim të diversifikimit gjeografik të trupës studentore dhe publikimeve në revista ndërkombëtare të indeksuara, objektivat e standardit janë përmbushur në mënyrë të plotë.*<br><br>*Sugjerojme se janë të nevojshme hapa të mëtejshëm për të fuqizuar dimensionin ndërkombëtar të programit, përmes promovimit të synuar në rrjete akademike ndërkombëtare dhe përmirësimit të shërbimeve mbështetëse për studentët e huaj, si orientimi, mbështetja administrative dhe integrimi social.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Studenti dëshmon realizimin e veprimtarive të kërkimit shkencor dhe përmbushjen e detyrimeve shkencore për marrjen e gradës "Doktor".** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi përfundimtar i studentëve të doktoratës bazohet mbi produktin kërkimor shkencor të tij i arritur gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve doktorale. | Referuar Rregullores së Programit të Doktoraturës[395] në Universitetin Europian të Tiranës, produkti kërkimor shkencor i studentit vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së studimeve dhe përbën bazën thelbësore të vlerësimit përfundimtar të tij. Në kuadër të shqyrtimit me kujdes kriteret dhe procedurat e vlerësimit të produktit kërkimor shkencor të kandidatëve doktorantë janë:<br><br>**1. Vlerësimi i vazhdueshëm i produktit kërkimor**<br><br>Sipas Rregullores së Programit të Doktoraturës, produkti kërkimor i kandidatëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së studimeve doktorale, duke përfshirë ndjekjen e përparimit të punës kërkimore në çdo fazë. Kjo qasje |

[395] 2.1. Regulation of Doctoral Program

| | |
|---|---|
| | kontribuon në monitorimin sistematik të avancimit akademik të doktorantëve dhe nxit cilësinë e rezultateve shkencore.<br><br>**2. Procesi shumëfazësh i vlerësimit**<br><br>Procesi i vlerësimit është i ndarë në disa faza, duke filluar me "Mbrojtjen e Bardhë" – një fazë paraprake gjatë së cilës kandidati paraqet një draft të konsoliduar të disertacionit dhe merr sugjerime për përmirësim. Vetëm pasi udhëheqësi shkencor jep miratimin, disertacioni dorëzohet për shqyrtim përfundimtar. Ky proces e forcon cilësinë dhe rigorozitetin akademik dhe ofron mundësinë për korrigjime dhe përmirësime të strukturuara.<br><br>**3. Kërkesat për origjinalitet dhe kontribut shkencor**<br><br>Rregullorja e programit thekson se çdo disertacion duhet të përmbajë një kontribut origjinal teorik dhe/ose empirike në fushën përkatëse. Mbrojtja përfundimtare zhvillohet para një jurie me pesë anëtarë, të cilët vlerësojnë në mënyrë të detajuar cilësinë metodologjike, kontributin shkencor dhe përmbajtjen e punës. Nota përfundimtare e doktorantit, në shkallën 0–100, pasqyron këtë vlerësim gjithëpërfshirës.<br><br>**4. Integriteti dhe etikë kërkimore**<br><br>Universiteti kërkon nga kandidatët dorëzimin e një deklarate të origjinalitetit dhe aplikon masa strikte kundër plagjiaturës dhe shkeljeve të tjera etike, duke përfshirë edhe anulimin e disertacionit dhe të rezultatit përfundimtar në rast të konstatimeve të tilla. Kjo praktikë është esenciale për ruajtjen e standardeve të larta akademike dhe besueshmërisë së procesit kërkimor.<br><br>**5. Arkivimi institucional dhe kombëtar**<br><br>Pas mbrojtjes së suksesshme, disertacionet depozitohen në Bibliotekën Shkencore të UET dhe në Bibliotekën Kombëtare, duke garantuar dokumentimin, ruajtjen dhe aksesin publik në punën kërkimore të doktorantëve. Kjo është një praktikë e mirë |

| | |
|---|---|
| | që përmirëson transparencën dhe promovon shkëmbimin e njohurive në komunitetin akademik dhe më gjerë.<br><br>**6. Vlerësimi përfundimtar dhe rekomandime**<br><br>Ekspertët vlerësojnë se Universiteti Europian i Tiranës ka ngritur një sistem të mirëstrukturuar, transparent dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare për vlerësimin e produktit kërkimor të doktorantëve. Procesi shumëfazësh, kërkesat për origjinalitet dhe integritet akademik, si dhe mekanizmat e arkivimit institucional përbëjnë një bazë të fortë për sigurimin e cilësisë së programit.<br><br>*Rekomandohet që Universiteti të vazhdojë përforcimin e këtyre praktikave, duke përfshirë trajnime të rregullta për udhëheqësit shkencorë dhe anëtarët e jurisë, dhe të bëjë përditësime periodike të rregullores, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e kërkimit shkencor dhe metodologjisë së doktoraturës.*<br><br>Kjo qasje e strukturuar siguron që vlerësimi përfundimtar të jetë i bazuar në një proces gjithëpërfshirës, të dokumentuar dhe të lidhur ngushtë me cilësinë e kërkimit të kryer nga kandidati gjatë gjithë programit. |
| **Kriteri 2.** Studenti jep prova që me anë të kërkimit shkencor të realizuar, ai ka sjellë produkte shkencore origjinale, punime shkencore të një niveli të lartë shkencor, disa prej të cilave kanë merituar a meritojnë publikimin në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. | Sipas Rregullores së Programit të Doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës, çdo kandidat është i detyruar të prodhojë produkte shkencore me risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit, të cilat përbëjnë një kontribut të matshëm në avancimin e njohurive shkencore.<br>1. Publikimet e detyrueshme: Studentët e doktoraturës duhet të publikojnë të paktën tre artikuj shkencorë në revista me rishikim akademik (peer-reviewed), ku së paku një duhet të jetë në një revistë të indeksuar në Scopus ose Clarivate Analytics. Ky kusht siguron një standard minimal të ndikimit dhe cilësisë shkencore të kërkimit;<br>2. Pjesëmarrja në konferenca: Kandidatët janë gjithashtu të obliguar të prezantojnë kërkimin në konferenca shkencore ndërkombëtare, dhe të sigurojnë publikimin e përmbledhjeve |

| | |
|---|---|
| | ose punimeve në aktet përkatëse të konferencave (me ISBN/ISSN), si pjesë e dokumentacionit që dëshmon përfshirjen aktive në komunitetin akademik ndërkombëtar;<br>3. Verifikimi institucional: Zyra e Studimeve të Doktoraturës ndjek progresin individual të kandidatëve dhe kërkon dorëzimin e dëshmive konkrete për produktet shkencore, si: – lista e publikimeve, – kopjet e artikujve ose konfirmimet e pranimit për botim, – dëshmi të prezantimeve në konferenca;<br>4. Vlerësimi i cilësisë së produktit: Gjatë Mbrojtjes së Brendshme dhe mbrojtjes finale, mentorët dhe anëtarët e jurisë vlerësojnë jo vetëm disertacionin, por edhe historikun e publikimeve. Prania e artikujve në revista me rishikim shkencor dhe pjesëmarrja aktive në konferenca është tregues i qartë i kapacitetit të kandidatit për të kontribuar në mënyrë origjinale dhe të qëndrueshme në kërkimin shkencor;<br>5. Tregues të përputhshmërisë: Vlerësimi i meritës shkencore bazohet në faktorë të matshëm si:– citimet,– indeksimi në Scopus/Clarivate,– prova të procesit të rishikimit akademik,– lloji i publikimeve (artikuj, kapituj libri, akte konferencash);<br><br>Këto komponentë krijojnë një sistem të qartë e të monitorueshëm për të vlerësuar nëse produktet e kërkimit janë të nivelit të kërkuar për përfundimin me sukses të studimeve doktorale. |
| **Kriteri 3.** Udhëheqësi dhe studenti doktorant garanton përmbushjen e detyrimeve lidhur me individualitetin e punimit dhe eliminimit të plagjiaturës në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të njësisë përgjegjëse. | Universiteti Europian i Tiranës ka vendosur një kuadër të qartë dhe gjithëpërfshirës rregullator që garanton integritetin akademik dhe promovon respektimin e standardeve të etikës në kërkimin shkencor. Rregullorja e Programit të Doktoraturës (Kapitulli VI, nenet 6.3.2–6.3.9) parashikon detyrime specifike si për studentin ashtu edhe për udhëheqësin shkencor për të siguruar origjinalitetin e disertacionit dhe shmangien e çdo forme të plagjiaturës[171].<br><br>Studenti është i detyruar të paraqesë një deklaratë të nënshkruar, ku garanton se punimi përfaqëson punën e tij/saj të pavarur dhe origjinale. Në rast se përfshihen pjesë nga punime të mëparshme të botuara apo të paraqitura në formate të tjera, ato duhet të identifikohen qartë dhe të referohen siç duhet. Disertacioni gjithashtu duhet të pasqyrojë kontributin personal të kandidatit, |

| | |
|---|---|
| | veçanërisht në rastet kur pjesë të tij janë zhvilluar në kuadër të projekteve të përbashkëta.<br><br>Referencimi korrekt është një komponent thelbësor i standardeve të etikës kërkimore. Studentët janë të detyruar të përdorin forma të sakta të citimit për çdo burim të jashtëm, të shënojnë qartë çdo citim të drejtpërdrejtë dhe të dallojnë përmbajtjen origjinale nga ajo e huazuar. Po ashtu, çdo devijim nga rregullat e ndershmërisë akademike, përfshirë mashtrimet, falsifikimet apo plagjiaturën, i referohet Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës "Doktor" për vlerësim dhe masa të mundshme disiplinore. Roli i udhëheqësit është i pazëvendësueshëm në këtë proces: ai/ajo duhet të sigurojë që që në fazat fillestare të kërkimit të jetë vendosur qartësisht mospranueshmëria e çdo shkeljeje etike dhe të udhëzojë studentin për të ndjekur praktikat më të mira të referencimit dhe prezantimit të autorësisë. Këto mekanizma përbëjnë një garanci të qartë për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, ruajtjen e standardeve shkencore dhe përmbushjen e plotë të kërkesave ligjore për disertacionin e doktoratës. |
| **Kriteri 4.** Studenti jep prova të veprimtarisë kërkimore të nivelit të lartë siç janë publikime me citime, veprimtari botuese e kërkimore-shkencore jashtë vendit, prezantime të rezultateve në nivel ndërkombëtar, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, projekte, etj. | Të dhënat e dokumentuara nga Universiteti Europian i Tiranës dëshmojnë se studentët e doktoraturës janë përfshirë në mënyrë aktive në veprimtari kërkimore dhe botuese të nivelit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, duke përmbushur kërkesat e këtij kriteri për kontribut shkencor të verifikueshëm dhe me ndikim ndërkombëtar[396].<br><br>Nga momenti i regjistrimit në programin e doktoraturës e deri në fazat përfundimtare, studentët kanë arritur të realizojnë:<br><br>• 10 artikuj të indeksuar në Scopus, si tregues i drejtpërdrejtë i publikimit në revista të njohura ndërkombëtare me rishikim shkencor;<br>• 7 artikuj të publikuar jashtë vendit, që reflektojnë përfshirjen në hapësira kërkimore ndërkombëtare;<br>• 34 konferenca ndërkombëtare, ku studentët kanë prezantuar gjetjet e tyre para audiencave akademike shumëdisiplinare; |

[396] 172 6.1 Tabela e Veprimtarise Kerkimore

| | |
|---|---|
| | • 17 pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, që përfshijnë programe të bashkëpunimit kërkimor si Erasmus+, COST etj;<br>• Si dhe aktivitet të qëndrueshëm në nivel vendor, me 17 pjesëmarrje në ASD, 10 konferenca kombëtare dhe 12 artikuj në revista shkencore shqiptare;<br><br>Vlen të theksohet se disa nga artikujt e raportuar ndodhen ende në proces rishikimi dhe si të tillë nuk mund të trajtohen në mënyrë të barabartë me publikimet e përfunduara, megjithatë përfshirja në revista me rishikim të njohur mbetet një tregues pozitiv i drejtimit të angazhimit shkencor.<br><br>Ky rekord demonstron jo vetëm aktivizimin kërkimor të studentëve, por edhe një qasje të qëndrueshme drejt ndërkombëtarizimit të produktit të tyre shkencor. Të dhënat pasqyrojnë përmbushjen e plotë të këtij kriteri në aspektin e cilësisë, sasisë dhe diversitetit të angazhimit kërkimor. |
| **Kriteri 5.** Studenti dëshmon se ka plotësuar kriteret bazë, që duhen përpara mbrojtjes së disertacionit, si:<br>• Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të | Studenti dëshmon se ka plotësuar kriteret bazë, që duhen përpara mbrojtjes së disertacionit, si:– të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare;– të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 2 (dy) të jenë të indeksuara në vendet e OECD-së, BE-së ose G20-ës.<br><br>Po, ky kriter është formalizuar në rregullore, por për momentin nuk mund të vlerësohet në mënyrë të verifikueshme, për shkak të mungesës së dorëzimit të draftit të parë të disertacionit (pre-defense) nga ndonjë prej studentëve. Sipas Rregullores së Programit të Doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës, para mbrojtjes përfundimtare të disertacionit, studenti duhet të:<br>• Ketë realizuar së paku tre prezantime, ku dy prej tyre të jenë të mbajtura në evente shkencore ndërkombëtare në një nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës. Prezantimet duhet të jenë pranuar pas një procesi rishikimi shkencor paraprak dhe të jenë botuar në proceedings me kod ISBN/ISSN; |

| | |
|---|---|
| një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;<br>• Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 2 (dy) të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës, me bord editorial, ku, së paku, në njërin prej tyre të jetë autor i parë dhe në tjetrin autor i dytë. | • Ketë publikuar të paktën tre artikuj shkencorë, ku dy të jenë në revista të indeksuara ndërkombëtarisht (p.sh, Scopus, Journal Citation Reports), dhe ku në të paktën një artikull studenti të jetë autor i parë dhe në një tjetër autor i dytë;<br><br>Sidoqoftë, deri në momentin e raportimit, asnjë student nuk ka kaluar ende në fazën e Mbrojtjes së Brendshme, çka do të siguronte verifikimin e përmbushjes së këtyre kushteve. Si rrjedhojë, nuk janë të disponueshme të dhëna të plota për të konfirmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë realizimin e këtij kriteri në praktikë.<br><br>Pavarësisht kësaj, dokumentacioni i raportuar nga Zyra e Studimeve të Doktoraturës, përfshirë raportet e progresit dhe komunikimin zyrtar me studentët, tregon se UET ka ngritur një mekanizëm funksional monitorimi dhe është në dijeni të plotë për rëndësinë dhe detyrueshmërinë e këtij kriteri. Për më shumë informacion, i referohemi listës së aktiviteteve shkencore të studentëve, e cila ruhet dhe përditësohet nga njësia përkatëse. |
| **Kriteri 6.** Studenti dorëzon dhe prezanton punimin e plotë para jurisë së ngritur nga njësia përgjegjëse si parakusht i mbrojtjes finale para jurisë së miratuar nga Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" duke garantuar përmbushjen e cilësisë akademike të disertacionit. | Universiteti Europian i Tiranës ka ndërtuar një procedurë të qartë dhe të strukturuar për dorëzimin dhe prezantimin e disertacionit, e cila siguron vlerësimin e plotë dhe të paanshëm të cilësisë akademike të punës kërkimore, në përputhje me Rregulloren e Programit të Doktoraturës (nenet 6.4 dhe 6.5)[173].<br><br>**1. Formimi i jurisë vlerësuese:**<br><br>Juria e parë, e ngritur nga njësia bazë, përbëhet nga pesë anëtarë, ku të paktën tre mbajnë titullin "Profesor", ndërsa të tjerët janë "Profesorë të Asociuar" me përvojë akademike të konsiderueshme. Dy nga anëtarët veprojnë si oponentë shkencorë, përfshirë një përfaqësues të jashtëm të institucionit.<br><br>**2. Prezantimi para jurisë:**<br><br>Studenti paraqet disertacionin në një seancë publike ose të mbyllur, sipas rastit. Prezantimi zgjat 25–30 minuta, dhe pasohet nga vlerësimet e shkruara të oponentëve, të cilët |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">shqyrtojnë origjinalitetin, përputhjen me objektivat dhe cilësinë metodologjike. Më pas, vijon diskutimi me pyetje nga anëtarët e jurisë.<br><br>3. Vlerësimi përfundimtar:<br><br>Pas përfundimit të prezantimit dhe diskutimit, juria voton në mënyrë të fshehtë, duke përdorur një shkallë vlerësimi nga 0 në 100 pikë. Ky proces siguron transparencë, objektivitet dhe besueshmëri në vlerësimin e cilësisë së kërkimit shkencor.<br><br>Gjatë vizitës në institucion, u paraqitën dokumente zyrtare që konfirmonin zbatimin e kësaj procedure, përfshirë dosjet e jurive, formatet e vlerësimit dhe protokollet e mbrojtjeve të brendshme. Dokumentacioni i konsultuar dëshmoi përmbushjen e qartë të këtij kriteri dhe funksionimin e mekanizmit të brendshëm të kontrollit të cilësisë.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 7. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, studenti bën plotësimet e vërejtjeve, rekomandimeve dhe i prezanton ato para jurisë së njësisë përgjegjëse brenda një periudhe 3 mujore.</td><td colspan="4">Sipas nenit 4.3.f të Rregullores së Programit të Doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës, është e parashikuar mundësia që në rast të vlerësimit negativ të disertacionit dhe/ose dosjes së kandidatit nga njësia bazë, kandidati ka të drejtë të ripunojë dhe dorëzojë sërish materialin e korrigjuar, pas një periudhe jo më të shkurtër se tre (3) muaj nga njoftimi i vendimit negativ[397].</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Studentët e doktoraturës dorëzojnë dhe mbrojnë punime origjinale të mbështetura nga publikime të indeksuara dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.<br><br>Udhëzimet për integritetin akademik dhe procedurat për rishikim, vlerësim dhe korrigjim janë të qarta dhe funksionale. Gjatë vizitës u verifikuan dokumente mbështetëse që dëshmojnë zbatimin korrekt të këtyre procedurave.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

[397] 2.1. Regulation Doctoral Program

| **Standardi IV.5**<br><br>**Studenti përgatit disertacionin për marrjen e gradës "Doktor" dhe dokumentacionin e nevojshëm dhe e paraqet atë para jurisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" miraton jurinë e mbrojtjes së disertacionit në përbërje të së cilës janë anëtarë nga kategoria "profesor" të fushës që mbulon studimi i doktoratës dhe së paku një prej tyre të jetë me gradën PhD ose më shumë nga një institucion i vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës. | Në referencë me Rregulloren e Programit të Doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës, është vendosur një procedurë e qartë për përbërjen dhe aprovimin e jurisë së mbrojtjes së disertacionit[398]. Institucioni ka përcaktuar për përbërjen dhe miratimin e jurisë së mbrojtjes së disertacionit, sipas Rregullores së Programit të Doktoraturës. Sistemi i miratuar parashikon që juria përbëhet nga pesë (5) anëtarë me ekspertizë relevante në fushën e studimit të doktorantit. Nga këta, të paktën tre duhet të kenë titullin akademik "Profesor", duke siguruar një nivel të lartë ekspertize akademike dhe kërkimore. Në situata kur nuk mund të përfshihen pesë anëtarë me këtë titull, rregullorja lejon përfshirjen e "Profesorëve të Asociuar" me përvojë të dokumentuar akademike, të cilët mund të vijnë si nga institucionet vendore, ashtu edhe nga ato ndërkombëtare.<br><br>Ky model kombinon rigorozitetin akademik me fleksibilitetin e nevojshëm për të përzgjedhur anëtarë të jurisë me profil profesional dhe kërkimor të përshtatshëm, duke garantuar cilësinë dhe drejtësinë e vlerësimit të disertacionit.<br><br>Rregullorja kërkon gjithashtu që dy oponentë të caktohen nga Komiteti për Dhënien e Gradës "Doktor", ku njëri prej tyre duhet të jetë nga jashtë institucionit. Këta oponentë janë gjithashtu anëtarë të jurisë dhe përgjegjës për vlerësimin e disertacionit. Edhe pse rregullorja nuk e përmend në mënyrë eksplicite kërkesën që një prej anëtarëve të jurisë të jetë me PhD nga një institucion i BE-së, OECD-së apo G20-ës, kërkesa për një rekord të fortë kërkimor dhe përvojë ndërkombëtare në botime sugjeron një përputhje të pjesshme me këtë standard. Megjithëse struktura e përcaktuar përbën një bazë të qëndrueshme dhe e përmbush pjesërisht qëllimin e standardit, do të ishte e rekomandueshme që në dokumentacionin |

[398] Ibid

| | |
|---|---|
| | mbështetës të reflektohet më qartë përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë me tituj nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës, si dëshmi e konkretizimit të kërkesës për ndërkombëtarizim të procesit të vlerësimit. Ekspertët vlerësojnë se përbërja e jurisë është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe përfaqëson një standard të lartë akademik, i cili siguron një proces mbrojtjeje të drejtë, profesional dhe të besueshëm. |
| **Kriteri 2.** Kandidati harton disertacionin sipas formatit të miratuar në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve. Disertacioni duhet të sjellë risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit, si dhe të jetë një kontribut në avancimin e njohurive shkencore. | Rregullorja e Programit të Doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës përcakton qartë udhëzimet për hartimin e disertacionit, në përputhje me kërkesat akademike të ciklit të tretë të studimeve. Disertacioni duhet të ndjekë një format të strukturuar që përfshin gjatësi të përcaktuar (zakonisht midis 50,000–60,000 fjalë, përjashtuar fusnotat dhe bibliografinë), specifikime teknike (p.sh., font Times New Roman 12, hapësirë rreshti 1.5) dhe seksione të detyrueshme si titulli, abstrakti (në shqip dhe anglisht), kapitujt, përmbajtja, përfundimet, bibliografia dhe anekset [399] [400]<br><br>Përveç aspektit teknik, disertacioni duhet të përmbajë kontribut origjinal në fushën përkatëse të kërkimit. Sipas nenit 6.3 të rregullores, origjinaliteti mund të përfaqësohet në dy forma:– përmes risive teorike, siç janë modele, qasje ose kuadro të reja konceptuale; ose– përmes kontributeve empirike, si grumbullimi dhe analiza e të dhënave të reja që zgjeron ose sfidon literaturën ekzistuese[178].<br><br>Kjo kërkesë për origjinalitet është në përputhje me standardet ndërkombëtare për studimet e doktoraturës dhe siguron që punimi final i doktorantit të ketë vlerë akademike dhe shkencore. Në këtë mënyrë, kriteri konsiderohet i përmbushur në mënyrë të plotë dhe e mbështet objektivin e avancimit të dijes në nivel institucional dhe më gjerë. |
| **Kriteri 3.** Disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor përpara dorëzimit dhe vlerësohet njësia përgjegjëse sipas | Në përputhje me Rregulloren e Programit të Doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës, procesi i paraqitjes së disertacionit për mbrojtje ndjek një sërë hapash të përcaktuara qartë, të mbështetur në dispozita rregullatore specifike. |

[399] 2.1. Regulation of Doctoral Program
[400] 3.4.1 BROSHURA E DOKUMENTEVE 2019

| | |
|---|---|
| përcaktimeve në aktet rregullatore dhe së bashku me dokumentacionin mbështetës kalon për shqyrtim në Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor". | 1. Miratimi nga udhëheqësi shkencor:<br><br>Para dorëzimit zyrtar, kandidati duhet të marrë miratimin e udhëheqësit shkencor, i cili verifikon përmbushjen e standardeve akademike dhe kërkesave teknike të disertacionit, si dhe origjinalitetin dhe rigorozitetin e përmbajtjes. Gjithashtu, udhëheqësi sigurohet që kandidati të ketë përmbushur të gjitha kërkesat ndërmjetëse, përfshirë rishikimet apo faza të ndërmjetme si Mbrojtja e Bardhë.<br><br>2. Vlerësimi nga njësia përgjegjëse (departamenti/fakulteti):<br><br>Pas miratimit të udhëheqësit, disertacioni i kalon për shqyrtim njësisë përkatëse akademike, e cila kontrollon përputhshmërinë me kërkesat e rregullores së doktoraturës në aspektin e përmbajtjes, strukturës, formatimit, dhe dokumentacionit shoqërues (si raporti anti-plagjiaturë, publikimet, raportet e progresit dhe dëshmitë e prezantimeve).<br><br>3. Paraqitja në Komisionin për Dhënien e Gradës "Doktor":<br><br>Pas vlerësimit nga njësia përgjegjëse, dosja e kandidatit dhe disertacioni përcillen për shqyrtim përfundimtar në Komisionin e përhershëm për Dhënien e Gradës "Doktor", brenda një afati kohor prej 30 ditësh. Nëse njësia përgjegjëse jep një vlerësim negativ, kandidati ka të drejtë të paraqesë një verzion të rishikuar pas një periudhe jo më të shkurtër se tre muaj. Gjithashtu, njësia propozon anëtarët e mundshëm të jurisë së mbrojtjes, duke siguruar përputhjen me kriteret përkatëse institucionale.<br><br>Ky zinxhir procedurash siguron integritet akademik, transparencë dhe përputhje me standardet institucionale dhe legjislative për vlerësimin e punës kërkimore në nivelin e doktoraturës. |
| **Kriteri 4.** Komisioni i përhershëm garanton cilësinë e punës kërkimore shkencore, përmbushjen e objektivave të përcaktuar | Nga analiza dhe vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur dhe i procesit të zhvilluar nga Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës "Doktor" në Universitetin Europian të Tiranës, ekspertët e jashtëm vlerësojnë se Kriteri 4 është përmbushur në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme. Komisioni ka demonstruar një |

| | |
|---|---|
| nga kandidati dhe detyrimeve akademike ligjore për marrjen e gradës doktor. | angazhim të lartë në garantimin e cilësisë së punës kërkimore shkencore, duke ushtruar një proces rigoroz rishikimi dhe verifikimi të disertacioneve dhe dosjeve të doktorantëve. Për më tepër, Komisioni siguron që objektivat e përcaktuara nga kandidatët të jenë të qarta dhe të arritshme, duke monitoruar përmbushjen e tyre gjatë gjithë procesit.<br><br>Ekspertët vlerësojnë gjithashtu se detyrimet akademike dhe ligjore janë respektuar në mënyrë rigoroze, duke përfshirë kontrollet e nevojshme për publikimet shkencore, dokumentacionin mbështetës, si dhe respektimin e afateve dhe procedurave formale. Formimi i jurive brenda afateve të përcaktuara dhe përzgjedhja e ekspertëve me kualifikime të përshtatshme është një element kyç që kontribuon në një proces të drejtë dhe transparent. Megjithatë, duhet theksuar se, duke qenë se doktorantët e parë nuk kanë përfunduar ende dhe nuk janë diplomuar, vlerësimi i plotë i rezultateve përfundimtare të punës kërkimore mbetet i paplotësuar. Megjithatë, institucionit i disponon të gjithë burimet infrastrukturore, organizative dhe akademike të nevojshme për të garantuar një proces të suksesshëm të doktoraturës dhe përmbushjen në të ardhmen të standardeve të kërkuara.<br><br>Në përgjithësi, ekspertët vlerësojnë se Komisioni është në përputhje të plotë me kërkesat e Rregullores dhe ka krijuar një mekanizëm efektiv mbikëqyrës që garanton standardet e larta akademike dhe ligjore për dhënien e gradës "Doktor" në Universitetin Europian të Tiranës. Përmes këtij roli mbikëqyrës dhe vendimmarrës, Komisioni siguron përputhjen e të gjithë procesit të vlerësimit të disertacionit me kërkesat akademike dhe ligjore të nivelit të tretë të studimeve. |
| **Kriteri 5.** Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" garanton përmbushjen e detyrimeve lidhur me individualitetin e punimit | Sipas deklarimit në dokumentacionin e vetëvlerësimit dhe referencës në nenin 4.1 të Rregullores së Studimeve të Doktoraturës[401], Komisioni i Përhershëm ka kompetenca të qarta për të garantuar që çdo disertacion të jetë rezultat i punës së pavarur të kandidatit dhe në përputhje me standardet për eliminimin e plagjiaturës. Ky verifikim realizohet përmes |

[401] 2.1. Regulation of Doctoral Program; 2.11 Mbi zgjedhjen dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore

| | |
|---|---|
| dhe eliminimit të plagjiaturës në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet rregullatore të njësisë përgjegjëse. | shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës, përfshirë raportin e verifikimit të origjinalitetit dhe publikimet që shoqërojnë disertacionin. Në këtë mënyrë, institucioni siguron integritetin akademik dhe cilësinë shkencore të gradës që jepet. |
| **Kriteri 6.** Nëse Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" vlerëson pozitivisht disertacionin, përmbledhjen e miratuar nga udhëheqësi shkencor së bashku me raportimet, vlerësimet e njësisë përgjegjëse, vijon me prezantimin para jurisë. | Në rast se Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" vlerëson pozitivisht disertacionin, përmbledhjen e miratuar nga udhëheqësi shkencor, si dhe raportimet dhe vlerësimet e njësisë përgjegjëse, kandidat i kalon në fazën e prezantimit para jurisë.<br><br>Sipas Rregullores së Programit të Doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës, procedura e kalimit në mbrojtjen publike të disertacionit nis vetëm pas një vlerësimi pozitiv të plotë nga Komisioni i Përhershëm, duke konfirmuar përmbushjen e detyrimeve akademike dhe administrative nga ana e kandidatit.<br><br>Pas kësaj konfirmimi, Komisioni formon Jurinë e Vlerësimit të Disertacionit brenda një afati prej tridhjetë (30) ditësh. Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të jurisë përcaktohen në Dokumentin F.III "Mbi Përzgjedhjen dhe Funksionimin e Komisionit të Përhershëm", pjesë përbërëse e Broshurës së Dokumenteve të UET. Njëri nga anëtarët e jurisë emërohet si kryetar i jurisë nga vetë Komisioni. Pas formimit, juria cakton datën e mbrojtjes së doktoraturës brenda një periudhe pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Procesi i mbrojtjes realizohet me pjesëmarrjen e plotë dhe aktive të të gjithë anëtarëve të jurisë, duke garantuar kështu integritetin, transparencën dhe cilësinë e vlerësimit në këtë fazë përfundimtare të procesit shkencor. *Shih aneks 2.1 Rregullore e programit doktoral*<br><br>Kjo procedurë garanton që kalimi nga vlerësimi i brendshëm institucional në mbrojtjen para jurisë të jetë i mirëstrukturuar, në përputhje me standardet akademike dhe aktet rregullatore të institucionit. |
| **Kriteri 7.** Procedura më të detajuara për fitimin e gradës shkencore "Doktor" | Universiteti Europian i Tiranës ka përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat e këtij kriteri përmes një kuadri të qartë dhe të harmonizuar rregullator që përfshin Statutin e institucionit, |

| | |
|---|---|
| përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë, rregulloren e ciklit të tretë të studimeve dhe rregulloren e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor". | Rregulloren e Ciklit të Tretë të Studimeve dhe Rregulloren e Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës "Doktor". Këto dokumente janë të ndërthurura në mënyrë koherente dhe sigurojnë transparencë dhe kontroll të cilësisë në të gjitha etapat e procesit për përfitimin e gradës shkencore. Rregullorja e Programit të Doktoraturës e miratuar nga UET përshkruan në mënyrë të hollësishme të gjitha procedurat institucionale dhe teknike që rregullojnë procesin për marrjen e gradës, përfshirë:<br><br>• Kriteret akademike dhe kërkesat për përgatitjen dhe strukturën e disertacionit;<br>• Hapat formalë të vlerësimit dhe verifikimit të përmbushjes së detyrimeve;<br>• Rolin dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse (udhëheqësi shkencor, njësia bazë akademike, Komisioni i Përhershëm, Juria e vlerësimit);<br>• Afatet procedurale për çdo fazë të procesit.<br><br>Në funksion të mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë së procesit gjatë gjithë ciklit të tretë të studimeve, Njësia e Doktoraturës ka ndërtuar dhe implementuar instrumente vlerësimi të standardizuara, të cilat lehtësojnë ndjekjen e vazhdueshme dhe objektive të progresit të doktorantëve. Midis tyre, mund të përmendim:<br><br>• **Formati për Vlerësimin e Metodologjisë**, që garanton koherencë ndërmjet objektivave kërkimore dhe qasjes metodologjike të propozuar[402];<br>• **Formati për Vlerësimin e Kërkimit të Doktoraturës**, që përqendrohet në vlerësimin e përmbajtjes shkencore dhe progresit të punës kërkimore[403]..<br><br>Këto formate standarde përbëjnë një mjet të rëndësishëm për mbikëqyrjen e brendshme të cilësisë dhe për nxitjen e një kulture të rregullt dhe të strukturuar kërkimore. Ato reflektojnë një qasje institucionale të mirëorganizuar për garantimin e standardeve akademike dhe mbështesin në mënyrë efektive objektivat e |

[402] 2.2.12 Formati i Vleresimt metodologjik
[403] 2.2.11 Formati i vleresimit te Oponentit per Mbrojtje te Bardhe

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | programit të doktoraturës. Të dyja formatet aplikohen në fazën e Mbrojtjes së Brendshme (Internal Defence), e cila organizohet nga njësia përkatëse përpara se disertacioni të kalojë në shqyrtim nga Komisioni i Përhershëm.<br><br>Kjo fazë ndërmjetëse garanton që puna kërkimore të jetë në përputhje me standardet akademike dhe të përmbushë nivelin e kërkuar për të vijuar drejt mbrojtjes përfundimtare. Përmes këtij kuadri rregullativ të shumëfishtë – Statut, Rregullore e Ciklit të Tretë dhe Rregullore e Komisionit – sigurohet qartësi, rregull dhe transparencë në të gjitha fazat e procesit të fitimit të gradës "Doktor". | | | |
| **Konkluzione** | *Të gjitha procedurat që lidhen me përgatitjen, vlerësimin dhe mbrojtjen e disertacionit në programin e doktoraturës të Universitetit Europian të Tiranës janë të qarta dhe të dokumentuara në aktet rregullatore përkatëse. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës "Doktor" ka një rol të qartë dhe funksional në mbikëqyrjen e cilësisë së punës kërkimore dhe përmbushjes së objektivave të kandidatit, duke ndjekur procedura të strukturuara për përzgjedhjen e jurisë, shqyrtimin e disertacionit dhe vendimmarrjen për mbrojtjen përfundimtare.*<br><br>*Udhëheqësit shkencorë dhe njësitë përkatëse akademike janë të përfshira në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të disertacionit, ndërsa janë ndërmarrë masa konkrete për garantimin e origjinalitetit të punës dhe shmangien e plagjiaturës.*<br><br>*Gjithashtu, aplikimi i formateve të vlerësimit në fazën e Mbrojtjes së Brendshme tregon për një mekanizëm funksional të kontrollit të cilësisë, i mbështetur në standarde të qarta dhe dokumentacion mbështetës. Në tërësi, dokumentacioni dhe praktika institucionale dëshmojnë një përmbushje të plotë të kërkesave të këtij standardi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN DOKTORAL

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni dhe njësia përgjegjëse lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të doktoratës, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe me aktet rregullatore institucionale. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) ka ngritur një sistem të qëndrueshëm dhe të dokumentuar për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG).<br><br>Kuadri rregullator për SBC përfshin dokumente të rëndësishme institucionale si Strategjia e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028, Politika mbi Mësimdhënien, të Nxënit dhe Vlerësimin e Orientuar nga Studentët[404], si dhe Dokumenti F.VII mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë[405]. Këto dokumente përcaktojnë qartë strukturat, objektivat, përgjegjësitë dhe procedurat e sigurimit të cilësisë, duke garantuar një qasje të integruar dhe funksionale në të gjitha nivelet akademike, përfshirë programin doktoral. Përveç tyre, Statuti i UET, Rregullorja e UET, Broshura e Dokumenteve dhe Rregullorja e Programit të Doktoraturës përbëjnë një grup të konsoliduar aktesh rregullatore që janë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe me standardet evropiane të cilësisë. Sigurimi i cilësisë është i ndërthurur me vizionin, misionin, strukturën organizative, proceset e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe me ofrimin e mbështetjes për studentët dhe stafin akademik. Ky sistem gjithëpërfshirës synon jo vetëm |

[404] 20.1 Strategjia Student Centred Learning Teaching and Assessment Policy
[405] 17.1 Strategjia-per-sigurimin-e-cilesise-2023-2028; 17. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

| | |
|---|---|
| | përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale, por edhe garantimin e një përvoje akademike cilësore në të gjitha programet, përfshirë programin e doktoraturës. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Institucioni ka ngritur dhe funksionalizuar një Sistem të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBC), në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare për arsimin e lartë, duke përfshirë **Udhëzimet ESG 2015** dhe **Kodin Shqiptar të Cilësisë në Arsimin e Lartë**. Ky sistem përfaqëson një strukturë të qëndrueshme institucionale që mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha dimensionet akademike, kërkimore dhe administrative.<br><br>Strategjia institucionale për Sigurimin e Cilësisë 2023–2028 përcakton qartë objektivat dhe mekanizmat e ndërhyrjes për monitorimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ajo shoqërohet nga dokumentacion mbështetës (manuale, udhëzues, formate vlerësimi), të cilat kontribuojnë në një kuadër funksional dhe operacional të vlerësimit të brendshëm, transparencës institucionale dhe përmirësimit të proceseve akademike dhe administrative. Një aspekt pozitiv i veçantë është **përfshirja e studentëve dhe aktorëve të jashtëm** në proceset e vlerësimit dhe reflektimit institucional, gjë që dëshmon për përqafimin e një kulture të cilësisë gjithëpërfshirëse dhe transparente.<br><br>Rolin kyç në funksionimin e sistemit e luan **Komisioni i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë (IQAC)**, i cili angazhohet në:<br><br>• vlerësimin periodik të programeve të studimit;<br>• analizimin e performancës së stafit akademik;<br>• shqyrtimin sistematik të kënaqësisë së studentëve përmes mjeteve të standardizuara të grumbullimit të feedback-ut (anketa, fokus-grupe etj);<br><br>Ky mekanizëm siguron një cikël të mbyllur reflektimi dhe përmirësimi, që përputhet me parimet e menaxhimit të cilësisë sipas modelit Plan-Do-Check-Act (PDCA). |

| | |
|---|---|
| | **Nga këndvështrimi i ekspertëve të jashtëm**, struktura e SBC-së në UET rezulton e konsoliduar dhe në përputhje me praktikat evropiane të menaxhimit të cilësisë në arsimin e lartë. Strategjia aktuale dhe përfshirja institucionale në zbatimin e saj përbëjnë garanci për ruajtjen dhe avancimin e standardeve akademike në një perspektivë afatgjatë. Përveç kësaj, IQAC siguron përfshirjen e ekspertëve të jashtëm dhe përfaqësuesve të tregut të punës në rishikimin e vazhdueshëm të programeve, duke garantuar që programet, përfshirë edhe atë të doktoraturës, të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ky mekanizëm gjithashtu mbështet zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave në bazë të inputeve të studentëve, punëdhënësve dhe zhvillimeve më të fundit në fushat shkencore përkatëse. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Universiteti Europian i Tiranës (UET) përdor një gamë të gjerë instrumentesh për sigurimin e cilësisë, të cilat përfshijnë si mekanizma të brendshëm ashtu edhe procese të vlerësimit të jashtëm. Në nivel të brendshëm, një rol të rëndësishëm luajnë anketat periodike të studentëve për vlerësimin e përvojës mësimore dhe të përmbajtjes së programeve, monitorimi i performancës akademike të stafit dhe i rezultateve të kërkimit shkencor, si dhe aktivitetet mbikëqyrëse të zhvilluara nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (IQAC). Këto instrumente mbështeten nga analiza sistematike e të dhënave dhe përpunohen përmes raporteve vjetore të cilësisë dhe dokumenteve vetëvlerësuese.<br><br>Në nivel të jashtëm, UET i nënshtrohet rregullisht proceseve të akreditimit kombëtar nga Agjencia Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAAHE), si dhe vlerësimeve nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, ku raportohen çdo vit të dhëna për mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe performancën e studentëve. Një komponent i rëndësishëm i angazhimit për cilësi është edhe vlerësimi ndërkombëtar: në vitin 2022, UET iu nënshtrua një rishikimi të jashtëm të cilësisë nga një agjenci britanike e akredituar, që rezultoi me sukses në akreditimin ndërkombëtar të institucionit. Këto procese janë të dokumentuara përmes raporteve përkatëse të vlerësimit, të cilat përmbajnë rekomandime të vlefshme për përmirësimin e |

| | |
|---|---|
| | mëtejshëm institucional. Përmes këtyre mekanizmave, UET jo vetëm që përmbush standardet ligjore dhe akademike vendore, por gjithashtu përafron veprimtarinë e vet me praktikat më të mira ndërkombëtare, siç përcaktohet në Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | Institucioni ka formuluar një politikë të qartë institucionale dhe ndjek procedura të mirëstrukturuara për sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBC). **Strategjia e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028** përbën dokumentin politik themelor që udhëheq këto procese, duke specifikuar instrumentet dhe mekanizmat për garantimin e standardeve akademike dhe rritjen e tyre në një cikël të vazhdueshëm përmirësimi.<br><br>Sistemi i SBC-së në Universitetin Europian të Tiranës është ndërtuar mbi tre shtylla kryesore: kontrolli i cilësisë, llogaridhënia dhe përmirësimi i vazhdueshëm. Ky sistem funksionon në të gjitha nivelet institucionale — që nga struktura qendrore drejtuesve të fakulteteve dhe departamenteve — duke përfshirë në mënyrë aktive stafin akademik, administrativ si dhe studentët, si bashkëpërgjegjës në krijimin e një kulture cilësie të qëndrueshme dhe të brendësuar.<br><br>Vlerësimi i brendshëm zhvillohet në mënyrë periodike dhe përfshin të gjitha aspektet kyçe të funksionimit universitar: cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen dhe përditësimin e kurrikulave, kërkimin shkencor, shërbimet për studentët dhe performancën e stafit. Përmirësimet e kurrikulave realizohen çdo fillim viti akademik, mbi bazën e analizave të departamenteve dhe rekomandimeve të nxjerra nga proceset vlerësuese. Gjithashtu, përshtatshmëria e programeve me nevojat e tregut të punës vlerësohet përmes të dhënave të punësimit të të diplomuarve dhe konsultimeve periodike me Bordin e Tregut të Punës.<br><br>Mekanizmat operacionalë për sigurimin e cilësisë përfshijnë: |
| | • vlerësimet online të studentëve; |

| | |
|---|---|
| | • grupet e fokusuara me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm;<br>• vlerësimin e performancës kërkimore të stafit;<br><br>Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe analizohen për të orientuar ndërhyrje konkrete në përmbajtje, metodologji mësimdhënieje dhe mbështetje akademike.<br><br>Nga këndvështrimi i ekspertëve të jashtëm, evidentohet se pavarësisht se nuk janë diplomuar ende doktorantët e parë të programit, institucioni ka vënë në funksion një strukturë të plotë dhe funksionale për mbikëqyrjen dhe përmirësimin cilësor të programit të doktoratës. Kjo përfshin procedura të qarta për mentorimin akademik, vlerësimin periodik të progresit kërkimor, si dhe mekanizma të përshtatshëm për përfshirjen e komunitetit akademik dhe të ekspertëve të jashtëm në monitorimin e standardeve shkencore. Kjo qasje integruese dhe e dokumentuar tregon për angazhimin afatgjatë të institucionit në kultivimin e një kulture të cilësisë së brendshme, të bazuar në standarde akademike, transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm.<br><br>Kultura e cilësisë në UET është ndërtuar si një proces i vazhdueshëm, ku çdo anëtar i komunitetit akademik ka një rol aktiv, dhe është vlerësuar si një praktikë e mirë nga ekipi ndërkombëtar i rishikimit të jashtëm të QAA. |
| **Konkluzione** | *Universiteti Europian i Tiranës ka ndërtuar një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u mbështetur në Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028. Ky sistem përfshin struktura të specializuara si IQAC dhe një sërë mekanizmash të brendshëm dhe të jashtëm për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe kërkimore.*<br><br>*Proceset e rregullta të vetëvlerësimit, rishikimit të kurrikulave, vlerësimet nga studentët dhe përfshirja e aktorëve të jashtëm garantojnë një qasje të koordinuar dhe transparente ndaj cilësisë, duke reflektuar angazhimin institucional për përafrim* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm akademik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni dhe njësia përgjegjëse monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programin të doktoratës, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të doktoratës. | Programi i Doktoraturës në Universitetin Europian të Tiranës i nënshtrohet të njëjtave parime dhe standarde të sigurimit të cilësisë si të gjitha programet e tjera akademike në institucion. Për monitorimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e tij, janë ngritur njësi të posaçme që veprojnë në bashkërendim me Komisionin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (IQAC), i cili mban përgjegjësinë për zbatimin e politikave të sigurimit të cilësisë në nivel institucional.<br>Në mënyrë të veçantë, për administrimin akademik të programit të doktoraturës, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Programit të Doktoraturës, rolet kryesore i takojnë Fakultetit përkatës, Departamentit akademik ku zhvillohet programi, Zyrës së Studimeve të Doktoraturës, si dhe Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Këto njësi janë përgjegjëse për planifikimin, ndjekjen dhe vlerësimin e të gjitha aspekteve të programit, përfshirë organizimin e kurrikulës, procesin e mbikëqyrjes së kërkimit shkencor dhe procedurat e mbrojtjes së disertacionit. IQAC zhvillon rishikime periodike të aktivitetit të këtyre njësive, si pjesë e planit vjetor të monitorimit të brendshëm, duke garantuar përputhshmërinë me standardet e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të doktoraturës. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese | Universiteti Europian i Tiranës përdor mekanizma dhe procese formale, të dokumentuara dhe të harmonizuara me kuadrin |

| | |
|---|---|
| formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit. | ligjor në fuqi për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programit të doktoraturës. Këto mekanizma janë të njëjtë me ato që zbatohen për programet e tjera akademike dhe përfshijnë një sërë hapash institucionalë, duke filluar nga diskutimi në nivel departamenti, bashkërendimi me Zëvendësrektorin për Kërkimin Shkencor dhe Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", deri te miratimi final nga Senati Akademik dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Programi i doktoraturës, i rihapur në vitin 2022, nuk ka hyrë ende në një cikël të plotë rishikimi, megjithatë është nën mbikëqyrje të vazhdueshme nga strukturat përkatëse. Projektet kërkimore të mentorëve janë rritur në numër që nga hapja e programit, dhe janë shqyrtuar në mënyrë të strukturuar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, me ndërhyrje kur është e nevojshme nga autoritetet më të larta akademike. Treguesit për vlerësimin e cilësisë së programit janë të ndarë në dy kategori: tregues sasiorë si numri i publikimeve, normat e përfundimit brenda afatit normativ, pjesëmarrja në konferenca dhe përfshirja në projekte të financuara; dhe tregues cilësorë si origjinaliteti i disertacionit dhe cilësia e vlerësimit përmes mekanizmave të rishikimit shkencor (peer review). Megjithëse deri më tani nuk është zhvilluar ndonjë pre-mbrojtje e disertacionit, strukturat përgjegjëse, përfshirë IQAC, janë të përgatitura për të aplikuar proceset e vlerësimit specifik të programit, siç parashikohet në strategjinë dhe rregulloren përkatëse. Elementë të tjerë të rëndësishëm të vlerësimit përfshijnë cilësinë e mbikëqyrjes akademike dhe efektivitetin e mentorimit, i cili monitorohet përmes feedback-ut të kandidatëve, rregullsisë dhe cilësisë së takimeve midis mentorit dhe doktorandit. |
| **Kriteri 3.** Institucioni ka përcaktuar indikatorë dhe tregues cilësorë të matshëm sasiorë për programin e doktoratës në kudër të vlerësimit të cilësisë së programit. | Për të siguruar një ndjekje sistematike të ecurisë dhe mbarëvajtjes së programit të doktoraturës, Universiteti Europian i Tiranës ka zhvilluar një sërë metodologjish vlerësimi, instrumentesh matëse dhe vlerësuese, të cilat janë të dokumentuara dhe të zbatueshme në të gjitha fazat e ciklit të studimeve. Metodologjitë e vlerësimit përfshijnë rishikimet periodike të progresit kërkimor të studentëve, vlerësimin e punës kursore, feedback-un e rregullt nga mbikëqyrësi, procesin |

| | |
|---|---|
| | e mbrojtjes së disertacionit si dhe përmbushjen e kërkesave të lidhura me publikimet shkencore.<br><br>Gjithashtu, realizohen anketa për matjen e kënaqësisë së studentëve të doktoraturës, duke adresuar aspekte që lidhen me strukturën e programit, cilësinë e mbikëqyrjes, burimet dhe mbështetjen institucionale. Instrumentet matëse përfshijnë listën e kontrollit për etapat kërkimore (si miratimi i propozimit, mbledhja e të dhënave, dorëzimi i punimeve), notat mesatare të punës kursore, numrin dhe cilësinë e publikimeve në revista të indeksuara ose akte konferencash, citimet dhe faktorët e impaktit të revistave, si dhe tregues të tjerë si normat e punësimit, pozicionet profesionale të arritura pas diplomimit dhe mundësitë për studime postdoktorale. Për më tepër, vlerësohet edhe kontributi i kandidatëve në akademi ose industri. Instrumentet e vlerësimit përfshijnë formularin e mbikëqyrësit (i përdorur p.sh. gjatë Ditëve të Doktoraturës), rishikimet nga kolegët dhe stafi akademik gjatë prezantimeve në sesione metodologjike, si dhe raportin e vlerësuesit të jashtëm për disertacionin. Për vlerësimin përfundimtar të disertacionit merren parasysh origjinaliteti dhe kontributi në fushën përkatëse, rigoroziteti metodologjik, cilësia e rishikimit të literaturës, analiza dhe interpretimi i të dhënave, si dhe qartësia dhe koherenca e argumentimit shkencor. Gjithashtu, realizohen anketa me alumni-t për të matur ndikimin e programit në zhvillimin e karrierës së tyre. Departamenti, në bashkëpunim me Zyrën e Studimeve të Doktoraturës dhe/ose IQAC, përgatit raporte të vetëvlerësimit të cilat fokusohen në rezultatet e studentëve, arritjet kërkimore dhe fushat për përmirësim. Treguesit kryesorë për suksesin e programit përfshijnë normat e përfundimit (brenda dhe jashtë afatit), normat e pranimit të disertacioneve, cilësinë dhe sasinë e publikimeve, punësimin e alumni-ve në pozita akademike apo në industri, njohjen e jashtme përmes çmimeve apo granteve, si dhe nivelin e kënaqësisë së të diplomuarve dhe punëdhënësve të tyre. |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe | Për të vlerësuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të doktoraturës, UET përdor metodologji të strukturuara që përfshijnë rishikime periodike të progresit kërkimor, vlerësimin |

| | |
|---|---|
| vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit. | e punës kursore, feedback-un nga mbikëqyrësit, mbrojtjen e disertacionit dhe kërkesat për publikime. Instrumentet matëse përfshijnë listat e kontrollit për etapat kërkimore, notat mesatare, numrin dhe cilësinë e publikimeve, citimet, faktorët e impaktit dhe normat e punësimit. Gjithashtu, realizohen anketa të studentëve për të vlerësuar strukturën, mbikëqyrjen dhe shërbimet mbështetëse të programit, si dhe anketa të alumni-ve mbi ndikimin e studimeve në karrierë. Raportet e vetëvlerësimit të përgatitura nga departamenti, me mbështetjen e Zyrës së Studimeve të Doktoraturës dhe/ose IQAC, fokusohen në rezultatet e studentëve, publikimet, përmirësimet dhe treguesit kryesorë të suksesit si përfundimi në kohë, punësimi, njohja e jashtme dhe kënaqësia e të diplomuarve. |
| **Kriteri 5.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin. | Institucioni ka ndërtuar një sistem të qëndrueshëm dhe të mirëstrukturuar për **dokumentimin dhe shpërndarjen e rezultateve të vlerësimeve të brendshme të cilësisë**, që lidhen me funksionimin dhe zhvillimin e programit të doktoratës. Këto rezultate përpunohen në **raporte të detajuara vjetore**, të cilat analizojnë përparimin e doktorantëve, cilësinë e mbikëqyrjes akademike, si dhe përputhshmërinë e programit me objektivat institucionalë dhe kërkesat e tregut të dijes.<br><br>Raportet i përcillen në mënyrë sistematike **Komitetit të Përhershëm për Dhënien e Gradës "Doktor"**, **Rektoratit** dhe **Bordit të Administrimit**, duke shërbyer si bazë për **vendimmarrje strategjike dhe operacionale**, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e kurikulës, përzgjedhjen e tematikave të kërkimit dhe përforcimin e mekanizmave të mentorimit.<br><br>**Shembull konkret** i kësaj praktike është raporti vjetor i dorëzuar nga Komisioni i Përhershëm në fund të vitit akademik 2023–2024, i cili analizonte progresin individual të çdo doktoranti, vlerësonte angazhimin e udhëheqësve shkencorë dhe rekomandonte disa masa për forcimin e mobiliteteve akademike dhe integrimin e kërkimeve me projektet institucionale. Këto raporte përfshijnë të dhëna mbi ecurinë e përgjithshme të programit, arritjet kërkimore të kandidatëve, efektivitetin e mbikëqyrjes akademike, si dhe tregues të jashtëm të cilësisë si kënaqësia e të diplomuarve dhe punëdhënësve. |

| | |
|---|---|
| | Përmes këtij procesi të dokumentuar, sigurohet që çdo nivel drejtues të ketë akses në informacion të saktë dhe të përditësuar mbi performancën e programit të doktoraturës. Nga këndvështrimi i ekspertëve të jashtëm, kjo praktikë tregon për funksionalitetin e sistemit të sigurimit të cilësisë, përdorimin e të dhënave të mbledhura për përmirësim të vazhdueshëm, si dhe për një nivel të mirë transparence institucionale. Edhe pse procesi i diplomimit të doktorantëve të parë nuk është finalizuar ende, struktura dhe praktikat ekzistuese dëshmojnë një angazhim serioz dhe të dokumentuar për rritjen e cilësisë së programit. |
| **Kriteri 6.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme në përputhje me objektivat institucionale dhe zhvillimin e karrierës së doktorandëve, analizojnë performancën e studentëve dhe cilësinë e mbikëqyrjes, si dhe identifikojnë pikat e forta e mangësitë. Në bazë të tyre, përcaktohen masa konkrete për përmirësim, si rishikimi i kurrikulës, forcimi i mentorimit dhe mbështetja për kërkimin shkencor. |
| **Konkluzione** | *Universiteti Europian i Tiranës ka ngritur një sistem funksional për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të programit të doktoraturës, duke përfshirë njësi të specializuara si IQAC dhe struktura të tjera institucionale që sigurojnë zbatimin e standardeve të cilësisë. Proceset e shqyrtimit, miratimit dhe mbikëqyrjes janë të formalizuara dhe të dokumentuara, ndërsa vlerësimet bazohen në tregues cilësorë dhe sasiorë të matshëm, të lidhur me progresin kërkimor, publikimet, punësimin dhe kënaqësinë e studentëve.*<br><br>*Raportet e vlerësimit janë të detajuara, adresojnë rezultatet e pritshme dhe përmbajnë masa konkrete për përmirësim, duke u shpërndarë te autoritetet vendimmarrëse për transparencë dhe orientim strategjik. Në këtë mënyrë, UET garanton përmbushjen e objektivave formuese dhe rezultateve të të nxënit në nivel doktorature.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br><br>**Institucioni dhe njësia përgjegjëse përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit doktoral kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimi të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit, apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Programi i doktoraturës në UET vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes bashkëpunimit ndërmjet Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", Departamentit dhe Zyrës së Studimeve të Doktoraturës. Vlerësimet përfshijnë analizën e ecurisë së studimeve dhe të përputhshmërisë së tyre me kërkesat e tregut të punës dhe me prioritetet shkencore, duke u mbështetur në konsultime me Bordin e Tregut të Punës dhe analizat e punësimit të të diplomuarve. |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, Institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën që ka programi i doktoratës. | Institucioni përdor metoda të njohura dhe të strukturuara për vlerësimin e programit të doktoraturës, të cilat përfshijnë tregues sasiorë dhe cilësorë, anketa me studentë dhe alumni, si dhe feedback nga punëdhënësit dhe aktorët e jashtëm. Vlerësimi i disertacioneve realizohet përmes një procesi të standardizuar që siguron përputhjen me kriteret akademike dhe vendore, i cili përfshin Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Gjithashtu, institucionet përfitojnë nga proceset e akreditimit të përsëritur dhe nga angazhimi i Zyrës së Studimeve të Doktoraturës dhe Zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor për të garantuar që programi të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të jetë në përputhje me standardet kombëtare dhe institucionale të cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit | Universiteti Europian i Tiranës zbaton metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e programit të doktoraturës përmes vlerësimeve të disertacioneve dhe analizës së përmbushjes së objektivave të nxënies. Ky proces përfshin shqyrtimin e |

| | |
|---|---|
| doktoral përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë. | përmbajtjes së disertacioneve në përputhje me kriteret akademike dhe etike, vlerësimin e strukturës dhe koherencës shkencore të kërkimit, si dhe evidentimin e ndikimit të kërkimit në fushën përkatëse. Vlerësimet realizohen nga vetë institucioni, përfshirë komisionet akademike dhe bordet vlerësuese, sipas formatit metodologjik të përcaktuar në dokumentet strategjike të UET-it. Këto metoda sigurojnë një analizë të thelluar të progresit të doktorandëve dhe ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit doktoral përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre te diplomuar, të personelit akademik, kërkues shkencor, udhëheqësve dhe partnerëve. | UET përdor një qasje gjithëpërfshirëse në vlerësimin e programit të doktoraturës, duke mbledhur të dhëna përmes anketave të studentëve dhe të diplomuarve, analizës së feedback-ut nga mbikëqyrësit dhe vlerësimit të ngarkesës së punës së tyre. Gjithashtu, realizohen takime dhe konsultime me aktorët relevantë për të vlerësuar përvojën akademike dhe efektivitetin e mentorimit, në përputhje me Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028. Këto metoda synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të programit duke përfshirë zërat e të gjithë palëve të interesuara. |
| **Kriteri 5.** Mekanizmat e vlerësimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programit, përfshijnë palët e interesuara, institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Programi i doktoraturës përfshin palët e interesuara në procesin e vlerësimit përmes bashkëpunimit me punëdhënësit, organizatat kërkimore dhe alumni-t. Këto partneritete ndihmojnë në rishikimin dhe përshtatjen e programeve me nevojat e tregut dhe zhvillimet akademike, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe relevancës së kurrikulës. Mekanizmat e komunikimit dhe analizës së vazhdueshme sigurojnë që informacioni i mbledhur nga këto grupe të përdoret në mënyrë strategjike për përmirësimin e rezultateve të programit. |
| **Konkluzione** | *Universiteti Europian i Tiranës ka zbatuar një sistem të konsoliduar vlerësimi për programin e doktoraturës, në përputhje me kërkesat e standardit V.3. Vlerësimi i brendshëm kryhet në mënyrë të rregullt nga strukturat përkatëse, duke u reflektuar në vetëvlerësimet institucionale. Institucioni përdor* |

| | |
|---|---|
| | *metoda dhe instrumente të ndryshme të përshtatura për natyrën e programit, përfshirë analiza të disertacioneve, tregues sasiorë dhe cilësorë, si dhe mekanizma të rishikimit të brendshëm dhe të jashtëm.*<br><br>*Gjithashtu, përdoren metoda të drejtpërdrejta dhe tërthorta vlerësimi si anketat me studentë, alumni, mbikëqyrës dhe partnerë institucionalë. Palët e interesuara, përfshirë punëdhënësit dhe organizatat kërkimore, janë të përfshira aktivisht në procesin e vlerësimit, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjen e tij me nevojat e tregut dhe zhvillimet shkencore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br><br>**Institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC të programit të doktoratës dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit doktoral. | Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur dhe e praktikave të ndjekura, konstatohet se Universiteti Europian i Tiranës ka ndërtuar një kuadër funksional që parashikon dhe garanton përfshirjen sistematike të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të doktoratës.<br><br>Stafi akademik, mentorët dhe njësitë mbështetëse angazhohen rregullisht në procese të vetëvlerësimit, identifikimit të nevojave për përmirësim dhe në propozimin e ndërhyrjeve konkrete. Mekanizmat për përfshirjen e aktorëve të jashtëm, si përfaqësues nga tregu i punës, ekspertë nga institucione partnere dhe ish-studentë, janë të institucionalizuar përmes strukturave këshilluese si Bordi i Tregut të Punës dhe bashkëpunimet ndëruniversitare. Strategjia e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028 përmendet si dokumenti udhëheqës, i cili përshkruan mënyrat e |





| | |
|---|---|
| | përfshirjes dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit aktor. Vlen të theksohet se ka një ndërveprim të qëndrueshëm midis përvojës akademike dhe kërkesave të tregut të punës, çka ndihmon në përafrimin e objektivave të programit me realitetin profesional dhe kërkimor.<br><br>Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UET angazhohet në vlerësime të rregullta nga institucione si ASCAL dhe QAA (UK), që përfshijnë gjithashtu palët e interesuara të jashtme në vlerësimin e cilësisë së programeve. Institucioni ndjek procedura për rishikime të plota apo të pjesshme në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe me ekspertë të jashtëm, sipas nevojave që lindin nga analiza të brendshme ose kërkesa për akreditim. Për më tepër, ekspertë akademikë të jashtëm dhe konsulentë të fushës angazhohen në forume diskutimi dhe këshillime për të dhënë udhëzime mbi përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të doktoraturës. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe në informacionin e mbledhur gjatë vizitës në institucion, konstatohet se Universiteti Europian i Tiranës (UET) ka ngritur një strukturë të qartë funksionale për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të doktoraturës.<br><br>Përgjegjësitë dhe detyrat përkatëse janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Rregulloren e Studimeve të Doktoraturës dhe në Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028, duke përfshirë aktorët kryesorë institucionalë si Dekanati, Departamenti, Koordinatori i Programit të Doktoraturës, si dhe Grupet e Vetëvlerësimit. Zyra e Shkollës Doktorale mbështet në mënyrë operative funksionimin e mekanizmave të cilësisë dhe bashkërendon komunikimin ndërmjet aktorëve përkatës. Nga vëzhgimi i praktikave dhe diskutimet me stafin akademik dhe administrativ, vërehet se ekziston një përputhje e mirë ndërmjet dispozitave të dokumentuara dhe zbatimit praktik të tyre. Struktura e përgjegjësive dhe proceset e llogaridhënies janë ndërtuar në përputhje me parimet e menaxhimit të cilësisë në arsimin e lartë. |

| | |
|---|---|
| | Megjithëse programi ndodhet ende në ciklin e tij të parë dhe nuk ka përfunduar ende diplomimi i doktorantëve të parë, mekanizmat ekzistues për sigurimin e cilësisë duken funksionalë dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm. *<u>Rekomandohet</u> që, pas përfundimit të ciklit të parë, të realizohet një vlerësim i thelluar i zbatimit dhe efikasitetit të këtyre mekanizmave, me synim rishikimin dhe përshtatjen e strukturave sipas nevojës.* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativë dhe studentët e programit të studimit. | Për secilin kandidat, monitorimi i progresit realizohet përmes dokumentacionit të rregullt të fazave të kërkimit, të cilat përfshijnë: miratimin e temës dhe propozimit të disertacionit, raportimin e progresit, vlerësimin e ndërmjetëm, si dhe përgatitjen për mbrojtjen përfundimtare. Këto etapa janë të formalizuara në Rregulloren e Programit të Doktoraturës dhe mbështeten nga formatet standarde të hartuara nga Zyra e Studimeve të Doktoraturës. Kjo garanton gjurmueshmëri dhe transparencë gjatë gjithë ciklit kërkimor. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Universiteti Europian i Tiranës, përmes Kodit të Etikës dhe rregulloreve përkatëse, garanton integritetin akademik dhe respektimin e parimeve të barazisë gjatë gjithë proceseve të sigurimit të cilësisë. Aktivizimi i aktorëve të brendshëm në ciklet e vlerësimit bëhet në një ambient gjithëpërfshirës, ku çdo kontribut vlerësohet në mënyrë të barabartë, pa diskriminim apo trajtim të pabarabartë ndaj stafit apo studentëve. Kjo qasje reflekton përkushtimin institucional për të siguruar që proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (IQA) të respektojnë lirinë akademike dhe të drejtat e njeriut. Në përputhje me Rregulloren e Studimeve të Doktoraturës, UET ka përcaktuar gjithashtu masa të veçanta për të garantuar përfshirjen dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë individët e verbër, paraplegjikë apo tetraplegjikë. Këtyre studentëve u ofrohen zgjidhje të personalizuara për përmbushjen e detyrimeve akademike, si përdorimi i kompjuterëve personalë, mundësi për transkriptim ose ndihmë të drejtpërdrejtë, dhe përshtatje të metodave të provimit në raste të arsyeshme. Këto masa sigurojnë që asnjë student të mos përjashtohet nga procesi për |

| | |
|---|---|
| | shkak të kufizimeve fizike dhe që pjesëmarrja në vlerësim dhe cilësi të jetë e barabartë dhe dinjitoze për të gjithë. |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Universiteti Europian i Tiranës siguron përfshirjen aktive të partnerëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, përmes marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve të strukturuara. Ekspertët e jashtëm, që kanë lidhje me programin e studimit ose me fushat përkatëse të kërkimit, angazhohen në procesin e rishikimit të programeve dhe ofrojnë mendime të specializuara për cilësinë dhe përmirësimin e mëtejshëm të tyre. Kjo përfshirje ndihmon në mbajtjen e programeve në përputhje me standardet akademike ndërkombëtare dhe zhvillimet shkencore aktuale. |
| **Kriteri 6.** Monitorimi i ecurisë akademike e programit të doktoratës dhe sigurimi i cilësisë, është pjesë e veprimtarisë së njësisë përgjegjëse e Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" dhe NJSBC. | Monitorimi i ecurisë akademike të studentëve të doktoraturës dhe zbatimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë është funksion i drejtpërdrejtë i Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara, i cili administron programin. Ky departament është përgjegjës për ndjekjen sistematike të progresit akademik të kandidatëve, duke siguruar që çdo student të ndjekë rrugëtimin kërkimor në përputhje me objektivat e programit. Monitorimi përfshin gjithashtu raportimin dhe koordinimin me Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe me strukturat përkatëse të njësisë SBC. |
| **Konkluzione** | *Universiteti Europian i Tiranës përfshin njësitë akademike, personelin dhe studentët në proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC) të programit të doktoraturës dhe duke informuar në mënyrë të vazhdueshme palët e interesuara për rezultatet dhe masat e marra. Përmes Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë 2023–2028 dhe rregulloreve të brendshme, institucioni ka krijuar struktura funksionale që përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha njësive përkatëse, përfshirë Dekanatin, Departamentin, Koordinatorin e Programit dhe grupet e vetëvlerësimit.*<br><br>*Këto struktura sigurojnë përfshirje të plotë dhe të barabartë të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe studentëve në proceset e vlerësimit, duke promovuar transparencë dhe përmirësim të* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *vazhdueshëm. UET respekton parimet e integritetit akademik dhe barazisë duke siguruar përfshirjen pa diskriminim të personave me aftësi të kufizuara, të cilëve u ofrohen mbështetje dhe përshtatje në përputhje me nevojat e tyre. Partnerët dhe ekspertët e jashtëm luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe rishikimin e programeve, duke dhënë ekspertizë për zhvillimin e tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare. Monitorimi i progresit akademik të studentëve të doktoraturës është funksion i drejtpërdrejtë i Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara dhe realizohet në koordinim me Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe me njësinë SBC. Proceset e dokumentuara të monitorimit përfshijnë të gjitha fazat e kërkimit dhe sigurojnë mbështetje institucionale gjatë gjithë ciklit të studimeve.*<br><br>*Rekomandohet që, pas përfundimit të ciklit të parë, të realizohet një vlerësim i thelluar i zbatimit dhe efikasitetit të këtyre mekanizmave, me synim rishikimin dhe përshtatjen e strukturave sipas nevojës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br><br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen | Bazuar në analizën e dokumentacionit të paraqitur dhe vëzhgimeve gjatë vizitës në Universitetin Europian të Tiranës (UET), vlerësohet se institucioni ka strukturuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar rolet dhe përgjegjësitë për njësitë, individët dhe aktorët e tjerë të përfshirë në sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e doktoraturës. Nëpërmjet Rregullores së Studimeve të Doktoraturës dhe Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë 2023–2028, janë përcaktuar qartë funksionet e njësive bazë akademike, përfshirë Dekanatin, Shefin e Departamentit, |

| | |
|---|---|
| publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Koordinatorin e Programit Doktoral dhe Grupet e Vetëvlerësimit, si dhe roli mbështetës i Zyrës së Shkollës Doktorale. Secili prej këtyre aktorëve ka përgjegjësi të sanksionuara në mbikëqyrjen e përmbushjes së standardeve akademike, monitorimin e ecurisë së doktorantëve dhe hartimin e masave për përmirësim.<br><br>Nga vëzhgimet në terren dhe bisedat me personelin akademik dhe administrativ, rezulton se ekziston një përputhje e konsiderueshme ndërmjet dokumenteve institucionale dhe praktikave në zbatim. Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë paraqitet i funksionalizuar dhe i ndërtuar mbi parimet e kontrollit të cilësisë, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm.<br><br>Megjithatë, duke qenë se programi ndodhet në ciklin e tij të parë dhe doktorantët e parë nuk janë diplomuar ende, *rekomandohet* që pas përfundimit të këtij cikli të realizohet një vlerësim më i thelluar i zbatimit praktik të përgjegjësive dhe efektivitetit të mekanizmave të ngritura, në mënyrë që të identifikohen mundësitë për rregullime dhe përmirësime të mëtejshme. Në përgjithësi, nga këndvështrimi i ekspertëve të jashtëm, Institucioni ka krijuar një bazë të fortë institucionale për menaxhimin sistematik të cilësisë në programin e doktoraturës, duke u përgatitur për sfidat e fazave të mëvonshme të zhvillimit të këtij cikli akademik. |
| **Kriteri 2.** Institucioni dhe njësia përgjegjëse publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Universiteti Europian i Tiranës angazhohet për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit në përputhje me normat e etikës akademike, duke respektuar lirinë akademike dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Njësia përgjegjëse për këtë proces është Komisioni i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë (IQAC), i cili siguron që çdo rezultat të publikohet vetëm pas vlerësimit dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Në rastet kur programi i doktoraturës ende nuk është vlerësuar, UET shpreh gatishmërinë për të publikuar rezultatet menjëherë pas përfundimit të procesit. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan | Në përputhje me Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028, rezultatet e vlerësimeve duhet të shoqërohen me masa konkrete për përmirësim, që adresojnë mangësitë apo dobësitë e |

| | |
|---|---|
| masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | evidentuara. Të dhënat që mblidhen nga proceset e monitorimit dhe vlerësimit në UET përdoren për planifikimin strategjik të institucionit, për hartimin e raporteve të brendshme dhe për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, kërkim dhe shërbime mbështetëse. Ato gjithashtu shërbejnë për planifikimin e aktiviteteve vjetore dhe për rritjen e performancës në të gjitha nivelet. Raportet dhe dokumentet përkatëse arkivohen në formate fizike dhe elektronike, duke siguruar gjurmueshmëri dhe transparencë institucionale. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të doktoratës. | Universiteti Europian i Tiranës, në përputhje me Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë 2023–2028, vlerëson vazhdimisht efektivitetin e veprimeve të ndërmarra në kuadër të monitorimit të cilësisë dhe përmirësimit të programeve, përfshirë programin e doktoraturës. Qasja institucionale ndaj vlerësimit të cilësisë bazohet në Ciklin e Përmirësimit Deming (PDCA – Plan, Do, Check, Act), i cili siguron një model sistematik për ndjekjen e progresit dhe ruajtjen e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha aspektet e programit. Ky cikël i integruar i veprimit institucional e bën të mundur që të masë ndikimin real të masave të zbatuara dhe të përcaktojë nevojat për ndërhyrje të mëtejshme në mënyrë objektive dhe të gjurmuar. |
| **Kriteri 5.** Institucioni dhe njësia përgjegjëse organizon veprimtari periodike me personelin akademik përgjegjëse dhe studentët doktorantë për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të doktoratës. | Institucioni, përmes strukturave përgjegjëse, organizon veprimtari për informimin dhe përfshirjen e stafit akademik dhe të studentëve të doktoraturës në çështjet e sigurimit të cilësisë. Këto përfshijnë workshop-e, sesione informuese dhe trajnime, të cilat janë pjesë e planit të veprimit të institucionit për rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes aktive në përmirësimin e cilësisë. Në vitin 2022, anëtarë të stafit dhe studentë doktorantë morën pjesë në sesione të ofruara nga agjenci ndërkombëtare si QAA (UK), me fokus në përmirësimin e standardeve të cilësisë dhe ndërkombëtarizimin e programeve. Këto aktivitete ndihmojnë në ndërtimin e një kulture cilësie të qëndrueshme, ku çdo aktor akademik është i informuar dhe i angazhuar në mënyrë aktive. |
| **Konkluzione** | *Universiteti Europian i Tiranës siguron transparencë dhe efektivitet në politikat dhe veprimtaritë për sigurimin e cilësisë.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Politikat dhe rezultatet e vlerësimeve publikohen në përputhje me etikën akademike dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave.*<br><br>*Çdo vlerësim shoqërohet me plane konkrete për përmirësim dhe vlerësohet impakti i masave përmes qasjes PDCA. UET organizon rregullisht trajnime dhe aktivitete ndërgjegjësuese me staf dhe studentë për të forcuar kulturën e brendshme të cilësisë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në: "Shkencat Sociale dhe Sjelljes"**

a. **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Qasje ndërdisiplinore që ndërthur shkenca sociale me qasje ekonomike, politike, psikologjike dhe kulturore;
2. Universiteti Europian i Tiranës ka përfshirje aktive në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare (Erasmus+, COST, AKKSHI), që fuqizon kapacitetin kërkimor dhe ndërkombëtarizimin;
3. Tematika kërkimore të përqendruara në realitetin shqiptar dhe rajonal, që i japin programit relevancë konkrete;
4. Universiteti Europian i Tiranës ka një sistem të brendshëm sigurimi cilësie të strukturuar mirë dhe të njohur ndërkombëtarisht përmes akreditimit të QAA (UK);
5. Procesi i dorëzimit e mbrojtjes së disertacionit është transparent, me faza të formalizuara, kontrolle anti-plagjiaturë dhe juri pesë-anëtarëshe;
6. Aktivitetet shkencore të qëndrueshme, si konferenca "Ditët e Studimeve Shqiptare" dhe revistat UET Press, krijojnë platforma të rregullta botimi e prezantimi për doktorandët;
7. Fonde europiane si Horizon Europe dhe Erasmus+ mund të sjellin projekte shumëdisiplinore ku doktorandët marrin role drejtues;

b. **Pika të dobta:**

1. Mungesa e programeve të përbashkëta doktorature, pavarësisht kapaciteteve dhe interesit të deklaruar institucional; ***(Standarti III.5, kriteri 5)***
2. Burime të kufizuara për mobilitetin ndërkombëtar të doktorantëve në krahasim me universitetet perëndimore; ***(Standarti IV.2 dhe IV.3 , konkluzione)***

c. **Rekomandime**

1. GVJ rekomandon që Institucioni të krijojë mekanizma të nevojshëm për zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimeve të doktoratës, me universitete homologe në një nga vendet anëtare të BE;
2. GVJ rekomandon zhvillimin e mekanizmave të strukturuar për mbështetjen e inovacionit dhe patentimit të ideve që lindin nga kërkimi doktoral;
3. GVJ rekomandon nevojën për përmirësim në strukturimin dhe monitorimin e prodhimit shkencor të studentëve, veçanërisht në drejtim të publikimeve në revista ndërkombëtare me faktor impakti dhe të indeksuara;

4. GVJ rekomandon se janë të nevojshme hapa të mëtejshëm për të fuqizuar dimensionin ndërkombëtar të programit, përmes promovimit të synuar në rrjete akademike ndërkombëtare dhe përmirësimit të shërbimeve mbështetëse për studentët e huaj, si orientimi, mbështetja administrative dhe integrimi social;

**Evaluation's conclusions for the Third Cycle Doctorate in "Social and Behavioral Sciences."**

**a. Strengths and affirmations:**

1. An interdisciplinary approach that merges social sciences with economic, political, psychological, and cultural perspectives;
2. The European University of Tirana has an active involvement in national and international research projects (Erasmus+, COST, AKKSHI), contributing to the strengthening of research capacities of both staff and students, as well as enhancing the institution's level of internationalization through academic collaborations and participation in European and global networks;
3. Research topics focused on Albanian and regional realities, giving the programme concrete relevance;
4. The European University of Tirana (UET) has a well-structured internal quality-assurance system internationally recognised through QAA (UK) accreditation;
5. The dissertation submission and defence process is fully transparent, with formalised stages, anti-plagiarism checks and a five-member jury;
6. Sustainable scholarly outlets—such as the annual "Albanian Studies Days" conference and UET Press journals—offer regular publication and presentation platforms for doctoral candidates;
7. EU funding schemes (Horizon Europe, Erasmus+) provide opportunities for multidisciplinary projects in which doctoral students can take leading rolës;

**b. Weaknesses:**

1. Despite the institutional capacities and the formally expressed commitment, joint doctoral programs have not yet been established; ***(Standard III.5, Criterion 5)***
2. Resources allocated for the international mobility of doctoral candidates remain limited, especially when compared to the practices and opportunities offered by Western universities; ***(Standard IV.2 and IV.3, Conclusions)***

**c. Recommendations**

1. The External Evaluation Group (EEG) recommends that the Institution establish the necessary mechanisms for the development of joint doctoral programs with peer universities in EU member states;
2. The EEG recommends the development of structured mechanisms to support innovation and the patenting of ideas generated from doctoral research;
3. The EEG recommends improvements in the structuring and monitoring of doctoral students' scientific output, particularly concerning publications in indexed international journals with an impact factor;
4. The EEG recommends that further steps are needed to strengthen the international dimension of the program, through targeted promotion in international academic networks and the enhancement of support services for foreign students, including orientation, administrative assistance, and social integration;





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. KUADRI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT DOKTORAL | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT DOKTORAL | | | | X |
| III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT | | | | X |
| IV. KËRKIMI SHKENCOR, ARRITJET DHE REZULTATET | | | | X |
| V. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN DOKTORAL | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |